




E Shtunë 29 Qershor 2024



Gazment Bardhi mashtroes ordiner, asnjë kallëzim për Olsi Ramën në SPAK, Edi Rama e nominon "çingije" të Sali Berishës  Faqe 4

# SPAK fut në skaner pasuritë e Berishës që nga viti 1995, si kanë ndryshuar të ardhurat e tij gjatë 30 viteve, nga pallatet, fabrikat, vilat, disa shtëpi e qindra mijëra euro, "gropën" mund t'ia bëjë Argita dhe Shkëlzeni, ja detajet e bujshme nga dosjet konfidenciale bankare që janë në duart e amerikanëve dhe britanikëve

Faqe 2-3



**Kryetari i komanduar i Bashkisë Himarë Arqile Bollano në hetim nga SPAK, ja si përfitoi rreth 14 mijë m<sup>2</sup> tokë në vitin 2015, zbardhen detaje nga dosja "përvëluese" që kanë në duart prokurorët specialë**

Faqe 10

**Edi Rama "shkarkon" Belinda Ballukun dhe paralajmëron administratën se do ngrejë më shumë "çarqe" për të kapur të korruptuarit, priten lëvizje drejtorësh**

Faqe 5

**Vajza e "non-gratës drejt marrjes së frenave të partisë, Argita Malltezi nxjerr "muskujt" brenda PD, i tregon vijën e kuqe Gazment Bardhit dhe i mbyll derën e bashkëpunimit Lulzim Bashës**

Faqe 7



Rezoluta për Jasenovacin "trazon" politikën në Podgoricë, propozimi i Mandiç kritikohet ashpër, miratimi do t'i kushtojë shtrenjtë vendit, ja si u shndërrua Mali i Zi në "veglën" e Serbisë

Faqe 12



Ja emri i ri që mund të zëvendësojë Joe Biden, demokratët në panik kërkojnë largimin e presidentit të SHBA pas dështimit në përballjen me Donald Trump, zbardhet skenari i fundit

Faqe 13

**Dështon Censi i popullsisë, nuk është anketuar më shumë se gjysma e shqiptarëve, ja skandali i drejtoreshës së INSTAT, hidhen në erë 16.9 milionë euro për të nxjerrë shifra të falsifikuara**

Faqe 9

**Vangjel Tavo, kandidat i PS për kryetar bashkie në Himarë, ja si Rama po kërkon t'iu mbyllë "gojën" grekëve me vendosjen e njeriut të Ilir Metës që është nën hetim nga SPAK**

Faqe 6

**Ja të dhënat zyrtare nga rritja e pagave, kush përfiton dhe kush përjashtohet, zbardhet roli që do të ketë vjetërsia në punë**

Faqe 8

**Anastas Kostandini: Vizatimi është mjet për të mbajtur mend çaste nga jeta materiale dhe sentimentale, ai mbetet një ditë i vend-jetës**

Faqe 20

## KOMENT & ANALIZË

Faqe 16-19

### NGA TRITAN KALO

RRËNJËT e dukurisë "ONKOLOGJIK" janë 33 vjeçare...

### Nga Bujar LESKAJ

Paaftësia në mbikëqyrje e AKEP-it

### Nga Bardhyli ERMINI (BEJO)

Udhëkryqet "me vulë" të opozitës tonë

### Nga Dhimitër SHTËMBARI

Kur do, shteti e kap lepurin me qerre

## RAJON & BOTË

**Lëvizjet e amerikanëve "tërbojnë" rusët, Vladimir Putin urdhëron "djegien" e një qyteti të tërë, plani i hakmarrjes rrezikon të gjithë Ukrainën, ja pse Zelensky mund të detyrohet të ulet në tryezën e negociatave**

Faqe 15

**Një epokë e re e pret Britaninë e Madhe pas 4 korrikut, sondazhet e kanë bërë të qartë se kush do t'i fitojë zgjedhjet, ja pse fati politik i kryeministrit Rishi Sunak varet në "fije të perit"**

Faqe 14

# speciale-politikë

## Zbardhen dokumentet, ja si hetimet e SPAK do të nxjerrin pasuri marramendëse t

Të fuqishmit po bien një e nga një nga fronti për pasuritë marramendëse që kanë vendosur nga hiçi. Është çështje kohe që Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi të fundosen nga SPAK. Në skanerin e drejtësisë së re është edhe ish-kryeministri Sali Berisha bashkë me familjen e tij. Në një dosje voluminoze që po heton SPAK renditen të gjitha argumentet se si një kryeministër ka vënë shtetin në shërbim të familjes së tij. Ka ndryshuar ligje, ka ngritur agjenci e zyra, të gjithë në funksion personal. Madje ka bërë presion e shkarkuar nga detyra këdo që i ka dalë kundra. SPAK tashmë ka në dorë paligjshmëritë e institucioneve dhe procedurat e dyshimta për tjetërsimin e pronës. Por jo vetëm kaq. Hetimi për të zbardhur dosjen për korrupsion dhe pasurim nëpërmjet pushtetit të Berishës është shtrirë deri në vitin 1995, madje në skanerin e SPAK janë futur dhe mbesat e ish-kryeministrit. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Tiranë shkaktoi tërmet me vendimin e saj vitin e kaluar. Drejtësia vendosi masën e sigurimit pasuror "sekuestro preventive", për 25 pasuri të paluajtshme në pronësi të tij dhe bashkëshortes, Argita Malltezi, mes tyre 6 llogari bankare. Një prej pasurive që është vendosur nën sekuestro preventive është edhe një vilë luksoze në Gjirin e Lalzit, ku Berisha kalon edhe pushimet, për të cilën ai ka deklaruar se vila nuk është e tij, por e së bijës Argitës dhe bashkëshortit të saj Jamarbër Malltezi. Kjo është vetëm maja e ajsbergut, pasi hetimet përfundimtare do të nxjerrin pasuri marramendëse, të cilat familja "Berisha" nuk i justifikon dot.

### Pasuria e Berishës

Qëndrimi për gati 30 vite në politikë i Berishës, duket se ka pasur dhe benefitet e veta. Ai është ndër politikanët më jetëgjatë në vend, duke pasur pothuajse të gjitha postet që mund të dëshironte çdokush, nga president, kryeministër, deputetë, kryetar partie, etj. Por këto poste që ai ka mbajtur kanë ndikuar dhe në të ardhurat e familjes së tij, pasi çdo vit fitimet janë shtuar ndjeshëm, sidomos gjatë periudhës 2005-2013, periudhë kur Sali Berisha mori drejtimin e qeverisë. Gazeta "SOT" ka marrë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të gjitha deklaratimet që ish-kryeministri ka bërë sa i takon të ardhurave të tij. Sot po pasqyrojmë pasurinë e deklaruar nga Berisha që prej vitit 2003 e deri në vitin 2022, pasi për vitin 2023, duhet të presim marsin e 2025. Berisha deklaroi në çdo studio televizive se pasuria e tij është vetëm një apartament dhe 100 mijë euro kursime nga pagat. E vërteta është se familja Berisha ka një pasuri me vlerë dhjetëra milionë euro. Kjo pasuri është në emër të dy fëmijëve, Shkëlzenit dhe Argitës, si dhe dhëndrit Jamarbër Malltezi. Pasuria me vlerë marramendëse, ku përfshihen pallate, fabrika, apartamente dhe qindra mijëra euro, është krijuar kryesisht pas vitit 2006, që përkon me ardhjen në pushtet të Sali Berishës. Ky fakt konfirmon se trashja Shkëlzen-Argita-Jamarbër është pasuruar nën hijen e pushtetit të Berishës si kryeministër, siç është provuar edhe nga dosjet e britanikëve dhe amerikanëve, të cilat janë në duart e SPAK.

# SPAK fut në skaner pasuritë e Berishës ardhurat e tij gjatë 30 viteve, nga mijëra euro, "gropën" mund t'ia bëjë nga dosjet konfidenciale bankare që



### Provat që kanë britanikët dhe amerikanët

Vetë Berisha tha se Londra e akuzon se ka prova për vajzën e tij, e cila ka vepruar si portiere për investitorët që vinin në Shqipëri. Në dosje ata kanë llogaritë bankare dhe veprimtarinë e vajzës së tij, të cilat ai i quan mashtrime pasi janë prova të aktiviteteve dhe llogaritë individuale bankare të një studioje tjetër ligjore, madje dhe llogari private të personave të tjerë, të cilat pa asnjë prove, i citon si pjesë e pasurisë së vajzës së tij. Dosjet konfidenciale bankare zbulojnë sesi një studio ligjore në pronësi të vajzës me ndikim të ish-kryeministrit shqiptar Sali Berisha u bë një portë për investitorët e huaj të mëdhenj që kërkonin licenca, leje dhe mbështetje politike nga qeveria e babait të saj. Pak muaj pasi Sali Berisha u zgjodh kryeministër i Shqipërisë në vitin 2005, vajza e tij Argita Malltezi u kthye në shtëpi nga Prishtina, duke lënë pas një punë të mirë paguar në Misionin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK, për të hapur një zyrë ligjore në kryeqytetin Tiranë. Duke u bashkuar me një nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e saj në UNMIK, Flutura Kola, ata krijuan tre firma avokatësh-Malltezi&Kola, Kola&Associates dhe Malltezi&Associates, duke ndarë një zyrë dhe një listë në rritje të klientëve fitimprurës. Në pak muaj, ata u bënë avokatët e kërkuar për kompanitë shumëkombe të investonin në ekonominë shqiptare në rritje të shpejtë. Por ish-klientët pretendojnë se e kanë punësuar Malltezin për lidhjet e saj familjare dhe për të anashkaluar kërcënimet e shantazhit, jo vetëm për aftësitë e saj ligjore.

### Ndryshimi i pasurisë

Sa i takon Berishës, në vitin 2003, kur nisën dhe deklaratimet e pasurisë, ish-kryeministri si pasuri të paluajtshme ka deklaruar vetëm një apartament të fituar nga procesi i privatizimit pas rrëzimit të regjimit komunist. Bëhet fjalë për një apartament 69 metër katror, por që Berisha

në këtë periudhë zotëronte vetëm 33 për qind të tij. Po ashtu ka deklaruar rreth 5 milionë lekë të vjetra KESH, ndërsa i ka dhënë vajzës 21 mijë euro borxh. Por duke kaluar nga viti në vit pasuria e tij ka ndryshuar ndjeshëm, sidomos të fëmijët e zotit Berisha. Në vitin 2004 ai ka deklaruar vetëm pagën e tij si deputet, ndërsa në 2005 kur mori detyrën e kryeministrit, të ardhurat ndryshuar ndjeshëm. Ai ka deklaruar llogari bankare rreth 15 milionë lekë të vjetra si dhe disa piktura apo suvenire argjendi të dhuruara nga homologët e tij. Në vitin 2006 ka qenë bashkëshortja e tij që ka shtuar llogaritë bankare me të ardhura kryesisht nga paga në mjekësi. Po ashtu Berisha ka deklaruar 800 mijë lekë të reja kesh, ose 8 milionë lekë të vjetra. Ndërsa në vitin 2008 ka nisur deklarimin e pasurive nga dy fëmijët e tij, Argita dhe Shkëlzen Berisha. Ajo që bie në sy është se ata kanë pasuri me dhjetëra milion lekë në vit, ndërsa në disa raste shkojnë dhe në qindra mijëra euro. Ata kanë deklaruar llogari bankare brenda dhe jashtë vendit. Zonja Argita ka deklaruar llogari në një bankë amerikane, ndërsa Shkëlzen Berisha ka deklaruar llogari në një bankë suedeze.

### Ja si ka ndryshuar ndër vite pasuria e familjes Berisha

#### Viti 2003

Apartament banimi 69 m<sup>2</sup>, përfituar nga privatizimi, zotëron 33% Lekë CASH: 0.5 milionë lekë 2.1 milionë lekë dhënë hua vajzës

#### Viti 2004

Paga si deputet, 1.381.2015 lekë

#### Viti 2005

Llogari në Raiffeisen Bank, 1.500.000 lekë Gjendje CASH, 400 mijë lekë Paga si deputet janar-gusht, 971.537 lekë Të ardhura si kryeministër, 707.287 lekë Të ardhura nga paga e bashkëshortes. Piktura, servis argjendi, filxhane, vazo, etj, dhuratat nga kryeministria të huaj

#### Viti 2006

Depozitë kursimi+llogari rrjedhëse në Raiffeisen bank, 191 lekë+5.139 lekë

Liri Berisha, depozitë + llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, 44.774 lekë+6.593 lekë

Liri Berisha llogari në Tirana Bank, 351.672 lekë

Gjendje CASH: 800.000lekë+ 15.000lekë Paga si kryeministër, 2.469.960 lekë Bashkëshortja, paga në qendrën shëndetësore nr.4, 401.616 lekë

#### Viti 2007

Pakësim i 2/3 së apartamentit dhe likuidim të huasë prej 2.1 mln lekë dhënë nga vajza

Blerje apartamenti dhe parkimi nëntokësor

Pakësim gjendje CASH, -950.000 lekë Liri Berisha, shtesë llogarie bankare në Tirana Bank, 736 lekë+16.334 lekë Shtesë në Bankën Amerikane, nga derdhja gjendjes CASH, 6 mijë euro Shtese po në Bankën Amerikane, 1.154.350 lekë

Shtesë llogarie në Credins Bank nga paga e bashkëshortes, 408.857 lekë Liri Berisha shtim llogarie në Raiffeisen Bank, 9.157 lekë

Liri Berisha pakësim llogarie Raiffeisen Bank, -286 lekë

Paga si kryeministër, 2.540.520 lekë Të ardhura si anëtar i KRRTSH, 386.250 lekë

Të ardhura nga paga e bashkëshortes, 337.339 lekë Shpërblim i bashkëshortes, 56.210 lekë

#### Viti 2008

Pakësim i llogarisë në Intesa San Paolo Bank, -1.500 lekë

Gjendje llogarie Credins Bank, +5.824 lekë

Liri Berisha shtesë llogarie, 10.074 lekë+13 lekë

Shtesë nga paga e bashkëshortes në Credins Bank, +406.735 lekë

Pakësim llogarie bashkëshortja në Raiffeisen Bank, -300 lekë

Liri Berisha, shtesë në Raiffeisen Bank, 897 lekë

Sali Berisha, shtesë llogarie në Raiffeisen Bank, +122.796 lekë

Pakësim në Raiffeisen Bank, -776 lekë Paga dhe shpërblime si kryeministër, 2.149.592 lekë+9000 lekë

Paga e bashkëshortes në qendër shëndetësore, 576.947 lekë

Argita Malltezi

Emporiki Bank, 9.069 USD +11.227,41 euro

Chavy Chase Bank llogari, -570.88 USD

Llogari në UNFCU, -14077.09 USD dhe +2099.54 USD

Llogari në Raiffeisen Bank, +32 euro Llogari në Intesa San Paolo, -94.538 lekë

Shitur makina Mitsubishi, 8200 euro Shitur makina Mercedes A Class, 5.000 euro

Rroga si pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, 821.500 lekë

Të ardhura si avokate, 5.264.363 lekë Dhënia me qera apartamenti, 900 euro/muaj

Dhënia me qera apartamenti, 1170 euro/muaj

Të ardhur nga mësimdhënia në Kosovë, 3 mijë euro në muaj

Repartation grant OKB, 9069 USD Shlyer kredi, 138.019 euro

Shkëlzen Berisha

Llogari në Intesa San Paolo Bank, 84.659 euro

Fitime si konsulent ligjor, 6930 lekë Llogari rrjedhëse në Intesa San Paolo Bank, 14.767 lekë

Llogari në Banka e Kredisë, 460.497 lekë

Llogari bankare në Suedi, 6 mijë euro

Fitime nga ndërmjetësimi në shit-blerje, 82.882 euro

Ndërmjetësim në shitblerje si peron fizik, 6930 euro

#### Viti 2009

200 mijë euro nga ndërmjetësimet në shitblerje pasurish

Makinë 18 mijë euro.

#### Viti 2010

150 mijë euro nga ndërmjetësimet 3 632 528 lekë të ardhura si konsulent juridik

#### Viti 2011

1 842 680 lekë të ardhura si konsulent juridik

12 000 euro kontratë qiraje të Vilës B9, në Lundër

#### Viti 2012

Makinë me vlerë 85 000 euro (55 000 euro kredi)

5 668 384 lekë të ardhura nga konsullanca ligjore

#### Viti 2013

346 mijë euro blerje apartamenti 198 m<sup>2</sup> dhe parkingu te ETC (277 200 euro kredi)

4 520 814 lekë të ardhura nga konsullanca ligjore

31 964 euro të ardhura nga dhënia e apartamentit te ETC me qira,

Pagesë qiraje për zyrat në Lundër 4 800 euro.

#### Vitin 2014

1 266 628 lekë rroga nga "Albanian Legal Company",

954 068 lekë dividendi nga "Albanian Legal Company",

50 350 euro të ardhura nga qiraja e apartamentit tek ETC Tiranë

Detyrim huaje 34 222 euro.

#### Vitin 2015

210 mijë euro nga ndërmjetësimi 1.000.000 lekë të ardhura nga konsullanca juridike

759.789 lekë të ardhura nga punësimi, 47,956 euro të ardhura nga qeraja e apartamentit

Kontratë qeraje në Lundër, 18 mijë euro.

#### Viti 2016

600 mijë euro të ardhura nga shitja e pasurive të paluajtshme në 2015

3 000 000 lekë nga konsullanca 961 956 lekë nga paga

vlera 47 956 euro nga qiraja e apartamentit të vitit 2015

#### Viti 2017

3 000 000 lekë të ardhura nga shoqëria Agromel

959 784 lekë nga paga



## ë familjes "Berisha"

# ishës që nga viti 1995, si kanë ndryshuar të pallatet, fabrikat, vilat, disa shtëpi e qindra të Argita dhe Shkëlzeni, ja detajet e bujshme janë në duart e amerikanëve dhe britanikëve

**Viti 2018**  
 3 parcela arë 6.183 metra katrorë, 3 parcela truall 14.220 metra katrorë, 5.066.5 metra katrorë godina në Gërdec, me kredi 1.8 milionë euro. Pajisje për ngritjen e një fabrike boricash në Gërdec 1.9 milionë euro 6 700 000 lekë nga konsulenca 2 281 228 lekë nga konsulenca faturuar në vitin 2017, arkëtuar në 2018 1 050 000 lekë nga punësimi në "Albanian Legal Company" Dhënë hua 90 mijë euro, kthim 10 mijë euro

**Viti 2019 deri në 11 mars**  
 Pakësuar llogaritë me 43 mijë euro Jamarbër Malltezi  
 -Jamarbëri pronar me 35-50 % i 20 pallateve në Tiranë, ndërtuar mbi pronën ish-Klubi Partizani

**Viti 2020**  
 Apartament në Tiranë me kontratë shkëmbimi në 2007-ën bashkëpronar 50%. Vlera sipas privatizimit: 2.100.000 lekë Bodrum në Tiranë, bashkëpronar 50% Llogari bankare në emër të Sali Berishës deri më datë 7.09.2021/ 5.554.833 lekë Llogari bankare: 36.218 dollarë Llogari bankare në emër të Sali dhe Liri Berishës: 9872 euro, bashkëpronar në vlerën 50%

Llogari në emër të Sali dhe Liri Berishës: 600 lekë, bashkëpronar 50% Llogari në emër të Sali dhe Liri Berishës: 1.235.401 lekë, bashkëpronar 50% Të ardhura nga pensioni deri më 01.08.2021/ 628.080 lekë Të ardhura nga interesat bankare: 262 lekë

**Bashkëshortja, Liri Berisha**  
 Llogari në emër të Liri Berishës: 5.103.444 lekë Llogari në emër të Liri Berishës: 16,482 euro Të ardhura nga pensioni deri më 01.08.2021/ 260,950 lekë.

**E bija, Argita Malltezi**  
 Apartament në bashkëpronësi 50% me vlerë 195.250 euro  
 Apartament në bashkëpronësi 50% me vlerë 200.000 euro  
 Apartament në bashkëpronësi 50% me vlerë 179.000 euro  
 Bodrum në bashkëpronësi 50% me vlerë 10.000 dollarë  
 Bodrum në bashkëpronësi 50% me vlerë 17.000 euro  
 Bodrum në bashkëpronësi 50% me vlerë 26.370 euro  
 Vilë në Lalëz, bashkëpronare 50%, vlera e godinës 56.000 euro plus toka 908.176 lekë

Ndërtesë banimi në Lalëz në bashkëpronësi 50%, vlera e godinës 155.000 euro Tokë bujqësore 3000 m<sup>2</sup> në fshatin Priskë në bashkëpronësi 50%, vlera: 4.950.000 lekë Llogari bankare Llogari bankare: 92 euro

1. Llogari bankare: 61.464 dollarë  
 2. Llogari bankare: 51 euro  
 3. Llogari bankare: 25.399 dollarë  
 4. Llogari bankare: 68.767 leke



5. Llogari bankare: 41.666 dollarë  
 6. Llogari bankare: 115.005 dollarë  
 7. Llogari bankare: 174.864 euro  
 8. Llogari bankare: 1.715.329 lekë  
 9. Llogari bankare: 522 euro  
 10. Llogari bankare: 155.228 euro  
 11. Llogari bankare: 6.108.308 lekë  
 12. Llogari bankare: 5.500 euro  
 13. Llogari bankare: 132.771 dollarë  
 14. Llogari bankare: 153.698 euro  
 15. Llogari bankare: disponon 25% të vlerës 15.136 dollarë  
 16. Llogari bankare: disponon 50% të vlerës 20.337 dollarë  
 Rroga neto në Fakultetin e Drejtësisë dhe shpërblime: 900.091 lekë  
 Të ardhura nga mësimdhënia në fakultete private: 1.235.520 lekë  
 Të ardhurat nga qiratë: 10.740 euro  
 Të ardhura nga honorarë: 4.095 euro  
 Të ardhura nga interesi: 257 dollarë, 218 dollarë, 349 lekë  
 I biri, Shkëlzen Berisha  
 Llogari bankare: 617.396 lekë Llogari bankare: 66.090 euro  
 Llogari bankare: 453.965 lekë  
 Llogari bankare: 3.960 lekë  
 Makinë "BMV", prodhimi i vitit 2012 Paga si administrator i një kompanie private: 758.880 lekë  
 Llogari overdrafti, detyrim i pashlyer: 28.960 euro

**Viti 2022**  
 Aseti: Gjendje cash. Detaje: Vlera monetare: 100,000.00 ALL. Burimi i Krijimit: Të ardhura nga paga, Shuma: 100,000.00 ALL. Aseti: Llogari bankare Detajet e ndryshimit: Shtuar. Vlera: 295,174.43 ALL. Burimi i Krijimit: Te ardhura nga paga, Shuma: 295,174.43 ALL. Të ardhura nga Dieta. Emërtimi: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 517,176.00 ALL. Të ardhura nga paga. Emërtimi: Kuvendi i Republikës se Shqipërisë. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 1,325,868.00 ALL. Bashkëshortja e tij Liri Berisha deklaroi: Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Shtuar. Vlera: 415,940.00 ALL. Burimi i Krijimit: Tjetër, Shuma: 415,940.00 ALL. Të ardhura nga pensioni. Nga data: 01/01/2022 Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 415,940.00 ALL. Të ardhura

nga pensioni. Nga data: 01/01/2022 Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 415,940.00 ALL.

**Pasuria e Argita Berishës**  
 Argita Berisha deklaroi 15 llogari bankare. Disa nga ato për vitin 2022 i ka shtuar me shifra shumë të vogla, disa i ka pakësuar me shifra shumë të mëdha, ndër to përmendim: Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 5,144,717.69 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Shtuar. Vlera: 5,942.00 euro. Burimi i Krijimit: Kursime, Shuma: 5,942.00 euro. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 47,932.12 euro. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 8,400.00 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 360.00 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 71,995.65 USD. Të ardhura të tjera. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 1,019,500.00 ALL. Honorare ose pagesa të tjera sipas kontratave të së drejtës civile. Emërtimi: Rektorati i Universitetit te Tiranës. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 20,400.00 ALL. Të ardhura nga paga. Emërtimi: Universiteti i Tiranës. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 1,239,812.00 ALL

**Pasuria e Shkëlzen Berishës**  
 Edhe Shkëlzen Berisha, njësoj si Argita ka nisur të boshatisë llogaritë. Djali i Sali Berishës ka deklaruar në ILDKPI për vitin 2022: Gjendje cash. Detaje: Vlera monetare: 6,000.00 euro. Burimi i Krijimit: Tjetër, Shuma: 6,000.00 euro. Gjendje cash. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 800,000.00 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 9,107.88 euro. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 1,560.00 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 2,158.88 ALL. Llogari bankare. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 976,970.48 ALL. Huadhënie Detaje: Data e huadhënies: 31/05/2022 Vlera: 2,000,000.00 ALL. Burimi i Krijimit: Tjetër, Shuma: 2,000,000.00 ALL.

Huadhënie Detaje: Data e huadhënies: 30/05/2022 Vlera: 2,760,000.00 ALL. Burimi i Krijimit: Tjetër, Shuma: 2,760,000.00 ALL. Huadhënie. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 2,672,447.03 ALL. Huadhënie. Detajet e ndryshimit: Pakësuar. Vlera: 3,659,900.00 ALL. Dhurata (monetare). Nga data: 25/09/2022. Në datë: 25/09/2022. Shuma Neto: 30,000.00 euro. Të ardhura të tjera. Nga data: 12/10/2022. Në datë: 12/10/2022. Shuma Neto: 1,019,500.00 ALL. Të ardhura nga tërheqja e dividendit. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 22,270.00 euro. Të ardhura nga tërheqja e dividendit. Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 30,000.00 EUR. Të ardhura nga paga. Emërtimi: Albania Legal Company shpk Nga data: 01/01/2022. Në datë: 31/12/2022. Shuma Neto: 384,816.00 ALL.

Ja 25 pasuritë që i janë sekuestruar Jamarbër Malltezi  
 1) Shuma prej 63 657.10 euro gjendur në llogarinë Bankare pranë ..... në monedhën euro me nr. 113398964650127 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi;  
 2) Shuma prej 2 699 408.46 lekë gjendur në llogarinë pranë ..... në monedhën lek me nr. 00000027583-74 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi;  
 3) Shuma prej 29 259.43 USD gjendur në llogarinë bankare pranë ..... në monedhën USD me nr. 40201835101 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi;  
 4) Shuma prej 62 018.49 euro gjendur në llogarinë Bankare pranë ..... në monedhën Euro me nr. 40201835102 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi;  
 5) Shuma prej 45 705.66 euro gjendur në llogarinë Bankare pranë ..... në monedhën Euro me nr. 40201838001 në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi;  
 6) Shuma prej 26 492.72 euro gjendur në llogarinë Bankare pranë ..... në monedhën Euro me nr. 403592661, në emër të shtetasit Jamarbër Malltezi.  
 7) Pasuria Nr. ND 2/261+2-19 vol.27, faqe 213, zk.8160, apartament me sipërfaqe 128.3 m<sup>2</sup> I ndodhur në Rr "Mustafa Matohiti" Godina 7, Hyrja 2, apartamenti 8.  
 8) Bodrumi i ndodhur në Tiranë, rruga "Mustafa Matohiti", me sipërfaqe 18 m<sup>2</sup>, ZK 8160 pasuria ND 2/261-B9 vol 28 faqa 56.  
 9) Bodrumi të ndodhur në Tiranë, rruga "Mustafa Matohiti", me sipërfaqe 28 m<sup>2</sup>, ZK 8160, pasuria nr. 2/261-B24 vol 28 faqa 71  
 10) Pasuria Nr. ND 2/261+2-25 vol.27, faqe 190, zk.8160, apartament me sipërfaqe 195 m<sup>2</sup> i ndodhur në Rr "Mustafa Matohiti", shkalla 1, kati i 8 apartamenti 25,  
 11) Pasuria nr. 2/261/ND+1-12, vol.

27, fq. 177, zk. 8160, me sipërfaqe 102.60 m<sup>2</sup>.  
 12) Pasuria Nr.4/90+1-23 vol.68, faqe 227, zk.8270, apartament me sipërfaqe 208.20 m<sup>2</sup> i ndodhur në Rr "Dëshmorët e 4 Shkurtit, Tiranë dhe 13) Pasuria 4/90-G6, VOL.68, FQ.131, ZK. 8270. 14) Pasuria Nr. 370/18 vol.8, fq.219, zk.3051 në bashkëpronësi të Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi.  
 14) Pasuria Nr.370/18 vol.8, fq.219, zk.3051 në bashkëpronësi të Jamarbër Malltezi dhe Argita Malltezi  
 15) Apartament me numër pasurie Nr. 3/491+19-4 Vol.62, fq.42, zk.8220 me sipërfaqe 346.1 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 70.3 m<sup>2</sup>.  
 16) Apartament me numër pasurie Nr. 3/491+19-5 Vol.62, fq.47, zk.8220 me sipërfaqe 356.3 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 68.8 m<sup>2</sup>  
 17) Njësi me numër pasurie Nr. 3/491+19-N3 Vol.62, fq.26, zk.8220 me sipërfaqe 459.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 43.03 m<sup>2</sup>  
 17) Njësi me numër pasurie Nr.3/491+19-N3 Vol.62, fq.26, zk.8220 me sipërfaqe 459.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 38.7 m<sup>2</sup>  
 18) Njësi me numër pasurie Nr. 3/491+19-N2 Vol.62, fq.27, zk.8220 me sipërfaqe 379.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 38.7 m<sup>2</sup>  
 19) Njësi me numër pasurie Nr. 3/491+18-N3 Kodi Unik 8220062026 me sipërfaqe 459.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 43.3 m<sup>2</sup>  
 20) Apartament me numër pasurie Nr. 3/491+19-2 Kodi Unik 8220062032 me sipërfaqe 375 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 31.1 m<sup>2</sup>  
 20) Apartament me numër pasurie Nr.3/491+19-2 Kodi Unik 8220062032 me sipërfaqe 375 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të përbashkët 31.1 m<sup>2</sup>  
 21) Truall dhe vile (apartament dublex) i vendosur mbi këtë truall me nr pasurie 172/277 ZK 2375 vol 14 faqa 77 me sipërfaqe 187.7 m<sup>2</sup>, me sipërfaqe 76.23 m<sup>2</sup> e ndarë në kati përdhe me sipërfaqe 76.23 m<sup>2</sup> kati i parë me sipërfaqe 76.22 m<sup>2</sup> si dhe verande me sipërfaqe 22.73 m<sup>2</sup>.  
 22) Pasuria me numër 3/201+2-N3, vol.28, fq.26 e ndodhur në ZK.8220, me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>, Ruga Frosina Plaku, kati përdhe i godinës 9 (nëntë) katëshe shkalla 2.  
 23) Masen 45% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise Homeplan sh.p.k. me NIPT K81803020E, ne emer te shtetasit Jamarber Malltezi;  
 24) Masen 100% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise Magnet IMO sh.p.k. me NIPT L81714031D, ne emer te shtetasit Jamarber Malltezi;  
 25) Masen 60% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise Magnet Gym&Fit, me NIPT L72022010B, ne emer te shtetasit Jamarber Malltezi.

# politikë

Rama publikon përgjigjen e prokurorisë: S'ka asnjë kallëzim nga Bardhi

## Gazment Bardhi mashtrues ordiner, asnjë kallëzim për Olsi Ramën në SPAK, Edi Rama e nominon "çingije" të Sali Berishës

Elmas BOGDANI

Vazhdon telenovela e mashtrimeve të deputetit demokrat Gazment Bardhi me dosjen "Xibraka". Vetëm pak orë, pasi Olsi Rama, vëllai i kryeministrit, u paraqit ditën e djeshme në SPAK (28 qershor), për të marrë një përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, ka qenë kreu i qeverisë Edi Rama, i cili e ka publikuar përgjigjen e Prokurorisë. Në përgjigjen e prokurorisë së Posaçme vërtetohet zyrtarisht se Gazment Bardhi nuk ka kryer asnjë kallëzim penal ndaj Olsi Ramës. "Në kuadër të veprimeve verifikuese, është kërkuar informacion nga Zyra e Regjistrimit në Prokurorinë e Posaçme, dhe nga shkresa Nr. 7973/1 Prot. datë 29 Maj 2024, rezultoi se i kallëzuar Gazment Bardhi nuk ka paraqitur në Prokurorinë e Posaçme ndonjë kallëzim penal në ngarkim të shtetasit Olsi Rama përgjatë vitit 2024", thuhet në përgjigjen e publikuar nga Rama. Pra del hapur se Bardhi ka mashtruar.

### Reagimi i Ramës

Përmes një postimi në rrjetet sociale, Rama tha janë vetëm kërcime të çingjies në prehrin e tutorit të ri lart në ballkon. "A ju kujtohet kur thoshte "kallëzim more kallëzim kam bërë" duke tundur ndenjësën mbi karrige?! Kishte zbuluar një narkotrafikant në familjen time, që e kishte kallëzuar në SPAK dhe aq shumë e bëri ajrin vrimë



me gisht sa e detyroi narkosin e kallëzuar, t'i bënte kallëzim për kallëzim të rremë. Mirëpo ja që s'paska qenë kallëzim i rremë sepse s'paska qenë fare hiç kallëzim, po një tjetër kërcim i çingjies në prehrin e tutorit të ri lart në ballkon. Orë të tëra në parlament, intervista të tëra nëpër kanale, tituj e fjali të tëra nëpër portale, pa asnjë turp e asnjë respekt për miletin që e kanë bërë si mish në pazarin e neveritshëm të kujëve e kuisjeve të tyre, dhe si përfundim një tallje e madhe për një kallëzim që nuk ekziston! Fatmirësisht SPAK-u megjithatë e ka rihapur dosjen e tundur nga çingjia si dajre mbi prehrin e tutorit dhe le të presim deri në fund nëse do të gjejë provat e pretenduara nga çingjia do të duhet t'i gjejë vendin gishtit të akuzës që e ka mbajtur aq shumë në ajër, për të argumentuar kallëzimin e paqenë!", shkruan Rama.

### Përgjigja e Bardhit

Por pas publikimit të përgjigjes së Ramës, reagoi dje edhe

Gazment Bardhi. Bardhi thotë ai ka bërë kallëzim, por jo në formën siç e do kryeministri Rama. "Po more budalla po kallëzim kam bërë! Lexo përgjigjen e drejtuesit të prokurorisë së Posaçme z. Altin Dumani! Unë nuk do bëjë kallëzimin në formën që don ti dhe yt vëlla, me qëllim rivarrosjen e çështjes që ekziston nga Prokuroria e Hanoverit. Unë kam bërë kallëzim siç e kërkon ligji në këtë fazë ku ndodhet çështja penale, dhe që ka risjell ekzaktësisht atë që unë kam kërkuar: "Rihapjen e dosjes penale 335/1-2016 që prokurori yt personal e kishte varrosur në 2018", shkruan Bardhi. Vetë Olsi Rama tha pasi doli nga SPAK se nuk ka asnjë lidhje me çështjen. "Nuk e di se çfarë ka vendosur prokuroria për kallëzimin tim. Do e shoh dhe do ju njoftoj nëse është e domosdoshme. E kam bërë kallëzimin se është bërë një manipulim i madh. S'kam asnjë çerek lidhje me bosët e Xibrakës. Dëgjo, ju e dini shumë mirë se i kujt është automjeti. Ia

kam marrë një personi në atë kohë për të bërë dy ditë udhëtim në Selanik. I kam mohuar të gjitha, se nuk ka asgjë të vërtetë. Do të vij sa herë të jetë nevoja", tha ai. Kujtojmë se Olsi Rama në maj të këtij viti depozitoi një padi në SPAK ndaj deputetit të opozitës Gazment Bardhi, lidhur me kallëzimin e këtij të fundit se Olsi Rama ka lidhje me laboratorin e drogës të zbuluar në Xibrakë në vitin 2015. Në kallëzim e Olsi Ramës, thuhet se ai i referohet një deklaratë të Bardhit bërë publike për median online lidhur me të. Sipas tij deklarimet e Bardhit përbëjnë elementë të veprës penale "Kallëzim të rremë". Nga ana tjetër SPAK ka rihapur hetimet për dosjen "Xibraka".

### Si e filloi mashtrimi Bardhi që vitin e kaluar?

Serinë e këtyre mashtrimeve Gazment Bardhi e filloi që në dhjetor të vitit të kaluar, kur paralajmëroi edhe me datë se do të publikojë dokumentet e dosjes që vërtetonin se të dhënat në sistemin TIMS u vodhën vetëm për të favorizuar vëllain e kryeministrit Rama. Jo vetëm që nuk i publikoi në atë datë, por nuk e përmendi dosjen, deri para disa javësh. Por edhe me publikimin e këtyre fakteve sipas Bardhit duket qartë se në të gjithë këto dokumente ka një lumë thashethemesh, pasi ai ka hedhur në treg një akuzë dhe disa lajme të bëra publike kohë më parë, të cilën e materializoi javën e kaluar. Informacionet për Genc Xhixhën, personazhin

kryesor të kokainës së Xibrakës që Bardhi tregoi se e shpëtoi Olsi Rama kanë dalë që në vitet 2015-2016. Me një kërkim të thjeshtë në "Google", mund t'i gjesh shumë kollaj. Akuzat e tij ndaj familjes së Ramës bëhen më të pabesueshme në momentin aktual, kur dihet shumë mirë aleanca aktuale e grupimit të Berishës me Edi Ramën. Të gjithë bashkë i ka bashkuar paniku i goditjes nga drejtësia dhe janë bashkuar për të zhbërë një reformë e cila ka ngrënë kokat e para me në krye Sali Berishën. Sa real është informacioni i Bardhit dhe lajmet e tij se e ka çuar dosjen në SPAK? Ai është i pabesueshëm pasi kjo nuk është hera e parë që Bardhi luan me denoncime dosjesh. Para disa muajsh ai denoncoi vilën 750 mijë euro të padeklaruar të Flamur Nokës, por që në fund nuk u materializua si kallëzim në SPAK pasi vetëm me përmendjen si aferë ai i ka arritur pazaret. Si mund të besohet Bardhi, kur brenda një kohe të shkurtër është transformuar totalisht me qëndrimet ndaj Berishës dhe Metës. Bardhi ka shkëmbyer akuza të llahtarshme me Sali Berishën që kur amerikanët e futën në "listën e zezë" familjarisht me akuzat e korrupsionit madhor dhe minuesit të demokracisë. Gazment Bardhi nuk sulmoi vetëm Berishën, por edhe aleatin e tij Ilir Meta dhe besnikët e tij që i shkuan nga pas. Në fund për interesat e tij personale ai ka "gëlltitur" çdo akuzë.

## Zbardhet kërkesa e Bardhit për interpelancë me Ramën: Emëroi këshilltar agjentin sekret rumun, i përfshirë në trafik droge

Kreu i Grupit të PD, Gazment Bardhi ka publikuar dje kërkesën për interpelancë me kryeministrin Edi Rama. Bardhi e akuzoi kreun e qeverisë se ka emëruar si këshilltar të jashtëm një ish-agjent sekret rumun, Florian Coldea, që sipas tij është i përfshirë në trafik ndërkombëtar droge. Në një deklaratë të ndarë për mediat, Bardhi shkruan se Coldea është në hetim nga Drejtoria Kombëtare e Antikorrupsionit në Rumani për korrupsion. Në kërkesën e Bardhit për interpelancë me Ramën thuhet se "Coldes është

nën hetim pasi i kanë kërkuar një biznesmeni shumë prej 700 mijë euro, në këmbim të së cilës i kanë premtuar se do të ndërhyjnë tek disa magjistratë në disa gjykata në mënyrë që ato të jepnin vendime të favorshme në një çështje penale në të cilën po gjykohej biznesmeni." "Edi Rama pa asnjë transparencë ka emëruar si këshilltar të jashtëm Florian Coldea, ish drejtor i Shërbimit Sekret Rumun. Ish agjenti sekret rumun është nën hetim për korrupsion, si dhe është referuar si drejtuesi i një linje trafiku ndërkombëtar të koka-

inës, që transportohej nga Meksika në Shqipëri dhe më pas nga Shqipëria në Rumani. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kam kërkuar zyrtarisht një interpelancë urgjente me Kryeministrin Edi Rama, i cili duhet të bëjë transparencë për Kuvendin dhe qytetarët shqiptar: (1) Si është njohur me këshilltarin e tij të jashtëm Coldea dhe a ka cenuar kjo sigurinë kombëtare për shkak të funksionit të tij si punonjës i shërbimeve të huaja sekrete; dhe (2) Cili ka qenë roli i z. Coldea dhe çfarë veprimtarie këshillimi konkretisht ka kryer

ai për Kryeministrin e Shqipërisë dhe për të cilën është paguar më taksat e shqiptarëve, ndërkohë që udhëhiqte një linjë të trafikut ndërkombëtar të kokainës nga Shqipëria në Rumani. Është rastësi e shumëfishtë që në çdo aferë të organizatave kriminale, përfshirë krimin e organizuar ndërshtetëror, përfshihen lidhje personale apo institucionale të Edi Ramës, ndërkohë që ky i fundit hesht. Por nuk është asfare rastësi që në qeverisjen 11-vjeçare të Edi Ramës, krimi i organizuar jo vetëm është fuqizuar, por ka përfaqësues të tij

në çdo institucion. Shqipëria, një vend kandidat për anëtarësim në BE dhe një vend anëtar i NATO-s, nuk meriton të qeveriset nga krimi i organizuar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do të kërkojë edhe zyrtarisht nga SPAK të hetojë rolin e Këshilltarit të Jashtëm të Edi Ramës në Shqipëri dhe sesi ka ndikuar marrëdhënia e tij me Edi Ramën për realizimin e veprimtarive të dyshuara kriminale të trafikut ndërkombëtar të kokainës nga Meksika në Shqipëri dhe nga Shqipëria në Rumani", thuhet në deklaratë.

## Hajdari kundër Berishës si kandidat për kryeministër, Noka iu kërkon vartësve të tij të takojnë drejtuesit e degëve të PD që ka mashtruar Basha

Është zhvilluar dje mbledhja e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike me detyrë të mbyllura. Nga bisedat e zbardhura në këtë mbledhje, deputeti Flamur Noka gjatë fjalës së tij ka thumbuar ish-kryetarin e kësaj force politike, Lulzim Bashën. Ai i ka dhënë porosi anëtarëve që të bëjnë takime me drejtuesit e degëve, që sipas tij janë mashtruar nga

ish-lideri i PD. Noka u shpreh se PD duhet ti hap derën çdokujt që është kundër qeverisë. "Drejtuesit e PD-së, Kryesisë, Këshillit Kombëtar, kryetarët e degëve të kontaktojnë me çdo demokrat për ta integruar në strukturë. Ne duhet të jemi të hapur dhe të shtrijmë dorën e bashkimit për demokratët si edhe jodemokratët, por që janë kundër qeverisë. Takoni

veçanërisht drejtuesit e degëve që janë mashtruar nga pengu (Basha). Protesta e 11 korrikut duhet të jetë madhështore sepse jemi e vetmja parti në Evropë ku lideri ynë është i burgosur politik pa provë, fakte dhe akuzë", deklaroi Noka. Në fjalën e saj nga mbledhja e Këshillit Kombëtar, deputetja Rudina Hajdari propozuar që PD të mos futet në zgjedhje me

Berishën si kandidat për kryeministër. "Me betejën e drejtuar nga lideri i PD Berisha u bë i mundur bashkimi dhe rikthimi i flamurit të PD. Jam dakord me çdo pikë dhe presje me rezolutën. Na ndajnë 9 muaj nga zgjedhjet e ardhshme. Kam respekt të jashtëzakonshëm për Sali Berishën si politikan. Por e rëndësishme është të diskutojmë për të ardhmen e PD-së.

Duhet të shohim një parti për të ardhmen ndoshta 15 vitet e ardhshme që nuk ka në qendër vetëm një person, por të një grupi njerëzish. Z Berisha ka bërë një punë të jashtëzakonshme. Do propozoja që PD të futet në zgjedhje me një kandidat tjetër për Km, jo z. Berisha", deklaroi Hajdari dhe. Ndërkohë në mbledhje u miratua edhe rezoluta e bashkimit.

Rama: Maskarenjtë nuk mbarojnë, dalin minj nëpër zyrat e shtetit

## Edi Rama "shkarkon" Belinda Ballukun dhe paralajmëron administratën se do ngrejë më shumë "çarqe" për të kapur të korruptuarit, priten lëvizje drejtorësh

Rigels SELIMAN

Zv/kryeministrja Belinda Balluku duket se nuk është më e preferuara e Edi Ramës sa i takon të përkëdhelurve të tij në qeveri dhe Partinë Socialiste. Edhe pse shihet si një kandidate e mundshme për të pasuar Edi Ramën në krye të PS, pavarësisht klaneve të tjera brenda partisë, së fundmi raportet mes zonjës Balluku dhe kryeministrit janë ftohur. Pasi i largoi disa drejtorë të rëndësishme që ishin "besnikë" të ministres së Transporteve dhe Energjisë, Belinda Balluku, shefi i qeverisë ka "shkarkuar" edhe zv/kryeministrën. Kjo e fundit prej muajsh ka qenë kryeministre në hije dhe çdo vendim e ligj kalonte nga firma e saj. Por së fundmi duket se gjërat kanë ndryshuar, pasi prej datës 12 qershor, frenat e Kryeministrisë e Qeverisë i ka marrë Edi Rama. Zoti Rama u është rikthyer mbledhjeve të qeverisë, ku sipas një vëzhgimi të gazetës deri në mbledhjen e fundit (26 qershor) të Këshillit të Ministrave, është ai që ka firmosur vendimet. Pra duket qartë se kemi një krisje të raporteve Rama-Balluku dhe sikur të mos mjaftonte kjo, pritet që në ditët në vijim zv/kryeministrja të marrë të tjera goditje, pasi shumë drejtorë të rëndësishme që





janë njerëz të saj do të shkarkohen dhe madje disa prej tyre që janë përfshirë në afëra do të kallëzohen penalisht në Prokurorinë e Posaçme (SPAK). Megjithatë duhet theksuar se kjo verë apo edhe shtatori të jenë të nxehtë për socialistë, pasi lëvizja e Ramës, tregon se kryeministri iu ka përcjellë një mesazh të koduar të gjithë klaneve të krijuara në Partinë Socialiste, që tentojnë apo guxojnë të ngrënë kokën kundër tij dhe bashkëpunëtorëve të tij, se i presin ditë të vështira.

### Paralajmërimi

Por nuk ndalet me kaq, pasi zv/kryeministrja Belinda Balluku nuk është e vetmja që është bërë me "dhimbje koke". Kryeministri Edi Rama, nga Dhërmiu ka shigjetuar dje administratën publike në vend, teksa theksoi se qeveria ka ngritur shumë çarqe për të kapur minj në zyrat e shtetit, sikundër

i konsideron ai të korruptuarit. Rama tha se secili ka punë e vet për të bërë e llogarinë e tij për të mbajtur. "Fjalë më shumë përditë ka. Baltë më shumë sa të duash. Xhagajdur e maskarenj, nuk mbarojnë, dalin. Minj nëpër zyrat e shtetit, patjetër, por edhe kjo, që kur kapen minjtë, të vësh kujën, që "o po bëhet nami". Ç'po

bëhet nami? Shyqyr që po kapen, më shumë të kapen, për këtë punë kemi bërë gjithë këtë përpjekje dhe për këtë punë përpiqemi. Po minjtë i kap çarku. Prandaj, kemi ngritur e do ngremë edhe më shumë çarqe për të kapur minj. Por nuk mund të rrimë të tërë të të rrokaniemi ditë-natë, se u kapën ca minj aty, u kapën edhe ca minj këtu, tani duhet të ngrihem të tërë e të merremi t'i biem njëri-tjetrit. Secili ka punën e vetë për të bërë. Secili ka përgjegjësinë e vetë për të mbajtur. Secili ka llogarinë e vetë për të dhënë dhe secili që është në anën e qytetarëve ka llogarinë e vetë për të kërkuar sipas detyrave. Kam dhënë këtë detyrë, ma bëj", deklaroi dje Rama gjatë ceremonisë në Dhërmi, ku ndau 789 tituj të tjerë pronësie në procesin e përmbylljes së hipotekimit të shtëpive të trashëguara.



## Nick Abbott emërohet ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri

Nick Abbott është emëruar ambasador i Britanisë së Madhe në Tiranë. Ambasadori Abbot do të marrë detyrën në muajin shtator, pas përfundimit të mandatit të ambasadorit aktual Alastair King-Smith. Lajmin e ka bërë të ditur Ambasada Britanike në Shqipëri përmes një postimi në rrjete sociale. Ambasada Britanike sqaron se Abbott ka punuar në Evropë dhe Lindjen e Mesme dhe se ai ka një përvojë të jashtëzakonshme edhe si ambasadori i Madhërisë

tij në Kosovë. "Nick Abbott është emëruar Ambasador i Madhërisë së Tij në Shqipëri. Të gjithë ne në ambasadë mezi presin ta përshëndesin në shtator 2024. Ai ka punuar në Evropë dhe Lindjen e Mesme dhe sjell një përvojë të jashtëzakonshme edhe si Ambasadori i Madhërisë së Tij në Kosovë", njofton Ambasada Britanike në Tiranë, teksa ka publikuar dhe historikun e karrierës së diplomatit që pritet të vijë në vjeshtë në Tiranë.

## Berisha shfaqet optimist: Misioni ynë shpëton Shqipërinë

Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha deklaroi dje se, misioni i PD shpëton Shqipërinë. Në fjalën e tij online në mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike, Berisha tha se, "mbledhja e sotme e këtij forumi ka një rëndësi të veçantë, që nuk e ka pasur asnjë mbledhje tjetër qysh nga rithemelimi i PD, sepse nëse në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar, ne ende nuk kishim realizuar plotësisht asnjërin nga tre objektivat tonë madhorë, sot ne mblihdemi pasi dy nga tre objektivat tonë më madhorë, për arritjen e misionit

tonë, ne i kemi përmbushur". "Realizimi i këtyre dy objektiveve bën që sot Shqipëria të jetë në një realitet të ri, që deri para pak kohësh do të ngjante i pamundur. Në mars të vitit 1992, kur PD erdhi në pushtet herën e parë, në fjalimin e fitores ju drejtova shqiptarëve me këto fjalë: Gëzuar ditën e parë të demokracisë. Ato fjalë sintetizojnë më së miri misionin e atëhershëm të kësaj partie, sepse me atë akt PD ndante epokat për Shqipërinë. Ato fjalë ndanë diktaturën ideologjike nga demokracia. Në mënyrë të

ngjashme, kur PD të fitojë vitin e ardhshëm, dhe ua theksoj këtë: fitorja vitin e ardhshëm është në duart tona. Pra kur PD të fitojë vitin e ardhshëm, fjalimi i fitores do të hapet me fjalët: Gëzuar ditën e parë të rikthimit të demokracisë. Kjo miqtë e mi është rëndësia e misionit tonë. Misioni ynë ndan përfundimisht narkoshtetin nga demokracia. Misioni ynë çliron përfundimisht Shqipërinë nga pushtimi më i egër i brendshëm që i është bërë këtij vendi. Misioni ynë shpëton Shqipërinë", deklaroi Berisha.

# politikë

## Shpërndahen 789 certifikata pronësie, Rama në Dhërmi: Brenda tetorit mbyllet procesi për qarkun e Vlorës

Kryeministri Edi Rama ishte dje në Dhërmi ku ndau 789 tituj të tjerë pronësie, në procesin e përmbylljes së hipotekimit të shtëpive të trashëguara. Kreu i qeverisë u shpreh se në total, bashkë me certifikatat e ndara sot janë 4 300 certifikata të shpërndara, teksa shtoi se deri më tani është mbyllur 1/3 e procesit, teksa brenda tetorit pritet të mbyllet i gjithë procesi. “Pjesa tjetër e punës, rreth 2

500 certifikata të tjera janë në Bashkinë e Himarës, 500-600 jashtë Bashkisë së Himarës, por në qarkun e Vlorës dhe të gjithë procesin do ta përmbyllin brenda tetorit”, tha Rama. Kreu i qeverisë tha se ky proces po ndiqet edhe në zonat e veriut, si Thethi, Hasi e Tropoja, por edhe në zonat më jugore, si Konsipoli, ku ka patur një problematikë ndryshe nga pjesa tjetër e vendit. “Jemi mbledhur këtu sot për të

vazhduar një proces, që është procesi i përmbylljes së një përpjekjeje shumë të gjatë. Në radhë të parë të një përpjekjeje shumë të gjatë nga ana juaj dhe ju siguroj që ka qenë një përpjekje jo e shkurtër edhe nga ana jonë, pasi kjo zonë, së bashku me disa zona të tjera të Shqipërisë, të cilat shtrihen nga veriu, dhe deri poshtë tutje në Konispol, janë disa pika ku problematika ka qenë e ndryshme nga ajo e

pjesëve të tjera të territorit”, tha Rama. Ai mohoi se ka patur politika diskriminuese për zonën. “Kjo për të thënë dhe atë që sa e pavërtetë, sa e ulët është e gjithë propaganda sipas të cilës ne kemi marrë, dhe që është bërë një politikë diskriminuese sepse ajo propagandë ka qëllime krejt të tjera nga interesat tona të përbashkëta dhe nga interesat e banorëve të vetë Himarës”, tha Rama. Kryeministri tregoi

dhe problematikat. “E vërteta është që problemi i regjistrimit të shtëpive të trashëguara në këto pika, e përsërisë nga Thethi, Malësia e Madhe, Kukësi, Hasi, Tropoja, e pastaj edhe tutje poshtë në disa pika të tjera, është një problematikë që lidhet me faktin se ndryshe nga të gjitha zonat e tjera, e gjithë marrëdhënia e titujve të pronësisë ka qenë e komplikuar. Shumë e komplikuar”, tha Rama.

Rama: Vangjel Tavo e keni këtu për punë

## Vangjel Tavo, kandidat i PS për kryetar bashkie në Himarë, ja si Rama po kërkon t’iu mbyllë “gojën” grekëve me vendosjen e njeriut të Ilir Metës që është nën hetim nga SPAK

Elmas BOGDANI

**M**e dënimin e Fredi Belerit me vendim të formës së prerë, Himara shkon në zgjedhje të parakohshme. Kryetari i zgjedhur i bashkisë bregdetare humb mandatin e tij pasi ai bëhet subjekt i ligjit të dekriminalizimit që i ndalon atij mbajtjen e detyrës për aq kohë sa është i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë. Pas publikimit të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, qeveria do të duhet të vërë në dijeni Presidentin për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në bashkinë e Himarës. Nga marrja në dijeni kreu i shtetit do të duhet të vendosë brenda 40 ditëve për datën e zgjedhjeve. Mbetet për tu parë nëse qeveria do t’i ndjekë shpejt procedurat për të çuar Himarën në zgjedhje të parakohshme, që u bë edhe shkak i ngrirjes së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Greqisë. Nuk përjashtohet mundësia që afatet kushtetuese të shkelen për shkak se përpara është vera e nxehtë dhe zgjedhësit janë me pushime. Rasti më i freskët është ai i zgjedhjeve të parakohshme në bashkinë e Kukësit. Sipas afateve kushtetuese ato do të duhet të zhvilloheshin brenda gushtit, por afatet u shkelën dhe kryebashkiaku i ri i Kukësit u zgjodh në fundin e shtatorit të një viti më parë. Deri sa politika



“Kështu që, doni Vangjel për punë, ja ku e keni! Doni një Vangjel për sherr, prisni një Vangjel me vetulla të rënda që t’iu sjellë sherrin. Kaq e thjeshtë është.”

të vendosë se kur zgjedhësit e Himarës do të thirren para kutive të votimit, PS dhe PD do të duhet të nxjerrin kandidatët e tyre.

**Vangjel Tavo, kandidat i PS për kryetar bashkie në Himarë**

Dje kryeministri Edi Rama dha sinjale se nga kampi rozë emri më i mundshëm është minoritari grek Vangjel Tavo. PS e rifuti në politikë duke emëruar prefekt të qarkut të Vlorës. Ai shihet si kandidatura më e mirë që në rast fitore do të lehtësojë komunikimin mes Tiranës dhe Athinës zyrtare. Rama u shpreh dje se një nga arsytet pse po përmbyllet procesi i titujve të pronësisë në Himarë është këmbëngulja e prefektit të qarkut të Vlorës, Vangjel Tavo. Në ceremoninë e shpërndarjes së titujve të pronësisë në Dhërmi, Rama vlerësoi angazhimin e prefektit të qarkut, Vangjel Tavo dhe gatishmërinë e tij për të

qenë pranë banorëve. “Prandaj edhe bashkia është bërë me krah, prandaj dhe kadastra është bërë me krah, se ka një usta që i rri mbi kokë edhe i thotë këtu, këtu. Dhe prandaj edhe marrëdhënia është më e afërt me banorët, sepse kanë një njeri që ua kam thënë ditën e parë kur ka ardhur prefekt, provoni ta merrni në telefon edhe më tregoni kur do ndodhi që nuk do ngre telefonin. Kështu që, doni Vangjel për punë, ja ku e keni! Doni një Vangjel për sherr, prisni një Vangjel me vetulla të rënda që t’iu sjellë sherrin. Kaq e thjeshtë është. Doni të vazhdojë kjo punë tamam siç vazhdon, thashë opinionet edhe diversiteti në kafene përplasni sa të keni qejf, se në këtë zonë përplasni brenda për brenda nëpër shtëpia më shumë se të tjerët për opinione politike gjithë jetën ka qenë kjo, po jashtë pastaj puna duhet të vazhdojë duhet të vazhdojë. Janë një mijë gjëra për t’u për t’u zgjidhur, nuk janë vetëm këto, një mijë”, tha ai.

### Rama në Himarë: Nuk ka oligarkë në Shqipëri

Ndërsa shpërndante certifikatat e pronësisë në Dhërmi, kryeministri Edi Rama mohoi akuzat e opozitës se qeveria do të marrë pronat në Himarë. Madje për t’iu përgjigjur akuzave se njerëzit pranë tij kanë vjedhur pronat dhe kanë bërë investime në jug, Rama tha se në Shqipëri nuk ka oligarkë. “Kjo është një punë e madhe, nga pikëpamja e volumit. Nuk është se nuk është bërë më përpara se nuk kemi dashur ne, por për ato arsye që thashë. Të gjithë kanë të drejtën për të pasur mendimet e tyre, por faktet janë fakte. Me faktet nuk luftohet, me opinionet po. Kemi vullnetin maksimal për ta mbyllur një herë e mirë këtë histori. Të tjerë e kanë shfrytëzuar këtë ngërç për të helmuar mendje dhe zemra njerëzish duke treguar lloj-lloj përrallash të shëmtuara, shumë të ulëta. Të gjitha që

qeveria do të marrë pronat në Himarë, do të thotë të tregosh një përrallë të shëmtuar dhe ulët. Se nuk ka lidhje me ne. Edhe sikur ta ketë ndërmend qeveria, se bën dot këtë gjë. Ata që kanë zhvilluar sipërmarrje këtu, kanë kontrata me pronarët e vërtetë, jo me qeverinë. Çmimi i tokës këtu në këtë zonë, është rritur ashtu siç nuk ia priste mendje deri 10 vite më parë. Kjo rritje nuk ka ardhur nga qielli apo malet, ata kanë qenë këtu. Por ja ku jemi këtu sot, se deri më parë, nuk mblidheshim dot te ky shtet që të rrinim në shesh, por do të rrinim në gropa. Para disa vitesh që të vije këtu ishte mund i madh. Sot kam ardhur për 2 orë. Oligarkë në Shqipëri nuk ka. Fjala oligark me sipërmarrës, është diçka ndryshe. Kam hequr dorë nga pronat këtu, se mund të isha dhe unë një nga pasardhësit e bregut”, tha ai.

### Lëvizja që mund t’i kushtojë shtrenjtë Ramës

Tavo ka qenë deputet i qarkut të Gjirokastrës nga radhët e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, por nuk e ka fshehur asnjëherë simpatinë e ndërsjellë me kryeministrin Edi Rama. Por kjo lëvizje mund t’i kushtojë shtrenjtë Edi Ramës, njësoj si rasti i Lefter Kokës, ish-besnikut të Ilir Metës, i cili ndodhet tashmë në burg pasi u bë deputet në siglën e Partisë Socialiste. E themi këtë pasi Vangjel Tavo është nën hetim nga Prokuroria e Posaçme

për lobimin me para të pista të ish-Lëvizjes Socialiste për Integrim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai madje u thirr para pak javësh për të dëshmuar në SPAK. Në materialin e referuar në Prokurorinë e Posaçme po hetohet Ilir Meta, bashkëshortja e tij Monika Kryemadhi, ish deputeti Vangjel Tavo dhe Iraklis T. Fidetzis, administrator i kompanisë Dorelita Limited me seli në Qipro, përfshirë në skemën e lobimit në vitin 2017, për llogaritë të Metës dhe LSI, me para të padeklaruar.

Kur hyn Argita Maltezi në politikë? Vajza e Sali Berishës zbulon arsyen

# Vajza e “non-gratës drejt marrjes së frenave të partisë, Argita Maltezi nxjerr “muskujt” brenda PD, i tregon vijën e kuqe Gazment Bardhit dhe i mbyll derën e bashkëpunimit Lulzim Bashës

Rigels SELIMAN

Argita Maltezi nuk është ende pjesë e strukturave drejtuese të Partisë Demokratike, por qëndrimi i saj shihet si përcjellje në publik i qëndrimeve të kreut të opozitës, Sali Berisha, i cili, prej fundit të dhjetorit 2023, gjendet në arrest shtëpie. Dhe ajo nuk ka ngurruar të tregohet direkte në kundërshtimin e idesë së Gazment Bardhit për një kandidat për kryeministër nga diaspora, që të udhëheqë fushatën elektorale të opozitës. “Mendoj që është një eksperiment i patestuar, por edhe i rrezikshëm në një farë mase, sepse vlerësimi me realizëm i situatës autokratike në të cilën ndodhet Shqipëria, i eliminimit të zgjedhjeve të lira, për shkak të masave represive të Ramës me të gjitha format, me drejtësinë, në kapjen e financave publike etj, e bën të pamundur një gjë të tillë, sado që është një ide shumë e mirë. E kam dëgjuar idenë, por kam menduar se bëhet fjalë për një kryeministër pas fitores së zgjedhjeve, sepse atëherë, kuptohet që është fare e mundur si alternativë”, tha dje zonja Maltezi gjatë një intervistë me gazetaren Elona Meço në emisionin “Pa Censurë”, në RTSH. Zonja Maltezi i qëndroi deklaratës së hershme të kreut të opozitës Sali Berisha për të vendosur me referendum të ardhmen e tij si kryeministër. “Normalisht, personi që udhëheq fushatën, është kandidati



për kryeministër. Sali Berisha, në një xhest unik, ka thënë se pas fitores në zgjedhje do t'u japë mundësinë shqiptarëve me referendum për të zgjedhur, nëse duan që ai të jetë ose jo kryeministër. Mendoj që ka një mazhorancë absolute ndër shqiptarë që, e duan apo jo Berishën, janë të bindur se Sali Berisha nuk bën pazare në luftën kundër Edi Ramës, që ai qëndron në betejë deri në fund, që e çon fushatën deri në fund sipas interesit të popullit opozitar dhe besoj se kjo është një bazë e mirë për t'i besuar atij udhëheqjen e fushatës elektorale, qoftë edhe nga arresti i shtëpisë”, u shpreh zonja Maltezi gjatë intervistës për emisionin “Pa Censurë”, në RTSH. Argita Maltezi është e bindur se, përveç Lulzim Bashës, të gjitha forcat e vërteta opozitare do të pranojnë

të bashkohen në një koalicion të përbashkët, të udhëhequr nga Sali Berisha.

## Angazhimi

Ndërkohë vajza e Sali Berishës, Argita Maltezi, la hapur gjithçka për sa i përket përfshirjes së saj në strukturat drejtuese të Partisë Demokratike apo në grupin e saj parlamentar, duke kandiduar në zgjedhjet e vitit të ardhshëm. “Deri para 8 muajsh, ju nuk më keni parë në media që të flas për çështjet e politikës. Kjo nuk ka qenë në projektet e mia. Sot nuk di t'ju them se çfarë do të sjellë e nesërmja dhe sesi do të reagoj. Për shkak të rrethanave kam vendosur të heq dorë nga rrjedha normale e jetës dhe të përfaqësoj një kauzë. Do ta ndjek deri në fund pa asnjë diskutim, por nuk parashikoj dot, nëse do të marr një vendim dhe kur do ta marr një

vendim”, tha Argita Maltezi dje, e cila dukej e sinqertë në përgjigjen e saj, gjatë së cilës shprehu dëshirën që jeta e saj të rikthehej në normalitet, si përpara tetorit 2023, kur bashkëshorti i saj u arrestua dhe ndaj babait të saj u morën disa masa sigurimi, të vlerësuar si antikushetuese. Ajo që u kuptua qartë dhe që Argita Maltezi e pohoi për herë të parë pas këmbënguljes së gazetares Elona Meço ishte se gjithçka varej nga gjendja e arrestit të Sali Berishës.

## Pjesë nga intervista e Argita Maltezi për emisionin “Pa Censurë”, në RTSH

Elona Meço: Cilat janë rrethanat që do t'ju detyronin ju të hynit në politikë, p.sh, që Sali Berisha të mbetet në arrest?

Argita Maltezi: Realisht nuk jam në gjendje t'i përgjigjem kësaj, sepse thashë, nuk ishte një planifikim që unë do të angazhohesha dhe do të bëjë këtë intervistë apo të tjera si kjo para tetorit 2023.

Elona Meço: Në fakt juristët kanë gjithmonë disa plane, përveç planit A.

Argita Maltezi: Po, e vërtetë, por i kanë atëherë kur kanë synim për të arritur diçka. Politika aktive nuk ka qenë kurrë synimi im. Dhe nuk kam patur një projekt. Politika ka qenë gjithnjë pjesë integrale e jetës sime, pjesë kushtëzuese e jetës sime, por jo angazhimi politik si profesion. Por duke thënë këtë, prapë dua ta

përsëris, edhe pse ju i quani fraza klishe, por nuk është kështu, pra, nëse vendos ta bëj, do ta bëj sipas procedurave të PD, sipas statutit të PD dhe gjithmonë me koshiencën e plotë që trashëgimia e Sali Berishës nuk është trashëgimi familjare, është trashëgimi e personave që kanë kontribuar në PD për 32 vite dhe e kanë mbështetur Berishën, përpjekjet e PD-së në qeveri dhe në opozitë gjatë këtyre 32 viteve.

Elona Meço: Kur thoni “nëse vendos që do ta bëj”, e keni fjalë për t'u bërë pjesë e grupit parlamentar si një mënyrë kjo për të hyrë në politikë, për të drejtuar partinë apo për të marrë pjesë në strukturat drejtuese të PD?

Argita Maltezi: Nëse do të ketë nevojë, do të angazhohem sipas nevojave që do të krijohen. Nuk mund të them asgjë tjetër sepse, realisht, nuk është diçka që mund ta parashikoj.

Elona Meço: Deri kur do të presim ne?

Argita Maltezi: Unë shpresoj që gjërat të vijnë në rrjedhën normale dhe unë të rimarr rrjedhën time normale të jetës, atë që kisha planifikuar dhe kisha planifikuar shumë gjëra në fakt. Politika nuk ishte një prej tyre. Nëse ndodh që nuk do të rikthehem shpejt në rrjedhën që kisha planifikuar, këtu jam, përsëri do të flasim.

Elona Meço: Pra duhet të dalë Sali Berisha nga arresti i shtëpisë, që ju të ktheheni në rrjedhën tuaj normale?

Argita Maltezi: Po, besoj se po.

## Basha sulm frontal Ramës dhe Berishës, ekspozon puçin e tyre kundër SPAK dhe Reformës Zgjedhore si vijim të pazarit të 2008-ës, ja si po mundohen të mbajnë në këmbë pandëshkueshmërinë

Kreu i demokratëve euroatlantik, Lulzim Basha ka komentuar dje situatën politike, ndërsa ka hedhur akuza të forta në adresë të kryeministrit Edi Rama dhe ish-kryeministrit Sali Berisha. Gjatë një prononcimi për mediat, zoti Lulzim Basha tha se ndryshimet Kushtetuese të 2008-ës duhen shfuqizuar pasi e kanë kthyer Shqipërinë në Republikë kryeministrale. Sipas Bashës, Rama dhe Berisha po veprojnë në vazhdim të asaj marrëveshje, pasojat e të cilës janë korrupsioni dhe shpopullimi. Propozimet për listat e hapura, votën e diasporës, numërimin elektronik, barazinë e votës dhe Shqipëria një zonë, të depozituara në Kuvend nga demokratët euroatlantikë, janë ndryshime që i duhen vendit. “Ne kemi çuar në Parlament propozimet tona për kodin zgjedhor. Dhe këto propozime siç i di tashmë mbarë Shqipëria, janë 4: listat e hapura, pra ta zgjedh qytetari deputetin, jo kryetari i partisë. Së dyti, votimi dhe numërimi elektronik, sepse shmang shumë problematika dhe shumë manipulime të zgjedhjeve të kaluara nga qeveria. Së treti, barazia e votës, sepse sot një deputetë në Vlorë zgjidhet me 8500

vota, por në Kukës me 13 500 vota dhe kjo nuk është barazi vote. Shqipëria një zonë elektorale, është ajo që ne kemi propozuar. Dhe e katërta që e kemi çuar qartësisht se si duhet bërë, është vota e diasporës. Me Shqipërinë një zonë elektorale, me votimin elektronik, me listat e hapura, diaspora e ka fare të lehtë, shqiptarët që jetojnë jashtë Shqipërisë e kanë fare të lehtë të hedhin votën e tyre. Pra, propozimet tona janë aty. Në qoftë se këto propozime vijnë debatoohen, diskutohen, padiskutim na duhet vota e çdokujt, edhe e socialistëve për t'i kaluar. Fatkeqësisht duhet ta them, nga ky moment ku jemi sot duket qartë pjesë e pazarit është që të mbahet në fuqi kodi zgjedhor dhe ndryshimet Kushtetuese të 2008-ës. Prandaj dua ta them edhe sot këtu, nuk kam hequr dorë nga ajo që kam shpallur edhe para vet zotit Berisha në mbledhje të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike që para disa vitesh, për shfuqizimin, hedhjen poshtë të ndryshimeve famëkeqe të Kushtetutës në vitin 2008, që i vunë minat një Republike me potencial demokratik dhe krijuan Republikën kryeministrale. Ja ku janë pasojat, korrupsion, emigracion,

shpopullim dhe një rini e cila nuk e gjen veten në Shqipëri. Ky është shqetësimi ynë kryesor”, deklaroi ai. Më tej kreu i demokratëve euroatlantik, Lulzim Basha tha se hapi i radhës i bashkëpunimit Rama-Berisha, është të pengojnë punën e SPAK-ut. Basha tha se pazarxhinjtë duan të largojnë nga kodi penal vepra të tilla si “shpërdorimi i detyrës”, të kufizojnë mundësitë e SPAK për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë. “Shqipëria meriton më shumë, ndaj programi jonë vjen me taksën e ulët, vjen me ndihmë për rininë shqiptare që të punësohet këtu me paga dinjitoze, vjen me luftë pa kompromis kundër korrupsionit, mbështetje pa kompromis për SPAK që t'i shkojë deri në fund çdo politikani të korruptuar. Pasurive të çdo politikani përmes ligjit tonë për vettingut të politikaneve. Tani po bëhen gati t'i vënë minat SPAK-ut. Hapi tjetër që shpërfaq dhe përmbledh dhe interesin e përbashkët të të dyve është godasin SPAK-un. Të largojnë nga kodi penal vepra të tilla si “shpërdorimi i detyrës”, të kufizojnë mundësitë e SPAK për t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë”, u shpreh Basha.

## Basha për akuzat e Berishës: Pasi i fali zgjedhjet Ramës, vazhdon të jetë aseti i vetëm i kryeministrit më të korruptuar në Europë

Kreu i demokratëve euroatlantik, Lulzim Basha, i është përgjigjur akuzave të Sali Berishës, nëpërmjet mediave që kontrollohen prej tij. Basha shprehet se Berisha është kthyer në asetin e vetëm të kryeministrit më të korruptuar të Europës. Sipas tij, mashtrimet linçimi gjuha e urretjes, janë e vetmja strategji që Berisha ka për të mbrojtur veten dhe për të mbajtur Ramën në pushtet, si mburojë për hallet e përbashkëta. “Pasi ia fali zgjedhjet Ramës në 14 Maj, po ashtu edhe në Kamëz me policin e radhës, Berisha përdor dordolecët e tij mediatik për të më sulmuar mua, ndërkohë që është kthyer në asetin e vetëm të kryeministrit më të korruptuar të Europës. Mashtrimet, linçimi gjuha e urretjes, janë e vetmja strategji që Berisha ka për të mbrojtur veten dhe për të mbajtur Ramën në pushtet, si mburojë për hallet e përbashkëta. Degradimi i jetës publike, në një rreth vicioz interesash, është një nga arsyet pse Shqipëria është kthyer në një vend të pajetueshëm. Ne nuk e pranojmë këtë, në veçanti kur akuzuesit janë në prerin e Ramës dhe turpërojnë veten intelektualisht me akuza boshe. Shqipëria meriton më shumë dhe do të ketë më shumë”, shkroi dje Basha në rrjetet sociale.

■ Nga ushtarakët, tek policët e arsimtarët, shtesa në pagë deri 53%

# Ja të dhënat zyrtare nga rritja e pagave, kush përfiton dhe kush përjashtohet, zbardhet roli që do të ketë vjetërsia në punë

Xhoana VRANIÇI

**M**e vendimin e qeverisë, prej 1 korrikut punonjësit e sektorit shtetëror do kenë rritje page. Për mësuesit paga mesatare do të shkojë në 950 euro. Me këtë rritje pagash të miratuar më 26 qershor 2024 paga mesatare në sektorin shtetëror arrin në 105 mijë lekë. Për këtë rritje të pagave, që është e fundit e reformës së ndërmarrë nga qeveria në vitin e kaluar, vetëm për periudhën korrik-dhjetor 2022 nga buxheti i shtetit do të shpenzohen afro 108 milionë euro për rritjen e pagave. Fatura do të rritet më tej në vitin e ardhshëm pasi për të mbajtur këtë nivel të ri pagash nga buxheti i shtetit do të shpenzohen afro 390 milionë euro. Paralelisht me këtë rritje, prej 1 janarit 2026, të gjitha pagat e sektorit shtetëror do të indeksohen me normën e inflacionit. Indeksimi i rrogave të administratës do të bëhet një herë në dy vite. Por për të mësuar më shumë rreth kësaj çështje, ka folur deputetja e Partisë Socialiste, Pranvera Resulaj, e cila ka shpjeguar me detaje se kush përfiton dhe kush përjashtohet nga administrata. Më poshtë po pasqyrojmë intervistën e zonjës Resulaj për televizionin "SCANTV".

## Sa është numri i përfituesve në rritje?

Kjo është në vijimësi të reformës së pagave, nisur që nga viti 2022 dhe pjesën më të madhe në 2023. Ne total, kemi një përfitues nga rritja e pagave, 135 mijë punonjës. Duke përfshirë edhe ata që janë në shërbim të drejtpërdrejtë të publikut, mjekë, infermier, mësues, policia e shtetit, forcat e armatosura, zjarrfikës, që janë të gjitha këto kategori që kanë përfituar më së shumti por gjithashtu dhe administrata qendrore. Për këtë vit, duke filluar nga 1 korriku, efekti që do të marrë është mbi 84 mijë përfitues por së bashku me përfituesit e 2023-it shkon në total prej 135 mijë punonjës. Po ashtu edhe efekti financiar është i ndarë. Nëse në vitin 2025 kur reforma të marrë të gjithë efektivitëtin e plotë të saj, kur të jetë e zbatueshme në të gjitha kategoritë e nivelet, efekti financiar është 31 miliardë lekë. Ndërkohë që për 2023-shin ky efekt ishte 17 miliardë dhe për 2024-ën në total do të jetë 22.1 miliardë. Vetëm efekti që kanë



me ndryshimin e pagave nga 1 korriku është sërish 11 miliardë lekë e shoqëruar me ndryshimet që do të vijnë deri në fund të vitit, ky do të jetë totali deri në 22.1 miliardë lekë. Rritje më të lartë në % dhe vlerë financiare, do të pësojë ajo kategori punonjësish të cilët janë paguar më pak deri tani, e vendin e parë e mbajnë mësuesit e ciklit të ulët.

## Janë 14 720 specialistë të administratës që përfitojnë një rritje prej ku varion nga 11%-16%

Nuk përfitojnë rritje ato të cilët kanë marrë maksimumin e rritjes vitin e kaluar, që do të thotë drejtorë, në hierarkinë e lartë të administratës publike. Duke u ndjekur ky parim, ata që kanë marrë maksimumin e rritjes më të lartë që në fazën e parë, nuk do të kenë një tjetër rritje, si dhe ata të cilët kanë përfituar 0-7% të pagës do të fillojnë me ndryshimet që janë në përqindje akumulative, duke filluar 2024 e duke u krahasuar me 2023-eshin, ka rritjen e vetë por në mënyrë akumulative.

## Shpjegim grafike

Kjo rritje e pagave që do të aplikohet për specialistët dhe që varion nga 11-16% dhe që hyn në fuqi prej datës 1 korrik, e çon në masën e përfitimit për specialistët e administratës publike deri në 113 mijë lekë, 102 mijë lekë, 91 mijë lekë dhe minimumi do të jetë 80 mijë lekë. Arsimtarët kanë një rritje prej 11-53% , kanë marrë në konsideratë vjetërsinë në punë. Bëhet fjalë për vjetërsinë mesatare, 15 vite. Kemi parasysh që në rritje është përfshirë paga bruto e cila bazohet mbi pagën sipas pozicionit dhe shtesat për kualifikimet.

## Mjekët e përgjithshëm dhe infermierët

Janë gati 15858 mjekë të përgjithshëm dhe infermierë të cilët do të marrin një rritje e cila shkon në një rritje nga 15 mijë lekë për person e deri në 20 mijë lekë. Fatura totale e rritjes vetëm për kategorinë e mjekëve shkon deri në 3 miliardë lek. Kjo rritje këtë herë është më standarde pasi herën e kaluar për 3 mijë mjekë e specialiteteve të ndryshme, duke marrë diferencën prej 50 mijë lekësh. Shkojnë në nivelet e pagave të mjekut 113 mijë lekë bazë. Është një rritje e cila është një rritje akumulative duke filluar nga 2023, kjo shkon në 23% rritja për mjekët. Ndërsa infermierët e kanë këtë rritje me 15 mijë lekë dhe shkon në një rritje akumulative në 27% dhe në vlerë paga bruto shkon në 87 mijë lekë në muaj.

## Punonjësit e policisë

15. 686 mijë policë të cilët do të përfitojnë një rritje të pagës bruto nga 13%-33%. Rritja mesatare e pagës merret në referim dhe në fokus kategoria më pak e paguar krahasimisht me kategoritë e tjera.

## Rritja e pagave për punonjësit e administratës lokale

Reforma e pagave kap dhe punonjësit e administratës lokale. Në 2023-shin, pagat e punonjësve të administratës lokale, njësitë e qeverisjes vendore, u rritën me 6 mijë lekë, që krahasuar me këto nivele pagash të rritura në krahasim me punonjësit e administratës qendrore, ka një diferencë goxha të madhe. Pjesë e reformës, zoti Mazniku është marrë dhe vetë me një ristrukturim e me një reformë strukturore në njësitë e

qeverisjes vendore, në mënyrë të tillë që edhe ata do të kenë një kategorizim të ri të nivelit të pagave, për të ngushtuar diferencën e madhe midis pagave në nivel qendror me ato të nivelit të një punonjësit në pozicionin lokal. Punonjësit e Bashkive në nivel lokal janë më pak të paguarit në krahasim me punonjësit në nivelin e bashkisë së Tiranës, ku radhitet si bashkia më e madhe. Në informacionet që unë kam, është një draft ku kategorizon bashkitë në vend në tre nivele. Bashkia e Tiranës dhe dy nivele të tjera të bashkive. E rëndësishme të theksojmë është edhe diferenca e pagave, ku njëra kategori nga tjetra, do të jetë vetëm 10%, për ta bërë sa me të ngushtë hendekun mes tyre. Nga ana tjetër, edhe sektori privat duke parë këto rritje pagash në administratën publike do të detyrohet që të bëjë reforma të reja për një rritje pagash. Janë normat e tregut, ata që e vendosin ku si e tillë nuk ka asnjë lloj imponimi apo detyrimi sepse sektori publik nuk mund të imponojë edhe sektorin privat për ndryshimin e pagave. Por nëse tregu bëhet konkurrues, atëherë sigurisht që edhe rritja e pagave do të shoqërohet.

## A do të ndikojë rritja e pagës edhe në rritjen e performancës

Është ndryshe kur flasim për sektor prodhues dhe në për sektorin e shërbimeve të drejtpërdrejtë duhet të ketë edhe një rritje të performancës së punën në mënyrë paralele me rritjen e temperaturave. Duhet të kemi realisht një reformë të mirëfilltë në administratën publike për rritjen e pagave, në mënyrë të tillë që t'i përshtatet jo vetëm digjitalizimit të shërbimeve, jo vetëm pritshmërive të publikuar por duhet të presim me domosdoshmëri dhe një rritje të performancës te punonjësit në administratën publike.

## Forcat e Armatosura

Rritja e pagës varion nga 7-20%, por duhet të kemi parasysh që është e njëjta tendencë që është ndjekur, ku për gradat më të larta që kane forcat e armatosura, vjen duke u ulur në nivel. Duke filluar me vlerën e 8% nga forcat admiral e me rradhë deri te niveli me i lartë.

## Vëmendja

Mendoj se kjo është risia e reformës së pagave përtej asaj që është anonçuar që prej vitit të kaluar duke i dhënë fokus ngushtimit të hendekut të pagave mes niveleve qendrore dhe asaj lokale.

**Rriten me afro 10.5% kontratat e sigurimit, në 5 muajt e parë të vitit u arkëtuan 9,3 mld lekë**

Tregu i sigurimeve ka përjetuar një rritje të fortë gjatë pesë muajve të parë të vitit, si për sa i përket volumit të arkëtimeve, ashtu edhe numrit të kontratave të sigurimit. Të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare tregojnë se të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar – maj 2024 kapën vlerën 9,3 miliardë lekë, ose 4.52% më shumë se në janar – maj 2023. Gjatë kësaj periudhe të parë të vitit, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 557,938, me një rritje prej 10.46% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tregu mbetet i orientuar te sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.91% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës vetëm 9.04% dhe risigurimi 0.042%. Nëse bëjmë një krahasim të ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, rezulton se primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 42.91% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë gati 58% të totalit të tregut. Nga janari deri në maj 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve ishin 32.27% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, konkretisht 3,4 miliardë lekë. Sa i takon dëmet të paguara bruto në sigurimin motorik për 5 muajt e parë të vitit, ato kapën vlerën 2,4 miliardë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 25.46% krahasuar me janar – maj 2023. Pagesat e dëmeve gjatë muajit janar – maj 2024 u rritën me 26.45%, ndërsa pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1,9 miliardë lekë apo 70% të totalit të dëmeve të paguara bruto.



■ Opozita ngre akuza për manipulim të dhënash të Censi

# Dështon Censi i popullsisë, nuk është anketuar më shumë se gjysma e shqiptarëve, ja skandali i drejtoreshës së INSTAT, hidhen në erë 16.9 milionë euro për të nxjerrë shifra të falsifikuara

Elmas BOGDANI

**D**rejtoresha e Institutit të Statistikave, Elsa Dhuli ka shpërdoruar 16.9 milionë euro për të nxjerrë shifra të falsifikuara për numrin e saktë të popullsisë në Shqipëri. Nga këto para 9.35 milionë euro janë marrë nga Buxheti i Shtetit, 4.8 milion euro janë donacione nga Bashkimi Evropian, 1.59 milion euro nga SIDA, 726.7 mijë euro nga SDC dhe 16.9 mijë nga UNFPA. Dyshimet për manipulimin e rezultateve të Censit u përforcuan për shkak të vonesës së publikimit të rezultateve. Intervistimi i popullsisë nisi në shtator dhe supozohej të zgjaste vetëm 6 javë. Por pas mbylljes së procesit u tha se rezultatet do të publikoheshin në datën 19 Qershor. Më vonë, drejtoresha e Instat e shtyu akoma më tej shpalljen e rezultateve deri dje në 28 Qershor.

## Detajet

Edhe pse nuk u anketua më shumë se gjysma e shqiptarëve, në raportin e INSTA doli se gati gjysmë milioni shqiptarë janë larguar nga Shqipëria përgjatë dymbëdhjetë viteve të fundit, një shifër marramendëse që pritet të hapë një debat më të gjerë mbi shkaqet dhe pasojat, përfshirë cilësinë e qeverisjes dhe llojin e sistemit politik që shtyn kaq shumë njerëz të lënë vendin e vet për ta nisur jetën nga e para në një vend tjetër. Të dhënat e publikuara nga Instituti i Statistikave tregojnë se numëruarit e Censit të dymbëdhjetë në historinë e shtetit shqiptar, popullsia rezidente ishte 2,402,113 banorë. Dymbëdhjetë vjet më parë, në Censin e vitit 2011, popullsia faktike ishte 2.8 milionë banorë



## Korça me uljen më të pakët të popullsisë

Në vitin 2011, Korça numëronte 75,994 banorë, sipas të dhënave të Censit të atij viti. Pas dymbëdhjetë vjetësh, popullsia e qytetit ka pësuar një rënie, duke arritur në 60,754 banorë në vitin 2023. Ky ndryshim tregon një tkurrje të ndjeshme të popullsisë, një fenomen që ka prekur të gjithë vendin në mënyra të ndryshme. Megjithatë, Korça paraqitet më mirë se pjesa më e madhe e qyteteve të tjera të Shqipërisë për sa i përket shkallës së uljes së numrit të popullsisë. Ndërsa qytete të tjera kanë përjetuar rënie dramatike dhe të shpejtë të popullsisë, Korça ka ruajtur një stabilitet relativ në këtë aspekt.

ndërsa shtesa natyrore për periudhën 2012-2023, pra diferenca mes qytetarëve të lindur dhe atyre të vdekur, është 88 mijë vetë. Kjo do të thotë se në rast se Shqipëria nuk do të kishte emigrim, popullsia do të shtohet me 88 mijë vetë në vend që të tkurret me 400 mijë. Numri i shqiptarëve që kanë përjetuar emigrimin ka gjasa që është më i lartë se sa kaq për shkak se në

## 99.4% e popullsisë janë me kombësi shqiptare

Janë publikuar të dhënat bazë të Censit 2023 sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë. Në bazë të dhënave 99.4% e popullsisë janë me kombësi shqiptare. Shqiptarë 2.186.917  
Grekë 23485  
Egjiptianë 12375  
Pa përgjigje 13.507  
S'disponohet përgjigja 134 451

popullsinë rezidente 2023, përfshihen edhe shqiptarët që emigruan në dekadat e mëparshme dhe u rikthyen në vend në dekadën e fundit. Këto janë vetëm rezultatet e para, pasi INSTAT do të publikojë në tetor një platformë me të gjitha të dhënat e detajuara në nivel bashkie. Kësisoj vonesa zgjatet për thujse një vit, pa një arsye të qenësishme. Dyshimet shtohen pasi në Kosovë rezultatet e Censit u publikuan për rreth një muaj pasi përfundoi procesi.

## Opozita ngre akuza për manipulim të dhënash të Censit

Edhe opozita ngriti dje akuza për manipulim të dhënash të Censit. Sipas Ines Nurja, drejtuese e departamentit të statis-

## Censi 2023, 54 % e popullsisë të martuar, 36% beqarë

54.9% e popullsisë në vendin tonë në bazë të të dhënave të Censit 2023 rezultojnë të martuar. Sipas Censit, 54,9 përqind e popullsisë rezultojnë i/e martuar, 36,6 përqind janë ende beqar, 7,0 përqind kanë status "I/e ve" dhe 1,4 përqind e divorcuar ose e ndarë. Deri në moshën 30 vjeç, përqindja e individëve beqar është më e lartë. Pas moshës 30 deri në 85 vjeç, rritet përqindja e personave të martuar, duke arritur pikun me rreth 88 përqind në grupmoshën 45-64 vjeç. Pas moshës 65 vjeç e lart, përqindja e individëve të ve, ka një rritje të konsiderueshme. Statusi martesor: 54.9% të martuar, 36.6% beqar, 7% i ve 1.4% të divorcuar.

tikave në Partinë Demokratike janë manipuluar të dhënat si me numrin e popullsisë ashtu dhe me atë të banesave. "Sipas INSTAT popullsia në Shqipëri është 2.4 milionë dhe për 12 vjet janë shtuar vetëm 70 mijë banesa. Ky është një mashtrim krye e këput", tha ajo në një konferencë për shtyp. Sipas Nurjes, janë të dhënat nga EUROSTAT që sugjerojnë se nga Shqipëria janë larguar mbi 900 mijë banorë vetëm në vendet e Bashkimit Evropian, shifër që bie ndesh me shifrën popullore të nxjerrë nga INSTAT. "E dyta, numri i banesave nuk mund të jetë shtuar vetëm me 70 mijë për 12 vite sepse në një llogaritje të thjeshtë vetëm në Tiranë për 3 muaj Erjon Veliaj ka dhënë 231 mijë metra katrorë për ndërtim", tha

më tej zyrtarja e PD-së. "Shifra të trukuara" i cilësoi të dhënat dhe kreu i Partisë së Lirisë, Ilir Meta. Nga ana tjetër, ish-kryetari i PD, Lulzim Basha tha se censi i publikuar dje nga INSTAT ishte i arnuar, zvarritur, i deformuar dhe jo transparent, si asnjëherë më parë e si në asnjë vend tjetër të botës. "Shpopullimi i vendit, i fshehur pas arnave të një Censit të zvarritur, të deformuar dhe jo transparent, si asnjëherë më parë e si në asnjë vend tjetër të botës,

## Censi 2023, publikohen të dhënat e besimit fetar

Janë publikuar të dhënat e besimit fetar në bazë të deklaramëve në kuadër të Censit 2023. Nga të dhënat sipas besimit fetar, vendi rezultojnë me shumicë myslimane, pra me mbi 1.1 milionë banorë, më pas besimi Katolik me mbi 200 mijë banorë dhe më pas besimtarë Ortodoks me mbi 173 mijë banorë. Rezultojnë se ka një numër të lartë banorësh që nuk janë përgjigjur, apo nuk janë cilësuar. Besimi Fetar Mysliman 1.101.718 Mysliman-Bektashi 115.644 Krishterë-katolikë 201.530 Krishterë - Ortodoks 173.645 Ungjillore 9658 Tjetër besim 3670 I pacilësuar 332.155 Ateist. 85.311 Nuk përgjigjen 244.331 Nuk disponohet 134.451

është produkt i drejtpërdrejtë i një qeverie të korruptuar që punon për interesat e një grushti të vogël njerëzish, duke lënë në varfëri familjet shqiptare, që mpaken vit pas viti. Eksodi masiv i shqiptarëve nuk e shqetëson qeverinë, as thagmat korruptive që po i bëjnë gjëmën vendit, si skandali dramatik i Onkologjikut, apo i dhjetëra zezonave të tjera që e kanë bërë vendin të pajetueshëm. Shqipëria nuk meriton shpërbërjen e saj, shpërbërjen e familjes, largimin e rinisë, plakjen e popullsisë. Që kjo hemorragji të ndalë, kërkohet një ndryshim i menjëhershëm dhe rrënjësor. Shqipëria meriton më shumë, prandaj ne kemi prezantuar përpara shqiptarëve një plan konkret dhe reformues, që lufton korrupsionin dhe siguron mirëqeverisjen, për t'u dhënë shqiptarëve alternativën që meritojnë", përfundoi Basha.

## 32% e popullsisë shqiptare jeton në Tiranë

Në bazë të të dhënave të publikuara nga Censi 2023, 32% e popullsisë jeton në qytetin e Tiranës. Përafërsisht një e treta e popullsisë shqiptare (31,6 përqind) banon në qarkun e Tiranës. Qarku i dytë me përqindjen më të lartë të popullsisë është Fieri me rreth 10,0 përqind, ndjekur nga qarku i Elbasanit me 9,7 përqind ndaj popullsisë gjithsej. Kukësi dhe Gjirokastra kanë përqindjen më të ulët, me 2,6 dhe 2,5 të popullsisë respektive. Në të gjithë qarqet, me përjashtim atë të Tiranës, popullsia ka ardhur në rënie përgjatë periudhës 2011-

2023, në një rang ndryshimesh prej 28,3 përqind në qarkun e Shkodrës dhe 27,3 përqind në qarkun Kukës, deri në 0,7 përqind në qarkun e Beratit. Shprehur në vlerë absolute, Elbasani dhe Shkodra kanë pësuar rënien më të lartë të popullsisë. Në anën tjetër, popullsia e qarkut Tiranë është rritur me 1,2 përqind, më së shumti prej migracionit të brendshëm. Rritja e popullsisë në Tiranë dhe rënia në qarqet e tjera rezultojnë në rritjen e përqindjes së popullsisë banuese në Tiranë, nga 26,8 përqind në 2011 në 31,6 përqind në 2023.

## Mbi 204 mijë banorë në Shqipëri me master

Të dhënat e censit tregojnë se 96,8 përqind e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart kanë përfunduar ose janë duke ndjekur shkollën, 97,2 përqind meshkuj dhe 96,4 përqind femra. Përqindja e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart që nuk ka ndjekur asnjëherë shkollën ka rënë nga 4,1 përqind në Censin e vitit 2011 në 3,2 përqind në Censin e vitit 2023. Më shumë se gjysma (55,0 përqind) e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart kanë përfunduar arsimin e mesëm ose arsimin e lartë. Për popullsitë përkatëse meshkuj dhe femra, kjo shifër është 57,9 përqind dhe 52,1 përqind. 38,8 përqind e popullsisë 15 vjeç e lart

ka përfunduar arsimin e mesëm të ulët, dhe 34,8 përqind kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, i konsideruar dhe si niveli minimal që ndihmon individët të kenë një pjesëmarrje të plotë në shoqëri dhe për të jetuar një jetë të plotë. Rreth 0,6 përqind e popullsisë 15 vjeç e lart nuk ka përfunduar asnjë nivel arsimor. Vërehet një rritje në përqindjen e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart me arsim të lartë të përfunduar (universitar dhe pasuniversitar) nga 10,7 përqind në Censin e vitit 2011 në 20,2 përqind në Censin e vitit 2023. Nga popullsia gjithsej me arsim të lartë të përfunduar, 55,7 përqind janë femra dhe 44,3 janë meshkuj.

# aktualitet

## Dialogu për Reformën Zgjedhore drejt dështimit, PS s'pranon kërkesën e PD për rikthim të koalicioneve

Pas 3 muajsh funksionimi grupi i negociatorëve nuk kanë arritur të hartojnë një draft të përbashkët ndryshimesh për Kodin Zgjedhor, ku përfshihen çështje për të cilat ka vendime të Gjykatës Kushtetuese, si vota e diasporës dhe përcaktimi i herësit në listat e kandidatëve. Duket se shkaku i mosmarrëveshjeve gjendet dikur tjetër, tek kërkesa e Partisë Demokratike për të rikthyer në fuqi një marrëveshje të vjetër të qershorit 2020, e cila u rrëzua me ndryshimet kushtetuese po atë vit që PS i votoi me një grup deputetësh opozitarë të

dalë nga listat shumëemërore pas dorëzimit të mandateve të PD-së dhe LSI-së. Bashkëkryetari i Reformës Zgjedhore, njëherësh deputeti i PD, Oerd Bylykbashi ka vendosur si kusht për konsensus rikthimin në kod të koalicioneve parazgjedhore, kusht që sipas Gjykatës nuk mund të mbajë peng gjithë reformën zgjedhore dhe zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. "Një nga çështjet që kemi shtruar nga platforma është rikthimi të marrëveshjes së 5 qershorit të vitit 2020, nënshkruar me konsensus nga PS dhe PD dhe mbështetur nga nivelet

më të larta të diplomacisë", deklaroi Bylykbashi për mediat dje. Sipas tij, "Rama e di që koalicioni kthen në pushtet opozitën, prandaj po mban peng reformën që të mbajë pushtetin me dhunë". PD i ka dërguar propozimin e saj zyrës së OSBE/ODIHR në Tiranë për të marrë një qëndrim të ekspertëve të huaj. Por, për Partinë Socialiste kjo është një kërkesë që nuk ka lidhje me reformën aktuale, e cila sipas, bashkëkryetarit të Reformës Zgjedhore, njëherësh deputeti i PS, Damian Gjijnuri. Vendi nuk mund të rrihet peng i 5 qershorit, theksoi dje ai për

mediat pas takimit të grupit të dialogut duke akuzuar opozitën se nuk kishte pranuar as propozimet për numërim elektronik në qarqet kryesore dhe zgjidhjet për votën e emigrantëve. Ai tha se ka ofruar gatishmërinë për të adresuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. "E para ka të bëjë me votën e diasporës, e dyta është herësi, shpërndarja brenda forcave politike. Do të dalim me propozimet tona për shpërndarjen e mandateve. Nëse nuk bihet dakord, lista mund të interpretohet nga KQZ si e hapur plotësisht", nënvizoi Gjijnuri. Reforma zgjedhore

kërkon një votë të cilësuar me konsensus politik në Kuvend gjë e bën të pamundur çdo vendim të njëanshëm për të ndryshuar dispozitat ligjore. Një komision i posaçëm për Reformën Zgjedhore u ngrit nga Kuvendi dhe për 2 vite nuk arriti asnjë rezultat për shkak të balancave politike brenda opozitës, pasi grupimi i drejtuar nga ish-kryeministri Sali Berisha nuk përfaqësohej nga bashkëkryetari i këtij komisioni, Enkelejd Alibeaj. Por, edhe dialogu në një grup pune të ngushtë dhe larg syve të publikut duket se gjithashtu s'po jep rezultat.

### SPAK rëndon akuzat ndaj Jorgo Goros

## Kryetari i komanduar i Bashkisë Himarë Arqile Bollano në hetim nga SPAK, ja si përfitoi rreth 14 mijë m<sup>2</sup> tokë në vitin 2015, zbardhen detaje nga dosja "përvëluese" që kanë në duar prokurorët specialë

Rigels SELIMAN

Prokuroria e Posaçme (SPAK) ka rënduar pozitën ndaj ish kryebashkiakut të Himarës, Jorgo Goro. Sipas gazetares Anila Hoxha, në kohën kur Jorgo Goro vijon të jetë në arrest me burg për skandalin e tjetërsimit të tokave, SPAK i ka kërkuar GJKKO vendosjen e sekuestros për 4 hektarë tokë në bashkinë e Himarës. Nga prokuroria e Vlorës është konstatuar se aty është hetuar dhurimi i 4 hektarëve tokë në adresë të një tjetër kryetari bashkie i cili u votua për shkak se Beleri ishte në burg, ishte falur kryebashkiakut Arqile Bollano, i cili nuk është pyetur ende nga SPAK. Është kryebashkiaku i tretë i cili duket sikur do të ketë të njëjtin fat. "Nga prokuroria e Vlorës është hetuar dhurimi i 4 hektarëve tokë në adresë të një tjetër



kryetari bashkie, i cili u votua për shkak se Beleri ishte në burg, 4 hektarët tokë i janë falur kryebashkiakut Arqile Bollano, i cili nuk është pyetur ende nga SPAK. Është kryebashkiaku i tretë i cili duket sikur do të ketë të njëjtin fat", tha Hoxha. Hetimi është bërë nga prokurori i Vlorës, Arjan Xhaferri, i cili shpalli mos kompetencën dhe ia dërgoi çështjen SPAK-ut.

### BIRN zbardh detaje nga dosja

Por detaje rreth kësaj afere ka zbardhur edhe "BIRN". "Përfitimi i rreth 14 mijë m<sup>2</sup> tokë në Himarë në vitin 2015 nga familja e kryetarit aktual të Bashkisë së Himarës, Arqile Bollano, të komanduar në këtë pozicion tre javë më parë, është duke u hetuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, SPAK.

Dosja është transferuar për kompetencë në SPAK nga Prokuroria e Vlorës rreth një muaj e gjysmë më parë, pas hetimit të një sërë procedurash për dhënie e tokës familjeve bujqësore nga Bashkia Himarë, që dyshohet se janë abuzive. BIRN mësoi se, gjatë procedurave të ndërrmarra në vitin 2015 nga Bashkia e Himarës, për plotësimin me tokë bujqësore të familjeve që kishin marrë sipërfaqe të mangëta gjatë ndarjes së tokës në vitin 1992 sipas ligjit 7501, ka pasur përfitime të pamërituara nga disa familje, mes tyre dhe ajo e kryebashkiakut aktual, Arqile Bollano. Me vendim të këshillit bashkiak, pasi shqyrtoheshin kërkesat e familjeve që pretendonin se u ishte ndarë më pak tokë nga sa u takonte, merrej vendim për plotësimin e deficiteve. Mes përfituesve ka qenë dhe familja e Arqile Bollanos, që mësohet të ketë përfituar 14 mijë m<sup>2</sup> tokë që, sipas përlogaritjeve, nuk i takonte. Në vitin 2015, Bashkia e Himarës drejtohej nga socialisti Jorgo Goro, i cili u ndalua në mars të këtij viti me urdhër të SPAK, pasi dyshohet se

në bashkëpunim me vartës dhe zyrtarë të Kadastrës, nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara, kanë mundësuar kalimin e sipërfaqeve të konsiderueshme tokë shtet në Himarë, në favor të privatëve, pasuri që u morën nga një shoqëri e zotëruar nga Artan Gaçi, bashkëshorti i deputetes socialiste Olta Xhaçka, i cili ka fituar statusin e investitorit strategjik. Goro i cili garoi për një mandat të katërt nën siglën e Partisë Socialiste për Bashkinë e Himarës në maj të vitit të kaluar, vijoi ta ushtronte detyrën megjithëse fitues u shpall rivali i tij, Alfred Beleri. Ky i fundit nuk arriti të kryente betimin pasi u arrestua dy ditë para zgjedhjeve për "Korrupsion aktiv në zgjedhje", vepër penale për të cilën u deklarua fajtor dhe u dënua me 2 vjet, masë që mori formë të prerë në Apel më datë 25 qershor. Pas ndalimit të Goros, Këshilli i Bashkisë Himarë komandoi në detyrën e kryetares Blerina Balën, e cila u dorëhoq në fillim të qershorit. Më 7 qershor ajo u zëvendësua nga Arqile Bollano, edhe ky si i komanduar", thuhet në shkrimin e BIRN.

### Ministrja Anila Denaj në Kosovë: Forcojmë bashkëpunimin në sektorin bujqësor mes dy vendeve

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj zhvilloi një vizitë zyrtare në Kosovë, ku u prit në një takim nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, me të cilin bisedoi për forcimin e bashkëpunimit në sektorin bujqësor mes dy vendeve. Në një deklaratë të përbashkët për shtyp pas takimit, Denaj tha, se "midis vendeve tona ka eksperiencë për t'u ndarë. Besoj çfarëdo eksperiencë që Shqipëria ka realizuar këto muajt e fundit dhe vitet e fundit në procesin screening mund të shërbejë si një eksperiencë për ju në të ardhmen". Ne, vijoi Denaj, jo vetëm na bëjnë krenarë për atë çfarë kemi arritur, por njëkohësisht na mundësojnë një këmbim më të rritur të shkëmbimet tona tregtare. "Këtë

vit shkëmbimet tregtare janë rritur me 15% dhe dua të prioritozohet disa nga produktet që ende kanë hapësirë për t'u këmbyer më shumë, siç janë bimët aromatike dhe medicinale, për të cilat ne po marrim edhe akreditimin më të fundit nga agjencia jonë ISUV", shtoi Denaj. Kjo agjencia, shtoi Denaj, është po aq e rëndësishme për t'u ndërlidhur me institutet tuaja dhe ku disa nga këto shërbime mund t'i shërbejnë bizneseve të dy vendeve për të njëjtin funksion për kosto më të optimizuar. "Kemi vajin e ullirit, që gjithashtu po njeht një transformim në Shqipëri dhe ku mund të marrim modelet më të mira që sot do të shohim sëbashku për të implementuar në një sistem që do të jetë efektiv", tha Denaj. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe

Zhvillimit Rural i Kosovës, Faton Peci tha, se gjatë takimit diskutuan për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural si dhe shkëmbimin e përvojave mes dy vendeve. "Siguria ushqimore është pjesë e sigurisë kombëtare. Ne angazhohemi për rritjen e shkëmbimit tregtar dhe prodhimin midis dy vendeve tona", tha Peci. Ministri Peci theksoi se "sa i përket shkëmbimit tregtar që Kosova ka me Shqipërinë, sektori i bujqësisë në tre vitet e fundit ka shënuar rritje dhe progres". Peci u shpreh se bashkë me homologen Denaj do të vizitojnë vreshtat e Rahovecit dhe malet e Rugovës, "për shkak se turizmi malor i Kosovës është ai që mund të jetë pjesa komplementare e turizmit që është me ngritje shumë domethënëse dhe në Republikën e Shqipërisë".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE  
DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

## NJOFTIM

### PËR FILLIMIN E PROCESIT TË QIRADHËNIES, FIER

Në zbatim të Vendimit Nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", i ndryshuar, kreu IV "Procedurat që ndiqen për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit", pika 4.1, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton fillimin e procesit për dhënie me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pasuritë me me Nr. 21/16; Nr. 21/15; Nr. 20/19; Nr. 143; Nr. 144; Nr. 360; Nr. 364; Nr. 365; Nr. 369; Nr. 390, Zona Kadastrale Nr. 3358, me vendndodhje në fshatin **Sheq Marinës, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier**".

## “Në rrugën e babait”, ndër 8 trashëgimtarët e “yjeve” edhe portieri Strakosha

Europiani i Gjermanisë ka mbyllur një etapë të tij, atë të grupeve, ku u përcaktuan edhe 16 ekipet që vijuan në raundin e dytë, atë të 1/8 e finales që është me eliminim direkt. Duhet thënë se në fazën e grupeve spikatën disa lojtarë, përfshi këtu dhe lojtarë të Kombëtares së Shqipërisë, si Nedim Bajrami për golin më të shpejtë, Ylber Ramadani për sasinë e kilometrave të vrapuara në të tri ndeshjet në grupe, por edhe Thomas Strakosha në top-10 portierët më të mirë. Ndërkohë, mediat europiane kanë zgjedhur emrat e 8 futbollistëve që janë në rrugën e baballarëve të tyre, pra ka spikatur babai, po spikat dhe

i biri e kjo është vërtet interesante dhe në këtë listë është edhe Strakosha ynë. “Plot 8 futbollistë të Euro 2024 në rrugën e baballarëve të tyre”, shkruajnë mediat. Futboli është një pasion që trashëgohet, si në rastin e Thomas Strakoshës, i cili gjithashtu si babai i tij Foto Strakosha, arriti të vishte fanellën e kombëtares shqiptare. Madje në të njëjtin rol, atë të portierit. 73 ndeshje regjistroi Foto mes shtyllave të Kombëtares Shqiptare, 31 numëron Thomas deri tani. 29-vjeçari i Brentfordit në Premier League, i luajti si titullar tri sfidat e kuqezinjve në grupin B të Euro 2024. “Gardiani” shqiptar bëri

mirë në duelet kundër Italisë, Kroacisë dhe Spanjës. Por edhe 7 lojtarë të tjerë, njësoj si baballarët e tyre, kanë arritur të bëhen pjesë e ekipeve kombëtare. Në listën e veçantë të djemve të artë bëjnë pjesë emra si Federiko Kieza, Markus Thuram dhe Kasper Schmeichel. Por edhe Marsel Sabitzer, nënkampion Europe me Dortmundin dhe një nga “shtyllat” e Austrisë frymëzuese të Rangnik. Nuk mungon Daley Blind, i cili mbylli një sezon ëndrrash me Xhironën në La Liga. Duke u kthyer tek Strakosha, duhet thënë se ai pati tri paraqitje shumë të mira në ndeshjet që luajti në grupin B të Europeanit.



Sulmuesi dhe mesfushori optimist për rritje të mëtejshme të kuqezinjve në garat e ardhshme

## Jasir Asani sheh Shqipërinë të aftë të shkojë në Botëror, Medon Berisha krenar që përfaqësoi kombin në European

Adriatik BALLA

Lojtarët e Kombëtares janë shpërndarë nëpër familjet e tyre dhe po shijojnë pushimet, para se të kthehen për pak ditë e të rigrumbullohen, por këtë herë jo me përfaqësuesen por me klubet e tyre respektive. Pas eliminimit nga Europeani, kanë folur me radhë kuqezinjët, ku kanë dhënë emocionet e tyre dhe kanë folur rreth forcës së grupit, si dhe kanë treguar optimizmin e tyre se Shqipëria do të mund të kualifikohet edhe në Botërorin e vitit 2026.

### Jasir Asani komenton forcën e Shqipërisë

Të gjithë prisnin një gol si ato të ndeshjeve kualifikuese nga Jasir Asani, por edhe pse anësori e tentoi disa herë, diçka e tillë nuk u realizua. Siç thotë edhe vetë Jasiri në intervistën për Panorama Sport, do e kishte ndërruar një gol të eliminatorëve me një ndeshje të Europeanit. Megjithatë, një performancë në përgjithësi e mirë për 29-vjeçarin, ku loja më e mirë ishte kundër Kroacisë, madje dha edhe një asist për Laçin, si edhe nxori Asllanin vetëm me portierin, të cilin nuk e mposhti



dot. Ndërkohë, Asani jep edhe një koment në lidhje me të ardhmen, ku flitet se do të firmosë për ekipin e Las Palmas-it në La Liga. “Me Spanjën bëmë një ndeshje të mirë. Nuk ishim pasivë, por përballë kishim një ekip shumë të fortë. Motorët i ndezëm që në minutën e parë, por të gjithë e dinë që ishte Spanja dhe dhamë maksimumin dhe iu treguam se nuk është aq e lehtë që të na mposhtësh si ekip. Kemi pasur edhe raste për të barazuar. Gjithsesi, është një eksperiencë nga më të mirat në karrierë”, theksoi Asani. Pyetjes se a mund Shqipëria të bënte më

shumë në këtë European, sulmuesi kuqezi u përgjigj se Kombëtarja bëri më të mirën e vet në këtë European. Mendoj se çdo ndeshje ka maksimumin e vet sepse me tre skuadrat që jemi përballur, janë nga më të mirat në botë dhe normalisht që do të ketë ndonjëherë edhe vështirësi, kundër Spanjës, Kroacisë apo Italisë. Me pak fat, po t’i kishim marrë ato tri pikë me kroatët, do të ishim më të qetë dhe kishim më shumë shanse për të vazhduar më përpara, por gjithsesi të gjithë lojtarët kanë dhënë maksimumin dhe shpirtin në fushë. Kjo është një eksperiencë

për ne që të vazhdojmë akoma edhe më përpara”, shtoi Asani. Në fund ai foli për golat e bukur që ka shënuar në eliminatorë, por që të gjithë do t’i dhurojnë për një gol në European. “Do të doja shumë, por gjithsesi jam i lumtur edhe për golat që shënuam, sepse jemi të gjithë bashkë dhe dhamë shpirtin në fushë e tani duhet të ecim përpara sepse kjo ishte një eksperiencë që nuk do të harrohet asnjëherë dhe na shtyn që të shkojmë tutje edhe për në Botëror”, theksoi ai.

### Qëndrimi/ Medon Berisha: Nder që përfaqësova kombin në European

Medon Berisha vendosi rekordin si lojtari më i ri shqiptar që luan në një European. Mesfushori u aktivizua në ndeshjen me Spanjën duke debutuar me fanellën kuqezi në një turne madhor. Nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale ai shkruan: “Ndihe shumë i lumtur dhe falënderues për të gjithë eksperiencën në ‘Euro 2024’. Nuk ka fjalë që të përshkruaj krenarinë dhe emocionin për të përfaqësuar kombin tim në këtë garë madhështore. Faleminderit të gjithëve”, ishin fjalët e 20-vjeçarit.

### QËNDRIMI

Mediat e huaja thonë se Silvinjo do të largohet nga Shqipëria

Mediet spanjolle raportojnë se loja e Shqipërisë në Kampionatin European, Gjermani 2024, ka bërë që puna e Silvinjos të tërheqë vëmendje. Ndërsa i ka mbetur edhe një muaj nga përfundimi i kontratës me FSHF braziliani ende nuk ka firmosur rinovimin, që siç deklaroi para pak ditësh Armand Duka i është propozuar që në janar. Duka siguroi pak ditë më parë se nuk do të ketë probleme për vazhdimin e kontratës së trajnerit, në përgatitje të eliminatorëve të Botërorit, pasi vullneti është i dyanshëm.

### SUPERIORE

Partizani dhe Egnatia ende s’kanë bërë blerje

Partizani nuk po ndihet aspak me blerje në merkato, strategji apo pret më parë të bëjë shitje? Ndryshe nga çfarë ka ndodhur në merkato të shkuara, të kuqtë nuk kanë blerë asnjë lojtar dhe me shumë mundësi kjo nuk pritet të ndodhë nëse nuk do të ketë shitje të mëdha të lojtarëve si Rrapaj, Maget apo dikush tjetër. Në fakt duhet shtuar se asnjë klub, përfshirë edhe Egnatian kampione, nuk ka blerë lojtarë në këtë sezon, por i kanë afruar me parametra zero. Mbetet të shihet si do të jetë ecuria e tyre në merkato.

### NDESHJA

Shqipëria U-20 barazon me Irakun në turneun arab

Shqipëria U20 zhvilloi dje ndeshjen e dytë në turneun “Al Dyar Al-Arabiya EAFF U19 Championship – KSA 2024” në Arabinë Saudite. Ku kuqezinjët marrin pjesë së bashku me Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabinë Saudite, Jordaninë, Kuvajtin, Jemenin, Libanin, Palestinën, Irakun, Sirinë, Bahrainin dhe Omanin. Skuadra e drejtuar nga Alban Bushi, në ndeshjen e dytë të grupit B u përball me Irakun. Kjo sfidë përfundoi në barazim 1-1. Golin e vetëm për kuqezinjët e shënoi Flavio Sulejmani.

## Brojën nuk e do vetëm Milani, në garë futet edhe Juventus

Paraqitja e kuqezinjve në Europeanin e Gjermanisë u ka rritur atyre vlerën e kartonit në treg dhe tani janë më të kërkuar. Kjo pasi Europeani është një vitrinë për çdo futbollist dhe padyshim ndihmon lojtarët pjesëmarrës të kenë më shumë shanse për të gjetur në treg ekipe më cilësore në top-ligat europiane. Armando Broja ka qenë tema e merkatos në Itali në periudhën e fundit. Për sulmuesin e Kombëtares shqiptare, ka shprehur interesim të hapur vetëm klubi i Milanit, ku ju rikujtojmë që në ndeshjen që

Shqipëria pati në Dortmund kundër Italisë, në stadium ndodheshin persona të dërguar nga klubi milanez për të parë nga afër Brojën. Përveç Milanit, tani në skenë për 22-vjeçarin ka dalë edhe Juventus. “Zonja e Vjetër” është në kërkim për zëvendësuesin e Vlahoviçit, dhe trajneri i ri i bardheznjive, Tiago Mota, ka propozuar transferimin e Brojës. Në planet e Juventusit ka qenë edhe Retegui, por Sampdoria kërkon 40 milionë euro për kartonin e tij, ndërsa Broja ka një vlerë që kap shifrën e 22 milionë eurove,



një alternativë më e lirë për ta. Kujtojmë që Broja luajti vetëm 1/3 re minutave në këtë European, madje në ndeshjen ndaj Kroacisë nuk u aktivizua.

# rajon

## Takimi i radhës për dialogun Kosovë-Serbi më 2 korrik, Petkoviç: Nuk pres asgjë

Drejtori i të ashtuquajturës Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petkoviç ka paralajmëruar vazhdimin e dialogut Beograd-Prishtinë në nivel teknik për javën e ardhshme, duke thënë se nuk pret asgjë nga takimi. Sipas Petkoviç ata insistojnë në formimin e Unionit të Komunave Serbe. Ai shtoi se kjo është shumë e rëndësishme për mbijetesën e serbëve në Kosovë dhe të ardhmen e tyre. Petkoviç theksoi se ata do të

bëjnë gjithçka për të ruajtur paqen dhe stabilitetin me një qasje të tillë dhe për të ruajtur popullin serb në Kosovë. “Si gjithmonë, ne shkojmë të përgatitur me ekspertët tanë, me të gjitha temat që janë në tryezë. Jemi të gatshëm të diskutojmë gjithçka hapur. Ne posaçërisht insistojmë në formimin e Unionit të Komunave Serbe. Kjo është shumë e rëndësishme për mbijetesën e Serbët në Kosovë për të ardhmen dhe ne do të bëjmë

gjithçka për të ruajtur paqen dhe stabilitetin me një qasje të tillë dhe për të ruajtur popullin serb në Kosovë”, tha Petkoviç sot për Radio Televizionin e Serbisë (RTS). 2 korriku pritet të jetë një datë e mundshme për një takim të ri mes Bislimit dhe Petkoviç. Kjo datë u paralajmërua edhe nga kryeministri i Kosovës Albin Kurti para dy ditësh. “Do të provohet në fillim të korrikut, me gjasa më 2 korrik, ndërmjet dy kryenegociatorëve, që do të

diskutojnë mbi sekuencimin. Por zbatimi i Marrëveshjes e ka të domosdoshme respektimin e saj”, tha Kurti pas dështimit të takimit trepalësh në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi në Bruksel. Kurse Vuçiç njoftoi përmes llogarisë së tij në Instagram se gjatë takimit me Borrellin dhe Laçakun ka insistuar në formimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, por edhe ka shprehur përkushtimin për vazhdimin e dialogut.

### Zbardhen diskutimet në Kuvend

# Rezoluta për Jasenovacin “trazon” politikën në Podgoricë, propozimi i Mandiç kritikohet ashpër, miratimi do t’i kushtojë shtrenjtë vendit, ja si u shndërrua Mali i Zi në “veglën” e Serbisë

Marsela SHYTIA

Kuvendi i Malit të Zi me kërkesë të partive pro-serbe të udhëhequra nga Andrija Mandiç dhe Milan Knezheviç debatoi ditën e djeshme për “Propozimin për Rezolutë për gjenocidin në Jasenovac”. Nisma për të diskutuar rezolutën për dënimin e këtyre krimeve gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe për shpalljen e 22 prillit si Ditë përkujtimore të viktimave u mbështet nga partitë e shumicës parlamentare, ndërsa opozita ishte kundër. Mandiç dhe Knezheviç propozuan ndryshime në tekstin origjinal të rezolutës dhe kërkuan që përveç “gjenocidit në Jasenovac”, të dënohen edhe krimet në kampet naziste Dachau dhe Mathausen. Në rendin e ditës së Kuvendit ishte edhe propozimi i opozitës Socialdemokrate (SD) që Kuvendi të deklarohej për “Propozimin për një rezolutë për dënimin e krimeve në Palestinë”.

#### Diskutimet në Kuvend

Duke shpjeguar “Propozimin për një rezolutë për Jasenovacin”, kryetari i Parlamentit të Malit të Zi dhe lideri i Demokracisë së Re Serbe, Andrija Mandiç, deklaroi se propozuesit “bëjnë thirrje për kujtesë dhe humanizëm tek të gjithë njerëzit”, se përmbajtja “është jo kundër askujt, por qëllimi është të tregohet se e keqja - e keqja, pavarësisht se kush e ka bërë atë”. “Rezoluta nuk është në dëm



të askujt dhe mund të jetë në dobi të të gjithë qytetarëve,” tha Mandiç dhe theksoi se “Mali i Zi do të bëhet vendi i parë në planet që do të dënojnë gjenocidin në Jasenovac, i cili do të shërbejë për të nderuar ata që mund të mos votojnë për rezolutë dhe i ftoj të jenë pjesë e historisë së madhe të Malit të Zi”. Ai është i mendimit se rezoluta “nuk ofendon asnjë vend modern”.

#### Kritika nga Kroacia

Partia Demokratike e Socialistëve (DPS) e opozitës, e cila njoftoi se deputetët e saj nuk do të merrnin pjesë në votimin e rezolutës, kritikoi ashpër faktin se ajo po diskutohej fare dhe vlerësoi se kjo do të dëmtonte marrëdhëniet me Kroacinë, e cila në mes të majit dërgoi një notë proteste në Podgoricë për shkak të synimit të parlamentit për të hapur këtë pyetje. Deputeti i DPS-së Andrija Nikoliç

kritikoi ashpër tekstin e propozuar gjatë debatit. “Gjithçka tregon se ky është një manipulim i qëllimshëm ku Kroacia dhe njerëzit e saj duan të futen nën regjimin e ustashevë”, tha Nikoliç. Kroacia më parë kërcënoi se miratimi i rezolutës në Jasenovac sigurisht që do të ngadalësonte integrimin e Malit të Zi në BE dhe se nuk do të kishte një efekt të mirë në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis dy vendeve. Në qarqet diplomatike në Podgoricë, spekulohet se përgjigja kroate ndaj një miratimi të mundshëm nga Mali i Zi të rezolutës në Jasenovac mund të jetë “e ashpër”, dhe pretendohet se miratimi i saj nuk do të dëmtonte politikisht dhe diplomatikisht Kroacinë, por Malin e Zi.

#### “Punët e pista” të Serbisë

Me miratimin e rezolutës për Jasenovacin, qeveria aktuale e

Malit të Zi po kryen “detyrat e pista” të qeverisë në Beograd, tha në Dubrovnik ish-ministri i Jashtëm malazez Ranko Krivokapiç. Në margjinat e Forumit të Dubrovnikut, Krivokapiç, një veteran i politikës malazeze, e shpalli qeverinë në Podgoricë “qeverinë e tretë të Kishës së Serbisë”, duke theksuar se Mali i Zi është “më shumë se kurrë” i varur nga Beogradi dhe “serbo-rusi”. botë në kuptimin më të keq të atij termi. “Qeveria aktuale në Beograd po kryen grabitjen më të madhe të Serbisë në historinë e atij vendi dhe ai e ka studiuar atë histori”, ka theksuar Krivokapiç. Me miratimin e saj, Lëvizja populiste “Evropa tani” e kryeministrit Miloško Spajiq duhet të qetësojë dhe kënaqë pjesën pro-ruse dhe pro-serbe të strukturës qeverisëse në Mal të Zi, pasi qeveria e tij mbështeti Rezolutën për Srebrenicën në OKB. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka thënë se nuk pret që Kuvendi malazez ta miratojë rezolutën për Jasenovacin dhe ka theksuar se nuk ka folur me ata që e kanë propozuar. Presidenti i Serbisë i tha Pink TV se nëse rezoluta miratohet do të përgëzojë propozuesit. “Unë pres që ajo rezolutë të mos kalohet, nëse kalohet do të them “urime, vlerësimi im ishte i gabuar”, tha presidenti i Serbisë. Ai po ashtu tha se nuk ka diskutuar për dorëzimin e asaj rezolute me ata që e kanë propozuar.

### “Mirëdita, dobar dan”, Vuçiç: Injorimi, përgjigja më e mirë

Kryeministri i Serbisë, Millosh Vuçiç, tha se s’ka parë arsye që në Serbi të ketë festival si kurse “Mirëdita, dobar dan”, duke theksuar se personalisht beson se përgjigja më e mirë ndaj organizatorëve të ngjarjes është “shpërfillja”. Më 27 qershor, autoritetet në Serbi ndaluan mbajtjen e festivalit, qëllimi i të cilit është përmirësimi i bashkëpunimit kulturor mes artistëve të Kosovës dhe Serbisë. “Po mendoja, nuk shoh arsye për një festival të tillë në Serbi”, tha kryeministri serb, Vuçiç. Një ditë pasi grupet e ekstremistëve të djathtë dhe tifozët u mbledhën në sheshin Dorqol, ku ishte paraparë të që hapej festivali “Mirëdita, dobar dan”, Vuçiç tha se ata “bënë gjithçka për të treguar se Serbia është shtet që pranon ata që nuk kanë qëllime të mira ndaj shtetit dhe popullit tonë”. Kur u pyet nga gazetarët se pse shteti nuk garantoi siguri për pjesëmarrësit e festivalit, Vuçiç tha se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit (BIA), “vlerësuan se ka pasur një rrezik të madh të prishjes së rendit publik dhe paqes, rrezik për pronën dhe sigurinë e qytetarëve”. “E dini çfarë, ky është vendimi më i mirë marrë parasysh rrethanat”, tha Vuçiç.

### Kurti: Pa dorëzimin e Radoiçit s’ka mirëbesim në dialog

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se tri kushtet që ai vendosi në takimin e fundit të dialogut në Bruksel, janë ato që garantojnë procesin e normalizimit me Serbinë. Gjatë mbledhjes së Qeverisë së Kosovës, Kurti tha se pa dorëzimin e Millan Radoiçiqit dhe grupit të tij, që kreu sulmin e armatosur në Banjskë të Zveçanit, tek autoritetet e Kosovës s’mund të ketë mirëbesim në dialogun që ndërmjetësohet nga BE-ja. “Tridhjetë e nëntë persona të atij grupi, nga 47 të identifikuar qartë ndodhen në listën e kërkimit ndërkombëtar nga INTERPOL-i. Për aq kohë sa Radoiçiq dhe grupi i tij janë të lirë dhe të mbrojtur në Serbi, nuk ka mirëbesim në dialogun për normalizim”, tha Kurti. Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe – partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit – mori përgjegjësinë për sulmin ndaj Policisë së Kosovës më 24 shtator të vitit 2023 në Banjskë të Zveçanit. Në sulm mbeti i vrarë një rreshter, ndërkaq gjatë këmbimit të zjarrit u vrarë edhe tre sulmues serbë. Radoiçiq besohet se ndodhet në Serbi. Kosova fajëson Serbinë për sulmin, por Beogradi mohon se ka gisht në të. Në raundin e dialogut, BE tha se Kurti nuk ishte i gatshëm për një takim trepalësh.

## Irani shkon në zgjedhje, ja cili kandidat mund të pasojë Ebrahim Raisin

Iranianët votuan në zgjedhjet e parakohshme për të pasuar presidentin e ndjerë Ebrahim Raisin, i cili vdiq në një aksident me helikopter muajin e kaluar, ndërsa apatia publike përshkon Republikën Islamike pas vitesh problemesh ekonomike, protestash masive dhe tensioneve në Lindjen e Mesme. Votuesit përballen me një zgjedhje midis kandidatëve të linjës së ashpër dhe një politikani pak të njohur që i përket lëvizjes reformiste të

Iranit dhe dëshiron të ndryshojë teokracinë shiite nga brenda. Që nga Revolucioni Islamik i vitit 1979, gratë dhe ato që bëjnë thirrje për ndryshime radikale janë ndaluar të votojnë dhe zgjedhjet nuk monitorohen nga vëzhgues të njohur ndërkom-bëtarisht. Votimi në Iranerndhi pasi tensionet më të gjera kanë kapluar Lindjen e Mesme për luftën e Izraelit me Hamasin në Rripin e Gazës. Në prill, Irani filloi sulmin e tij të parë të

drejtpërdrejtë ndaj Izraelit për luftën e Gazës, ndërsa grupet e milicisë që Teherani armatosur në rajon, si Hezbollahu i Libanit dhe rebelët Houthi të Jemenit, janë të angazhuar në luftime me sulme të shtuara. Ndërsa lideri suprem 85-vjeçar i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, ka fjalën e fundit për të gjitha çështjet shtetërore, presidentët mund të përqendrojnë politikën e vendit drejt konfrontimit ose negociatave me Perëndimin.

Analistët i përshkruajnë zgjedhjet si një garë trepalëshe. Janë dy palë të vijës së ashpër, ish-negociatori bërthamor Said Dzalili dhe kryetari i parlamentit Mohamed Bager Kalibaf. Pastaj është edhe kandidati reformator Masud Pezeškian, i cili iu bashkua ish-presidentit Hassan Rouhani, nën udhëheqjen e të cilit Teherani arriti një marrëveshje kyçe bërthamore me fuqitë botërore në 2015, e cila u shkel më vonë.

■ Një lëvizje e paprecedentë po përgatitet, presidenti ka vetëm dy muaj kohë

# Ja emri i ri që mund të zëvendësojë Joe Biden, demokratët në panik kërkojnë largimin e presidentit të SHBA pas dështimit në përballjen me Donald Trump, zbardhet skenari i fundit

Marsela SHYTIA

Dështimi historik i Presidentit Joe Biden në debatin e parë televiziv të transmetuar në "CNN: kundër Donald Trump fjalë për fjalë i futi në panik demokratët. Në mesin e demokratëve, pas performancës katastrofike të Biden, i cili u shfaq i hutuar dhe i çorientuar, tani po përhapet hipoteza e presionit mbi kreun e Shtëpisë së Bardhë për ta detyruar atë të tërhiqet për arsye shëndetësore dhe të zgjedhë një alternativë. Nëse presidenti amerikan tërhiqet nga gara, zëvendësuesi do të identifikohet në Konventën Demokratike që do të mbahet më 19 gusht në Çikago. Për momentin, megjithatë, stafi i presidentit përjashton mundësinë e tërheqjes. "Sigurisht që ai nuk do të tërhiqet", konfirmoi zëdhënësi i fushatës së Biden, Seth Schuster, në një mesazh të raportuar nga "The Hill". Ndonëse nuk ka gjasa, gjithçka mund të ndodhë.

### 2 gra në garë

Nëse ëndrra e universit liberal është mishëruar nga ish-Zonja e Parë Michelle Obama, hipoteza më konkrete përfaqësohet nga Zëvendës-presidentja Kamala Harris, e cila mund të mbështetet nga vetë Biden nëse realizohet tërheqja. Problemi i parë: Harris është jopopullore dhe vlerësimi i miratimit është aktualisht nën 40%, sipas me-



satares FiveThirtyEight. Së dyti: për të lehtësuar emërimin e Harris, Biden duhet të japë dorëheqjen përpara konventës së gushtit. Përndryshe, ai mund të imitonte atë që bëri Lyndon Johnson në 1968, duke qëndruar në detyrë deri në fund të mandatit të tij. Në atë rast, megjithatë, delegatët që ai fitoi do të ishin të kontestueshëm. Dhe nëse Kamala Harris nuk është presidente deri në mes të korrikut, ajo nuk do të ketë të drejtën efektive për nominim. Më pas ka figura të tjera të shquara që mund të zëvendësojnë Biden si guvernatori i Miçiganit Gretchen Ehitmer, guvernatori i Pensilvanisë Josh Shapiro, si dhe ai i Maryland, Ees Moore.

### Kandidati favorit

Prandaj, nëse Kamala Harris duket se është rruga më e qëndrueshme dhe më e dukshme në rast të një hapi të bujshëm mbrapa nga presidenti ameri-

kan, ai i guvernatorit të Kalifornisë Gavin Neesom duket më i pamundur. Ky i fundit, në fakt, ka mbështetur disa kandidatë jashtë Kalifornisë vitet e fundit, duke ndezur thashethemet më të ndryshme për kandidaturën e tij të mundshme për Shtëpinë e Bardhë, por Neesom e ka hedhur poshtë me vendosmëri këtë mundësi, duke u betuar për besnikëri ndaj fushatës së Bidenit për vitin 2024. Neesom është një 57-vjeçar energjik me pikëpamje jashtëzakonisht liberale – ai mbron të drejtën e abortit, paralajmëron kundër ndryshimeve klimatike, mbështet martesën e të njëjtit seks dhe prezantoi një moratorium mbi dënimin me vdekje "sepse ato janë dëshmi e diskriminimit racor". Ai është me origjinë irlandeze dhe katolik. Problemi i Neesom-it është se ai është një anëtar i lindur i elitës së Amerikës,

gjë që largon shumë votues. Përveç kësaj, një sondazh i kohëve të fundit zbuloi se 50 përqind e të rriturve amerikanë - duke përfshirë 30 përqind të demokratëve - besojnë se Kalifornia është shumë liberal. I njëjti sondazh tregoi se rreth një e treta e amerikanëve e shohin Neesomin pozitivisht, një e treta tjetër negativisht dhe se të gjithë të tjerët nuk e njohin atë.

### Zëvendësimi i Biden

Siç shpjegon "Politico", nuk është aspak një proces i thjeshtë zëvendësimi i një kandidati presidencial të caktuar tashmë që ka fituar zgjedhjet paraprake. Një nga opsionet që mund të shqyrtohet në ditët në vijim është amendamenti i 25-të; ai që nënkupton se Presidenti i Shteteve të Bashkuara nuk është më në gjendje të vazhdojë të ushtrijë detyrat e tij ekzekutive. Nga pikëpamja taktike, 'topi i përgjegjës' do të kalonte nga lidhësi i partisë dhe vlerësimi i tyre në faktorë të jashtëm, mbi të cilët askush nuk mund të kishte ndikim. Me zemër, Joe Biden ka grumbulluar një sasi pothuajse absurde gafash në javët e fundit që mund të shërbejnë si një lloj baze për të justifikuar këtë lëvizje. Presidenti, në fakt, është i vetmi që mund të vendosë nëse do të tërhiqet apo jo: asnjë organ partie nuk mund ta detyrojë atë ta bëjë këtë. Dhe për momentin duket se nuk e ka ndërmend ta bëjë këtë.

### Dronët në Detin e Zi, Rusia paralajmëron masa

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë i urdhëroi zyrtarët e vet ta përgatisin një "përgjigje" ndaj dronëve amerikanë që fluturojnë mbi Detin e Zi, tha kjo Ministri dje. Ministria ruse tha se ka një "intensitet të rritur" së voni të dronëve amerikanë mbi Detin e Zi, duke shtuar se ata "mbledhin informata dhe objektiva për armët precize me të cilat ushtria ukrainase furnizohet nga aleatët perëndimorë për të kryer sulme ndaj objekteve ruse". "Kjo tregon për një përfshirje të rritur të SHBA-së dhe vendeve të NATO-s në konfliktin në Ukrainë duke ia mbajtur anën regjimit të Kievit", tha ajo në një komunikatë. Ajo theksoi se "fluturime të tilla e rrisin dukshëm mundësinë e incidenteve me përfshirjen e avionëve luftarakë rusë, gjë që e rrit rrezikun për konfrontim të drejtpërdrejtë mes aleancës dhe Federatës Ruse". "Anëtarët e NATO-s do ta mbajnë përgjegjësinë për këtë", shtoi ajo. Ministria theksoi se ministri i Mbrojtjes Andrei Belousov e ka urdhëruar Shtabin e Përgjithshëm të "bëjë propozime për masat si përgjigje ndaj provokimeve". Uashingtoni dhe Moskja janë konfrontuar edhe më parë rreth dronëve amerikanë në Detin e Zi. Në një incident më 2023, një avion luftarak rus e dëmtoi një dron amerikan atje.

### Izraeli lejon evakuimin e dhjetëra palestinezëve

Dhjetëra palestinezë të sëmurë dhe të plagosur u lejuan të shkonin në Egjipt të enjten, një nga evakuimet e para mjekësore që nga mbyllja e pikëkalimit kufitar me Egjiptin në muajin maj. Gjashtëdhjetë e tetë persona, në mesin e tyre 19 fëmijë të sëmurë dhe të plagosur dhe familjet e tyre kaluan në Egjipt në kuadër të një evakuimi të koordinuar me zyrtarë nga Shtetet e Bashkuara, Egjipti dhe komuniteti ndër-kombëtar, tha ushtria izraelite. Njëzet e një pacientë me kancer nga Gaza po transportohen në Emiratet e Bashkuara Arabe për trajtim mjekësor, sipas agjencisë së lajmeve Agence France-Presse. Është e paqartë nëse 21 pacientët me kancer janë pjesë e 68 personave të evakuuar. Mohammed Zaqout, drejtor i spitaleve të Gazës, tha se më shumë se 25,000 pacientë në Rripin e Gazës kanë nevojë për trajtim mjekësor jashtë vendit dhe se rruga nga pikëkalimi Kerem Shalom në Egjipt nuk mund të zëvendësojë atë në Rafah që e lidh drejtpërdrejt Gazën me Egjiptin. Ndërkohë forcat izraelite hynë në një lagje të qytetit të Gazës të enjten dhe urdhëruan banorët palestinezë që të zhvendoseshin në jug, në kuadër të një operacioni, që Izraeli thotë se është pjesë e fazave përfundimtare të luftës kundër Hamasit.

## b o t ë

## Bjellorusia vendos ushtrinë në gatishmëri, përforcon kufirin me Ukrainën

Bjellorusia po forcon kufirin e saj me Ukrainën pas një incidenti sigurie dhe ka vendosur një njësi me raketa-hedhës të shumtë për të testuar gatishmërinë e tyre luftarake, njoftoi ditën e djeshme Ministria e Mbrojtjes e Bjellorusisë. Patrulla Kufitare njoftoi më herët po ashtu dje se siguria kufitare ishte duke u rritur, duke shtuar në një deklaratë se të mërkurën ata rrëzuan një dron që kaloi ilegalisht kufirin nga Ukraina

për të mbledhur informacion mbi infrastrukturën kufitare të Bjellorusisë. Patrulla Kufitare njoftoi këtë javë se materiali për një bombë të prodhuar në shtëpi ishte gjetur në të njëjtën zonë dhe se e dinte se një njësi e ushtarëve rusë pro-ukrainas ishte në rajonin ukrainas në kufi me Bjellorusinë. Ministria e Mbrojtjes publikoi foto të raketave bjelloruse Polonez me shumë fuçi të vendosura përgjatë kufirit pranë pyllit.

“Ushtarët kanë pajisur dhe kamufluar lokacione ku personeli ushtarak dhe pajisjet e tyre janë të vendosur në zonën e caktuar dhe vazhdojnë të kryejnë detyrat e tyre”, thuhet në deklaratë. Qendra për Kundër Dezinformimin e Këshillit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Ukrainës tha në maj se parashikonte nisjen e një operacioni të ri psikologjik rus në lidhje me hapjen e një fronti të ri në veri të Ukrainës nga kufiri me Bjellorusinë, që

synon “të nxisë masën”. panik në shoqërinë ukrainase. “Ne presim një sërë deklaratash provokuese nga lidhshipi i lartë i Rusisë dhe Bjellorusisë që kërcënojnë Ukrainën së shpejti”, thuhet në deklaratë. Bjellorusia ka qenë një aleat kyç i Moskës dhe ka mbështetur agresionin rus kundër Ukrainës, por ka refuzuar të angazhojë trupat e saj për të luftuar drejtpërdrejt në luftën e Rusisë. Ukraina nuk ka bërë ende asnjë koment.

### Rreziku nga populizmi

## Një epokë e re e pret Britaninë e Madhe pas 4 korrikut, sondazhet e kanë bërë të qartë se kush do t'i fitojë zgjedhjet, ja pse fati politik i kryeministrit Rishi Sunak varet në “fije të perit”

Marsela SHYTIA

Kryeministri aktual britanik Rishi Sunak dhe sfiduesi i tij kryesor Keir Starmer u përballën në debatin përfundimtar televiziv përpara zgjedhjeve të përgjithshme të 4 korrikut. Nuk ishte një luftë madhështore. Në njërin anë ishte kryeministri, fati i të cilit varet në një fije peri dhe në anën e kundërt ishte një robot politik, siç e quanin spektatorët “me dashuri” liderin e Laburistëve. Në përballjen e fundit televizive parazgjedhore, Sunak sulmoi fort dhe padyshim fitoi, por gjithçka ishte e kotë sepse vendimi praktikisht ishte marrë tashmë. Laburistët ka të ngjarë të fitojnë zgjedhjet me një shumicë të madhe brenda një jave. Nëse parashikimet rezultojnë të sakta, konservatorët do të humbasin pushtetin pas 14 vjetësh në pushtet dhe Sunak do të bëhet kryeministri i parë në historinë britanike që humbet një vend në parlament në zgjedhjet e përgjithshme.

### Përballja

Gjatë përballjes, Sunak dhe Starmer prekën çështjet e emigracionit, kufijve, taksave, të drejtave të grave dhe krizës së strehimit. Sunak mësoi nga gabimet e konfrontimeve të mëparshme dhe shkoi menjëherë në sulm, duke akuzuar Starmer se i bën qytetarët të duken si budallenj për plane joreale për të reduktuar migracionin, ndërsa Starmer



akuzoi Sunak, një nga njerëzit më të pasur në vend, se ishte “jashtë kontaktit”, “dhe shumë të pasur për të kuptuar shqetësimet e shumicës së britanikëve”. Sunak vazhdimisht u bëri thirrje qytetarëve që të mos “dorëzohen” ndaj laburistëve, ndërsa Starmer theksoi se zgjedhjet janë një mundësi që vendi të kthejë një fletë të re pas 14 vitesh sundimi konservator të shënuar nga masa shtrënguese, Brexit dhe luftime të brendshme partiake. Debati u la në hije nga protestat pro-palestineze, të cilat u zhvilluan para godinës ku ndodhi përballja.

### Bastet zgjedhore

Se çfarë mendojnë realisht britanikët për dy kandidatët kryesorë për kryeministër të ardhshëm britanik, mund të lexohet nga pyetjet e audiencës, të cilat treguan qartë se njerëzit kanë humbur besimin ndaj

tyre, veçanërisht pas zbulimit të skandalit të basteve zgjedhore. Së pari, Sunak tërhoqi mbështetjen për dy nga ndihmësit e tij pasi u zbulua se ata kishin vënë bast për datën e zgjedhjeve dhe më pas, në një kthesë të papritur, një kandidat i Partisë së Punës u pezullua gjithashtu pasi u zbulua se ai kishte vënë bast se ai nuk do të fitonte vendin për të cilin po garonte. Pakënaqësia e popullit britanik me ofertën politike është më se e dukshme dhe triumfi i mundshëm i laburistëve në zgjedhjet e ardhshme do të jetë një reflektim i indignatës së popullit ndaj premtimeve të thyera dhe paafetësisë së konservatorëve.

### Taktika e dëshpëruar

Në këtë “armagedon”, siç e përshkruajnë ata, Starmer planifikon të mbushë parlamentin me të majtë, të cilët do të kalo-

jnë dispozita antidemokratike. E ashtuquajtura “supershumicë”, me të cilën konservatorët trembin britanikët, i referohet sistemeve të votimit në të cilat vendoset një prag më i lartë për disa dispozita sesa shumica e thjeshtë. Kapërcimi i atij pragu zhbllokon fuqi shtesë. Për shembull, nëse një parti ka një supershumicë në Kongresin e SHBA, kjo i jep asaj kompetenca shtesë, të tilla si propozimi i amendamenteve kushtetuese ose anulimi i një vetoje presidenciale. Por në Britaninë e Madhe dispozita të tilla nuk zbatohen, ndaj termi “supershumicë” është thjesht një taktikë e dëshpëruar e konservatorëve.

### Rreziku nga populizmi

Ekonomia ka qenë në harresë prej vitesh, ndërkohë që borxhi publik vazhdon të rritet në qiell dhe krizat vazhdojnë të grumbullohen vit pas viti në vend që të zgjidhen. Përveç krizës shëndetësore dhe të imigracionit, Britania është përfshirë edhe nga krizat e strehimit dhe financimit të universiteteve publike që nga ky vit. Frika më reale nga ardhja e së majtës në pushtet janë pasojat që do të pasojnë nëse laburistët nuk janë të suksesshëm në pushtet. Nëse laburistët rezultojnë të jenë po aq të këqij apo edhe më keq se konservatorët, votuesit mund t'u drejtohen partive populiste të krahut të djathtë në zgjedhjet e ardhshme, siç ndodh tashmë në Hungari, Spanjë, Itali.

### Argjentinë, miratohen reformat ekonomike të Milei

Parlamenti i Argjentinës më në fund miratoi sot programin e reformës ekonomike të presidentit ultra-liberal Javier Milei, pas disa muajsh debati mbi projektligjin. “Ne do t'i japim qeverisë së Presidentit Milei mjetet e nevojshme për të qenë në gjendje të ristrukturojë shtetin një herë e përgjithmonë,” tha kreu i partisë në pushtet, Gabriele Bornoroni. Politikisht, ky miratim do të thotë “një sukses i plotë për qeverinë”, tha politologu dhe ekonomisti Pablo Tigani. Por në sektorin ekonomik do të thotë “një rikthim në politikën e viteve 1990 me derregullim, privatizim dhe hapje të pakushtëzuar të ekonomisë që do të godasë rëndë industrinë dhe kompanitë e vogla dhe të mesme,” shtoi ai. Qeveria e tij zbatoi një program fiskal drastik me një objektiv “deficiti zero” deri në fund të 2024-ës për të trajtuar inflacionin kronik, i cili në 2023 arriti në 211%. Por shkurtimeve buxhetore, të cilat shkaktuan, ndër të tjera, paralizën e punëve publike, të kombinuara me zhvlerësimin e dhunshëm të pesos (-54%) në dhjetor, shembën fuqinë blerëse të argjentinaseve. Inflacioni në Argjentinë vazhdoi të zbutej gradualisht në maj, duke rënë 4.2% nga muaji i kaluar, rënia më e madhe në dy vjet e gjysmë.

### SHBA i jep 6.5 miliardë dollarë ndihmë Izraelit

Që nga 7 tetori 2023 e deri më tani, SHBA-ja i ka dhënë Izraelit ndihmë sigurie me vlerë rreth 6.5 miliardë dollarë, e cila ka shkaktuar vrasjen e rreth 40 mijë palestinezëve në Rripin e Gazës. Lajmi i publikuar nga “The Washington Post”, bazuar në një zyrtar amerikan të pidentifikuar, zbulon se SHBA-ja i ka dhënë mbështetje intensive Izraelit për sulmet në Gaza. Sasia e ndihmës në fjalë u zbulua këtë javë kur delegacioni izraelit i kryesuar nga ministri i Mbrojtjes, Yoav Gallant u takua me homologët e tyre amerikanë si pjesë e takimeve të tyre në Washington. Vetëm gjysma e ndihmës së sigurisë prej 6.5 miliardë dollarësh të ofruara nga SHBA-ja për Izraelin që nga 7 tetori, u transferua në maj, kur tensionet me Hezbollahun në kufirin libanez u intensifikuan me pritishtëritë për t'u kthyer në luftë. Delegacioni izraelit i kryesuar nga Gallant që zhvilloi bisedime në Washington dhe homologët e tyre amerikanë, krahas negociatave në vazhdim për armëpushim dhe shkëmbimin e pengjeve në Gaza, diskutuan për skenarët e mundshëm pasi Izraeli të përfundojë sulmet në Gaza. Ministri izraelit Gallant e përshkroi ristrukturimin e administratës së Gazës pas Hamasit si “një proces të gjatë dhe kompleks”.

## Gratë marrin “frenat” e Bashkimit European, ja pse Kremli është trembur

Kremli tha dje se perspektivat për marrëdhëniet midis Rusisë dhe Bashkimit Evropian janë të këqija pasi krerët e vendeve anëtare të BE-së emëruan Ursula von der Leyen për një mandat tjetër në krye të Komisionit Evropian dhe zgjedhën kryeministren estoneze Kaja Kallas. përfaqësuesi i lartë për politikën e jashtme. Zëdhënësi i Kremli Dmitry Peskov u tha gazetarëve se vendimi i Unionit për të emëruar gjermanen Ursula

von der Leyen për një mandat të dytë pesëvjeçar nuk do të ndryshojë asgjë. “Zonja von der Leyen nuk mbështet normalizimin e marrëdhënieve midis BE-së dhe Rusisë. Ne e njohim atë ashtu, ne e kujtojmë atë ashtu. Asgjë nuk ndryshon në këtë kuptim”, tha Peskov. I ndarë më parë, Unioni është mobilizuar për të ndihmuar financiarisht dhe ushtarakisht Kievin në luftën e tij kundër Rusisë që kur presidenti rus Vladimir Putin dërgoi dhjetëra mijëra

trupa në Ukrainë në vitin 2022. Brukseli ka vendosur gjithashtu paketa të shumta sanksionesh ndaj Moskës, në përpjekje për ta detyruar atë të tërheqë forcat e saj dhe për të ndaluar kështu agresionin. Duke komentuar zgjedhjen e kryeministrit estonez Kaja Kallas në krye të diplomacisë evropiane, Peskov tha se ajo njihet për retorikën e saj antiturke. “Zonja Kallas gjithashtu nuk ka shfaqur prirje diplomatike dhe në vendin

tonë njihet për pikëpamjet e saj absolutisht të pakompromis dhe ndonjëherë edhe hapur antiturke”, tha ai. “Prandaj, ne nuk mendojmë se diplomacia evropiane do të kontribuojë në asnjë mënyrë në normalizimin e marrëdhënieve. Perspektiva është e keqe për sa i përket marrëdhënieve midis Moskës dhe Brukselit”, shtoi ai. Kujtojmë se Kallas është quajtur shpesh edhe “skiftere ruse”, për shkak të ashpërsisë ndaj Moskës.

### Forcat izraelite kryejnë sulme në thellësi të Gazës

Forcat izraelite kryen dje sulme duke goditur me tanke më në thellësi në dy zona në veri dhe jug të Rripit të Gazës, ndërsa autoritetet shëndetësore palestineze që kontrollohen nga Hamasi thanë se nga sulmet në Rafah u vranë 11 persona. Banorët dhe Hamasi thanë se tanket kryen sulme në perëndim të lagjes Shakoush në Rafah, duke detyruar mijëra të zhvendosur që të largohen nga kampet dhe t'i drejtohen qytetit të afët Khan Yunis. Ushtria izraelite nuk komentoi mbi këto sulme. Që prej datës 7 maj, tanket kanë përparuar në disa zona të Rafahut ndërsa forcat izraelite kanë nën kontroll të gjithë vijën kufitare me Egjiptin dhe pikëkalimin e Rafahut, e vetmja pikë lidhëse për më shumë se 2.3 milionë banorët e Gazës me botën e jashtme. Përpjekjet e ndërmjetësuesve arabë, të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara për të arritur një marrëveshje armëpushimi deri tani kanë dështuar. Hamasi thotë se marrëveshja duhet të sigurojë fundin e plotë të luftës dhe tërheqjen e Izraelit nga Gaza ndërsa Izraeli thotë se do të pranojë vetëm ndërprerje të përkohshme të luftimeve, derisa Hamasi, që qeveris Gazën që nga 2007, të çrrenjoset dhe eliminohet. Izraeli ka refuzuar t'i bindet SHBA për ndalimin e luftimeve.

### Beteja për Chasiv Yar

# Lëvizjet e amerikanëve “tërbojnë” rusët, Vladimir Putin urdhëron “djegien” e një qyteti të tërë, plani i hakmarrjes rrezikon të gjithë Ukrainën, ja pse Zelensky mund të detyrohet të ulet në tryezën e negociatave

Marsela SHYTIA

Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, thotë se ai është duke hartuar një “plan gjithëpërfshirës” për mënyrën se si Kiev beson se lufta me Rusinë duhet të përfundojë. “Është shumë e rëndësishme për ne që të tregojmë një plan për t'i dhënë fund luftës që do të mbështetet nga shumica e botës,” tha presidenti ukrainas në një konferencë shtypi në Kiev së bashku me Presidenten sllovene Natasa Pirc Musar. Nuk ka negociata aktuale midis Ukrainës dhe Rusisë dhe, bazuar në deklaratat publike të Zelensky dhe presidentit rus Vladimir Putin, të dyja palët duken aq larg sa kurrë më parë kur bëhet fjalë për kushtet e një zgjidhjeje të mundshme paqeje. Ukraina ka thënë vazhdimisht se Rusia duhet të tërheqë trupat e saj nga territori i saj i njohur ndërkombëtarisht – duke përfshirë gadishullin e Krimesë që Moska aneksoi në vitin 2014 – përpara se të fillojnë bisedimet e paqes. Ndërkohë, Putin, i cili nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt 2022, po kërkon që Ukraina të kapitultojë në mënyrë efektive duke evakuuar edhe më shumë territor në lindje dhe jug të saj që Rusia tani pushton.

#### Beteja për Chasiv Yar

Situata në fushë-betejë nuk dihet ende saktësisht sesi është,



pasi deklarata të kundërta vijnë nga palët. Ushtria ukrainase njoftoi të enjten se forcat e saj kanë dëbuar trupat ruse nga rrethi në qytetin Chasiv Yar në frontin lindor, ndërsa rusët vazhdojnë të pretendojnë se po bëjnë përparim në të njëjtin qytet. Chasiv Yar ndodhet në një kodër rreth 20 kilometra në perëndim të Bakhmut, një qytet që u pushtua nga forcat ruse një vit më parë, dhe të dyja palët e shohin atë si një pikënisje potenciale për përparimin rus drejt qyteteve kyçe të rajonit lindor të Donetskut. veçanërisht Kramatorsk dhe Slovyansk. Zëdhënësi i ushtrisë NazarVoloshin tha për agjencinë e lajmeve Ukrinform se mbrojtësit ukrainas i shtynë forcat ruse nga rrethi Kanal në Chasiv Yar. “Ushtria armike është zhdukur,” tha ai. Vološin shtoi se forcat ruse nuk mund të pushtonin Chasiv Yar, kjo është arsyeja pse ata vendosën

të shkatërrojnë qytetin. Ndër të tjera, thonë ukrainasit, rusët përdorin famëkeqin TOS-1, një raketë me shumë fuçi me raketa të pajisura me koka aerosol. “Është një armë e tmerrshme që godet me raketa termobarike”, tha Vološin.

#### Kërcënimet ndaj SHBA-së

Sakaq, hakmarrja synon edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, veç Ukrainës. Së fundmi ministri rus i mbrojtjes urdhëroi zyrtarët që të përgatisin një “përgjigje” ndaj fluturimeve të dronëve amerikanë mbi Detin e Zi, tha ministria dje, në një paralajmërim të dukshëm se Moska mund të ndërmarrë veprime të forta për të shmanjur avionin zbulues amerikan. Ministria ruse e Mbrojtjes vuri në dukje një “intensitet të shtuar” të kohëve të fundit të dronëve amerikanë mbi Detin e Zi, duke thënë se ata “kryejnë inteligjencë dhe shënjestrim

për armë precize të furnizuara ushtrisë ukrainase nga vendet perëndimore për sulme ndaj objekteve ruse”. “Kjo tregon një përfshirje të shtuar të SHBA-së dhe vendeve të tjera të NATO-s në konfliktin në Ukrainë në anën e regjimit të Kievit”, tha ministria në një deklaratë. Ai vuri në dukje se “fluturime të tilla rrisin ndjeshëm mundësinë e incidenteve që përfshijnë avionët ushtarakë rusë, gjë që rrit rrezikun e konfrontimit të drejtpërdrejtë midis aleancës dhe Federatës Ruse”.

#### Tensionet

Uashingtoni dhe Moska janë përplasur më parë për këtë çështje. Në mars të vitit 2023, një avion luftarak rus Su-27 dëmtoi një dron amerikan MQ-9 Reaper, duke bërë që ai të rrëzohej në Detin e Zi. Kjo ishte përplasia e parë e drejtpërdrejtë midis forcave ruse dhe amerikane që nga Lufta e Ftohtë. Një përsëritje e një konfrontimi të tillë mund të nxisë më tej tensionet për luftën në Ukrainë. Rusia ka shpallur zona të gjera pranë Krimesë të ndaluara për fluturime. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia në vitin 2014 dhe shumë kohë përpara se Rusia të pushtonte Ukrainën në shkurt 2022, Moska akuzoi avionët e mbikëqyrjes amerikane se fluturonin shumë afër kufijve të saj, duke injoruar njoftimet e lëshuara nga Rusia.

### Sondazhet, e djathta ekstreme franceze rrit epërsinë

Tubimi Kombëtar i ekstremit të djathtë të Francës (RN) zgjeroi epërsinë e saj në një sondazh të publikuar në ditën e fundit të fushatës përpara raundit të parë të zgjedhjeve parlamentare të së dielës, me një tjetër sondazh që e tregon atë në sytë e një shumicë të vogël. Partia anti-emigrante dhe euroskeptike e Marine Le Pen ka udhëhequr sondazhet që kur Presidenti francez Emmanuel Macron thirri një zgjedhje të papritur të parakohshme këtë muaj që e ka zhytur Francën në pasiguri dhe ka shqetësuar fqinjët evropianë dhe tregjet financiare. Një sondazh i ri i OpinionWay i botuar nga gazeta Les Echos ditën e djeshme tregoi se RN mund të arrijë deri në 37% të votave popullore, dy pikë përqindje më shumë se rezultati i saj një javë më parë. Partia Together e bllokut qendror të Macron u pa duke aritur në 20%, me dy pikë më pak nga publikimi i fundit. Aleanca e majtë e Frontit të Ri Popullor qëndroi në një 28% të votave të pandryshuara. BFM TV, në një sondazh tjetër të përpiluar nga Elabe, llogariti se RN dhe aleatët mund të përfundojnë me 260-295 vende në parlamentin e ri - potencialisht duke kaluar shiritin prej 289 vendesh për një shumicë absolute duke u dhënë atyre një mandat të qartë për të qeverisur.

Nga Përparim HYSI

## Onkologjiku dhe privati

Jam një qytetar që kam patur kunatin (vëllain e sime shoqe tek Onkologjiku). Vetëm rekomandimi për t'u shtruar tek ky spital, të streson. Të streson, nuk të streson është si një e keqe e domosdoshme apo, si të thuash, shpresa e fundit. Shkova me kunatin (nuk tregonte fare si i sëmurë), që gati dy metrosh dhe shpatullan si lis. Sido që nuk tregonte së jashtmi, ai kish punuar kovaç dhe e keqa i kish hyrë në gjak. E shtruan dhe sekseri (kudo është modë që këta sekserët janë si ata "suflerat" që në prapaskenë, u lexojnë aktorëve fjalët që do thonë në skenë), më tha: -Profesori e ka pak dorën të rëndë: për çdo mëngjes, pesë mijë lekë të rinj. Dy të tjerët, nga 10 -mijë të vjetra. Po kur thonë, "parja e

bardhë për ditë të zezë" dhe zura të "hidhja vallen", sipas muzikës së sekserit". Vetëm kunati të dilte mirë po as që vinim vesh për financa. Kjo marrëdhënie doktor-pacient, po shkonte si sahat për pesë ditë. Në krye të pesë ditëve, profesori më thirri dhe më tha: "Kunati ka sëmundje të pashërueshme. Mund ta shtyj ca me një ilaç që në Shqipëri nuk gjendet dhe është i kushtueshëm (gati 7500 Euro.) Mora rekomandimin, emrin e ilaçit dhe veç tyre, pas dy muajsh të bënim analiza dhe të riktheheshim tek profesori. E gjetëm ilaçin dhe, pas dy muajsh, e shpura kunatin për analiza. Analizat, për të qenë më i sigurt i bëra tek një laborator privat. Këto analiza tek

privati, ngaqë u hap sipari i ONKOLOGJIK-UT, më shtyn sot që të bëj këtë shkrim. Kunati im jetonte në FIER dhe nga FIERI erdhi me autobus. E çova tek laboratorin privat i DOKTOR QAMIL MEMËS, që gjendet pas klinikës 9 tek rruga e Kavajës. I morën kampionët që duheshin sipas rekomandimit. Kunatin e lashë në shtëpi me të motrën dhe vet, ashtu prag drekte shkova të merrja përgjigjen e analizave. Më priti DR. Qamili dhe më tha: -Çfarë e ke të sëmurin? -Është kunati im dhe e dua njësoj me vëllezërit e mi. -Është shumë keq dhe nuk e ka të gjatë. U dëshpërova dhe, i thyer shpirtërisht, i

them:

-Epo risku i keq, DOKTOR, por më thuaj, sa ju detyrohem?

-Doktor QAMIL MEMA:- Unë të marrë lekë për gjithë atë burrë si lis? As mos e zërë në gojë. Më zgjati zarfin e analizave dhe, tek e rroka në qafë për shpirtmadhësinë e tij, i thashë:- DOKTOR QAMILI ti je nga PEZA dhe në SHQIPËRI të mesme, ka një këngë popullore: "Çohuni djem, shaloni atin". Në një nga strofat thuhet: "Të kisha një djalë si MEMA, paç me i hy Vezirit brena...". Unë po i improvizoj këto vargje dhe po them: "Të kishte ca doktorë si QAMIL MEMA, ryshfetin në shëndetësi", e përzë me shqelma. Kunati im nuk e pati të gjatë, por unë po e bie shkrimin për të treguar, se ka mjekë si QAMIL MEMA që vë zemrën për pacientin. Mjekë të tillë ia zbardhin faqen shëndetësisë.

## Në vend të një replike....RRËNJËT e dukurisë "ONKOLOGJIK" janë 33-vjeçare...

Nga Tritan KALO, mjek

"Shqipërinë e bëmë, tani duhet të bëjmë shqiptarët" shprehej një Rilindas i madh, por edhe 112 vite pas 28.11.1912 ne nuk mundemi të kemi individin shqiptar bartës të shumë virtyteve në raport me bartjen e shumë veseve... Demon-kracia e këtyre 33 viteve po çon më shumë hulli në këtë drejtim.... "Homo medicus" nuk bën përjashtim nga pjesa tjetër e turmës së "Homo demoncraticus".... "Syri ynë vigjilent", syri i tërë "il poppulo albanese" më shpejt "kap qimen dhe jo traun

e problematikës"..... Po ashtu ai ecën në jetë sipas "parimit nastradinian", që për sa kohë unë nuk prekam direkt nga një dukuri negative, përse duhet të shqetësohem për ekzistencën e saj.... JO PA QËLLIM e filluam Demon-kracinë të prirë nga parulla: "Bashkëfajtorë dhe Bashkëvuajtës", me të justifikuam të kaluarën e para 31.03.1991, dhe i paraprimë asaj çka do të vinte pas kësaj date..... A nuk ishim vetë ne që shkatërruam atë çka ndërtoam në 45 vite punë, gjak e sakrificë?!..... Të mos harrojmë edhe faktin tjetër se sa herë që Qeveriu i radhës ka probleme madhore klepto-korruptive, në menaxhimin e zhvillimeve

socio-ekonomiko-politike të Shqipërisë së këndej Drinit, të na shfaqet "një grup i strukturuar armiqësor në Shëndetësi".... Askush nuk analizon po ashtu faktin se, si në fillim të viteve 90-të e mbushën QSUT me militantë të ardhur nga rrethet, që si të gjithë të ardhurit në Tiranë e në rrethinat e saja ata/ato "kapën tokën e pa zanam", dhe nuk zbritën thjesht për HUMANIZËM duke i braktisur postet e punës në rrethet përkatëse, POR për "Para, Plaçkë e Poste" (PPP e Homos demon-craticus).... A u ndëshkua kush për këtë braktisje të spitaleve, poliklinikave apo ambulancave në rrethet përkatëse, ASKUSH..... SOT ata janë shu-

mica dhe duhen breza për ti zëvendësuar.... Mjekët e rinj vështirë ta ndryshojnë këtë situatë sepse askush nuk po u hap vendin meritort, ndaj ata/ato në shumicën e tyre po marrin udhët e botës..... Megjithatë "Prisni, prisni se nuk keni parë gjë akoma" (ER).... Nga ana tjetër e "barrikadës politike", po presin të riciklohen ata që e iniciuan këtë thejqafje të Shqipërisë dhe në veçanti të Shëndetësisë Publike.... KU jeshmë asgjëkundi, ku o të vemë kërkund!!! VËNDIT në çdo qelizë të funksionalitetit të Shoqërisë i duhen individë të pa përlyer në çorbën klepto-korrutive të këtyre 33 viteve.... Quo vadis Shqipëria ime e këndej Drinit?!

## A është e vërtetë se është vjetruar Marksizmi, apo tezat e tij?!

Nga Ylli MEÇE

Mos u çuditni dhe askush te mos bëjë habinë duke vendosur duart ne faqe sikur të ketë ndodhur ndonjë gjëmë e madhe, pra që se si është e mundur që ky artikull shkruhet, pa pikë ndroje, aq më tepër teksa sot "Shqipëria aspiron për demokraci" na del këtu dhe na bënë propagandë marksiste?! Kjo nuk është aspak e vërtetë që këtë propagandë e bëj unë, por është vet sistemi kapitalist i instaluar në Shqipëri i cili vërteton katerciperisht tezat e Marksit mbi shfrytëzimin kapitalist dhe se është po vet ky sistem, që jo vetëm nuk mundet ti fshehtë plagët që po e çojnë drejt katastrofës katastrofë kjo që ja ka përcaktuar historia, por ai po manifeston pikërisht po ato tipare te cilat i kish parashikuar Marksit këtu e nje shekull e gjysëm më parë. Profesori i universitetit ne Angli dhe ish ministri i ekonomi- financës se Greqisë Jani Varofakis pa as më të vogël mëdysheje deklaroi se te gjitha ato çka shkruar Marksit me përjashtime shume te vogla e te pa rëndësishme i ka vërtetuar katerciperisht koha. Borgjezët e mesëm tronditen shume kur mendojnë se kapitalizmi dhe zëvendësohet ne mënyrë te pa diskutueshme nga komunizmi, pa e kuptuar aspak thelbin e marksizmit si teori dhe praktike revolucionare e cila bën përmbysjen e madhe te marrëdhënieve kapitaliste sidomos këtë ne fazën e fundit te tij ne imperializëm. Po pse pikërisht ne imperializëm?! Sepse imperializmi, jo vetëm bën koncentrimin e kapitalit mall- para, por ai krijon dhe kushtet e ekonomisë globale te lidhura e te ndërvarura me njera tjetrën dhe ashtu sikurse koncentrohet ky kapital, po ashtu koncentrohen dhe shtete duke formuar perandori të mëdha kontinentale te cilat herë a herës janë në unitet me njera tjetrën dhe hera herës ne kontraktin te ashpra po me njera-tjetrën. Nëse në të ardhmen do të ndodhin luftëra botërore shkaktar i tyre jane perandoritë e mëdha imperialiste sikurse jane Evropa..Rusia..Amerika..Kina.. India apo dhe disa te tjera qe aspirojnë për të qenë superfuqi dhe luftën nuk e bëjnë

aspak presidentet e këtyre vendeve, sado agresivë të jenë, por e bën rivaliteti për tregje e zona influence. Lufta e parë botërore solli aleanca trepaleshte midis Austro - Hungarisë e Gjermanisë ( me vonë dhe Italia) nga njera anë...dhe nga ana tjetër Anglia Franca e Rusia( paçka se kjo e fundit ne vitin 1917 u tërhoq nga aleanca për shkak te Revolucionit bolshevik te Leninit). Pra kjo luftë ishte nje luftë ndër imperialiste për zgjerim terrioresh, por nga kjo luftë lindi pre herë të parë dhe shteti i proletarëve që kurrë në historinë e njerëzimit nuk ishte parë ndonje herë. Lufta e dytë e përbotshme dhe kjo ishte nje luftë imperialiste e filluar nga vet imperializmi gjerman i cili ishte "dënuar" gjate luftës së parë dhe që ishin bere shume kufizime gjë që e pengonte shume ekonominë gjermane. Do të duhej nje A.Hitler te ulërinte si i marrë "për të çuar ne vend nderin dhe dinjitetin e Gjermanisë se neperkembur". Qellmi, nuk ishte thjeshte për te vene ne vend nderin e nje kombi, por Gjermania duhej te behej kombi i cili duhej te sundonte boten. Po çuditërisht lufta dhe fitorja mbi nazi-fashizmin solli shume vende qe mbas çlirimit ato kaluan direkt ne nje sistem tjetër politik ne nje sistem te demokracive popullore dhe rrugës drejt socializmit. Këto janë fakte të dukshme dhe te pakundërshtueshme historike, sepse është dhe tjetër gjë, qe ato nuk mundën dot ta përballonin ekspansionin ekonomik dhe diversionin ideologjik te te gjithë botes kapitaliste e imperialiste, sepse ne fund te fundit ne luftën për fitore midis dy sistemeve te kundërta midis kapitalizmit dhe socializmit do te triumfonte ai rend ekonomik shoqëror i cili do te kish rendimentin e punës me te larte. Këtë e patën deklaruar dhe vet udhëheqësit e vendeve socialiste. Rezultoi qe rendimentin e punës me te larte ne te dy këto sisteme te kundërta ekonomik- shoqërore e kish kapitalizmi dhe imperializmi. Mos vallë kjo do te thotë se dhe sikur te tentohet përsëri për nje sheqeri te barabarte nuk u dashka ndërmarrë nje hap i tille sepse rendimentin e punës me te larte e ka kapitalizmi?! Jo! Kjo është nje teze e gabuar sepse defektet e ish vendeve socialiste qëndronin pikërisht ne nënvleftësimin e faktorit ideologjik, duke ju futur dhe garës se ar-

matimeve ata e nënvleftësonin presionin e madh politik dhe ekonomik dhe kjo beri që nje pjesë e udhëheqjeve te partive por dhe vet partitë e tyre ru frikësuan disa te tjera rranë ne gabime te mëdha ideologjike ato u burokratizuan dhe nga "shërbëtore te masave" u kthyen ne "zotërinj te masave" por jo kapitalistë të mirëfilltë me prona te trashëguara dhe me fabrika ku shfrytëzohin krahun e punëtorit, por me triskën e komunistit në xhep te cilët me teorinë dhe praktiken e tyre i çuan këto vende drejt kapitalizmit, i çuan keto vende deri ne atë pike, sa qe dhe vet klasa punëtore u çorodit aq shumë sa qe humbi besimin te Partitë Komuniste. Po mos vallë ky është komunizmi i Marksit dhe kështu do te përfundonte çdo revolucion leninist?! Nëse do të ish kështu, atëherë do të ishte e kotë të luftohej për nje jetë tjetër pa shtypje e shfrytëzim klasor. Nese do të ish kështu ne djall dhe librat e marksizmit dhe teoritë revolucionare të Leninit! Por ja qe absolutisht që nuk është ashtu, sepse tradhtia qe mund tu behet idealeve, apo dhe rrugët e shtrembëta e jo të drejta qe mund te ndiqen nuk do te thotë se i tillë na qenka "Kapitali" i Marksit, se... "Revolucionin leninist" qenka nje aventurë e kote qe shkaktonte gjakderdhje. Jo absolutisht qe jo! Degjenerimi i Partive komuniste dhe largimi nga rruga revolucionare e Marksit dhe kalimi ne "mënyre paqësore ne rrugën kapitaliste" vërteton edhe nje here ligjësitë ekonomike janë përcaktuese. Kjo do të thotë se nëse ne këtyre ligjësitëve nuk u përmbahemi me rigorozitet atëherë prona socialiste degjeneron dhe degjenerimi i parë i saj manifestohet me sasinë dhe cilësinë e dobët ne rjesinë e kohës duke mos ecur paralelisht me revolucionin tekniko-shkencor. Ja pse kapitulluan njera mbas tjetres shume vende te ish bashkësisë socialiste, ja pse dhe vet R. Alia si nje autor dhe aktor kryesor i "Tradhtisë së madhe" e deklaroi jo vetëm hapur kalimin ne kapitalizëm por ajo që është dhe ngelet turpi më i madh i historisë është deklarata e tij se... "Me kalimin ne ekonominë e tregut kapitalist e rinj do te jemi ne, ne ish komunistet dhe kurrë s'kemi për t'ju u dorëzuar pushtetin klasës qe përmbysëm". Më hipokriti i cili derdhte lot mbi arkivolin e Enverit dhe

betohej pre rrugën e vazhdimësisë. Mjerani nuk e kuptoi se ai dhe kasta e tradhtisë qe e shoqëroi ne Kongresin e 10 te PS...përmbysi gjithë fitoret dhe pikërisht jua u dorëzoi pushtetin borgjezisë së re, asaj borgjezi e cila si rezultat i tradhtisë dhe degjenerimit material, moral e shpirtëror vinin nga komunizmi. Pra "Kapitali" i Marksit ne aspektin filozik është nje uragan i madh nje furtunë që paralajmëron rënien e pashmageshme te kapitalizmit dhe imperializmit, por ky "Kapital" (ky libër kaq i mallkuar qe tmerron borgjezinë) për here te pare u bë jo vetëm mallkim për kapitalizmin dhe imperializmin, por ky "Kapital" mbase pa e ditur dhe vet Marksit do te behej nje mallkim për degjenerimi e gjithë atyre partive dhe komunisteve te cilët devijuan, tradhtuan dhe ju larguan aspiratave te popujve te tyre. Ka me shume se 150 vjet qe Marksit e shkroi këtë libër. Mbase atij kurrë nuk do ti shkonte ndërmend se do te kish dhe Parti Komuniste qe do e nëpërkëmbin mendimin e tij ne fushën e ekonomisë dhe te filozofisë materialiste. Atij kurrë nuk mund ti shkonte nder mend se vendi me tipik i shfaqjes se tipareve thelbësore te kapitalizmit klasik do te ishte Shqipëria vendi nga ku për hir te "demokracisë se vërtetë te munguar" do të kthehej ne nje anarko shtet... "që nuk e merr vesh qeni të zonë", ne nje shtet ku klasa e përmbysur e bejlerëve dhe agallarëve të dikurshëm para çlirimit apo dhe borgjezëve te Lumo Skendos apo dhe kapëdanë te tipit Rrem Bajraktari dhe E.Toptani, do të njehsoheshin me Sali Baben me dyzet e kusur hajdutë, me aventurieri si Nano narkoza, me trima kokë mendje shtrembër si Meta, me aventurieri si Ramë karagozi etj...etj. Kemi me shume se tre dekada qe plaga e hemorragjisë dhe rrjedhjes së rinisë shqiptare nëpër Evropë s'ka te ndalur, ashtu sikurse s'kanë te ndalur vrasjet qe shteti u bën shtetasve te vet, jemi populli me i varfër i Evropës qe vidhemi nate e dite qe na pine gjakun, qe na vrasin ne mes te bulevardit, qe na mbytin ne Otranto sikur te jemi fëmijë jetimë, qe na pushkatojnë ne mes te bulevardit, qe na kurverojne si te duan e kur te duan qe na kanosin me dy kushtetuta njera e xha Saliut dhe tjetra e Lekës se Dukagjinit.



# Mjekët u dënuan, po drejtuesit keqmanaxhues të spitaleve publike?

Nga Pirro PRIFTI

**N**gjarja ne Onkologjik ishte nje ngjarje e paralajmëruar. Megjithëse Ministria e Shëndetësisë ka qenë në dijeni të keqmanaxhimit të Spitaleve Publike të cilat vazhdojnë të mbeten kripto-spitale publike dhe që në fakt janë kthyer në spitale private pa qenë të tilla, por që paratë e pacientëve shkojnë në xhepat e disa mjekëve, disa infermierëve dhe ndërmjetësve në formë mitmarrje dhe pagesë për operacionin, shtrimin në spital, për gjetjen e medikamenteve ku mendohet se rreth 10 mijë deri në 50 mijë euro extra në javë harxhohen nga pacientët për tek punonjësit e spitaleve publike për kujdesin e tyre shëndetësor, në një kohë kur këta pacientë kanë paguar dhe paguajnë çdo muaj tarifën shëndetësore 3.4%. Pra sipas të dhënave të Bankës Botërore pagesat ekstra të pacientëve shqiptarë shkojnë nga 280% në vit-550% në vit, në një kohë kur shpenzimet shtetërore shëndetësore publike mbetet 11.3% të shpenzimeve të përgjithshme publike. Pra qytetarët harxhojnë ekstra për çdo shërbim mjekësor publik, dhe ato shërbime publike mjekësore të cilat nuk i bëjnë dot në publik, i harxhojnë paratë tek spitale private ose paguajnë ekstra (nën dorë) tek mjekët e Spitaleve. Kjo ndodhi edhe tek Onkologjiku dhe kështu ka ndodhur përreth 34 vite të demokracisë. Maja e Ajsbergut shihet nga populli vetëm tek shpenzimet ekstra qoftë tek private ashtu edhe tek publiku si shpenzime ekstra (pagese nën dore) mjekëve të spitaleve publike, dhe këta mjekë para



se të shkojnë në Prokurori. u duhet hequr Licenca nga Urdhri i Mjekut për shkelje të Etikës dhe Rregullores së Spitalit. Problem kryesor qëndron tek drejtuesit e Shëndetësisë të cilët kanë bërë keto keqmanaxhimë të Spitaleve publike si dhe papërgjegjshmëria e nga ana e Politikës shqiptare dhe e qeverisjes në fuqi. Ku qëndron problemi Kryesor i Keqmanaxhimit dhe si mund të rregullohet? Rregullimi i Manaxhimit të Spitaleve Publike do të eliminonte mitmarrjen, disiplinën e shkelur profesionale mjekësore, do të largonte mjekët specialistë të korruptuar, do të mund të rregullonte job description të çdo kategorie mjekësh specialistë publikë qoftë në spitalet terciare ashtu dhe në ato regjionale nëpërmjet kontratave të punës, do të stabilizonte që të viheshin në funksionim Protokollat mjekësore sipas specialiteteve si dhe për ato të Urgjencave, do të mundësonte futjen në punë me konkurrim dhe intervistë të mjekëve specialistë më të mirë për Spitalet terciare (universitare), do të mundësonte Vendime të Ministrisë së Shëndetësisë për të përcaktuar se kush janë mjekë që punojnë në privat dhe kush në Spitale Publike, dhe nuk do të lejonte dy-punësimin korruptiv, por do të rriste rrogat në mënyrë cilësore edhe nëpërmjet bonuseve, do të aktivizonte Kartën e Shëndetit dhe nuk do të lejonte që, në Spitale publike të drejtohen nga militantë, jo-profesionistë dhe individë pa integritet. Një nga Objektivat kryesore të rregullimit të Menaxhimit Shëndetësor të Spitaleve publike janë: rishikimi i PPP të check-up ku është abuzuar në mënyrë flagrante sepse në këtë PPP nuk janë përfshirë moshat mbi 70 vjeç, nuk paguhen mjekët dhe infermierët që punojnë për check-up; PPP i veglave kirurgjikale sepse nuk mund të bësh PPP (partneritet publik privat)

kur aktualisht nuk kishte dhe nuk ka probleme për kirurgjinë. Problemet kirurgjikale kanë të bëjnë me rregullimin e numrit të operacioneve të planifikuara në vit, numrin mesatar të urgjencave kirurgjikale dhe ato mjekësore. Gjithashtu problem i madh janë rregullimi i PPP për laboratorët mjekësore, sepse, ndonëse është rregulluar disi problemi i analizave mjekësore në spitalet publike, nuk është rregulluar problemi i laboratorëve për analiza mjekësore ambulatorë publike, sepse pacientët detyrohen të shkojnë në laboratore private. Problem i madh i keqmanaxhimit është mos gjetja e medikamenteve për pacientët e shtruar në spital publik sidomos të medikamenteve anti-kanceroze tek onkologjiku, ku pacientët detyrohen të blejnë disa nga medikamentet spitalore në Farmaci ambulatorë. Problem i madh mbetet disiplina në punë në spitalet publike dhe kontrolli i mjekëve dhe infermierëve se si ata e bëjnë punën, dhe si infermieret kujdesen për pacientët. Problem tjetër është kontrolli për rrezatimet në Spitalet Publike si për rrezatimet nga Kobalti, rrezatimet nga rrezet Rontgen dhe medikamentet diagnostike rrezatuese. Këtu hyn në punë edhe Ministria e Mjedisit që kontrollon rrezatimin. Dihet se Ministrat e Shëndetësisë janë aktualisht edhe drejtues të Komisioneve për Rrezatimin kështu që duhet të mbajnë përgjegjësi penale për mungesën e kontrollit. Dihet aktualisht që rrezatimi i Kobaltit sipas referimeve është 20 herë më i lartë se norma në vendin ku është aparat. Pse? i gjithë sistemi drejtues shëndetësor ka përgjegjësi penale për problemet e pa realizuara sepse kanë shkelur ligjin dhe sepse nuk ka zbatuar rregulloret dhe ligjet. Një nga Problemet e vjetra të pazgjidhura janë këshilltarët e Ministrat të cilët duhen përzgjedhur me

kritere profesional e dhe meritokratike dhe jo me militant e miq dhe njerëz pa përvojë. Këta kanë shkaktuar këto pasoja. Problemi kryesor tjetër mbetet harxhimi jo profesional i buxhetit të shtetit për Shëndetësinë i cili aktualisht është: GDP për Shëndetësinë në Shqipëri; \$25.297 billion (nominal, 2024); \$59.099 billion (PPP, 2024). Ndërsa shpenzimet publike për shëndetësinë u ulën nga 3,7 % e PBB-së në 3,6 %, shpenzimet totale për shëndetësinë ranë nga 4,7 % e PBB-së në 4,6 %. Për Shqipërinë, të dhënat disponohen vetëm për shpenzimet e shëndetit publik. Kjo u rrit përkohësisht si pjesë e PBB-së nga 2,7 % në 2011 në 3,4 % në 2021. Pra kemi GDP për Shëndetësinë buxhetin më të ulët se vendet fqinjë jashtë BE. Problemi qëndron se edhe ky buxhet administrohet nga drejtues të Shëndetësisë publike që nuk janë as profesionistë dhe as meritokratë por militantë dhe miq të politikës. Më saktë, Sistemi Shëndetësor publik është në një anarki të plotë administrative dhe funksionale ku pacientët detyrohen ose të paguajnë nën dorë në Spitalet publike ose të shkojnë në privat e të harxhojnë shuma të konsiderueshme parash në një kohë që po të ishte në rregull Sistemi publik nuk do të paguanin për shërbimin. Problemi tjetër i madh është Fondi i sigurimeve Shëndetësore sepse nuk po mbulon plotësisht me siguracion Spitalet publike si dhe nuk po aktivizon Taksën e Shëndetit me anë të të cilës do të eliminohejshin pagesat ekstra (nën dorë) qoftë për shtrimet, operacionet, qoftë edhe për radhët për bërjen e ekzaminimeve. Problem tjetër i madh është mungesa e kontrollit dhe mos përfshirja në librin e Barnave të Medikamenteve Onkologjike dhe atyre Biologjike.

## Morali i politikës është guri i çmuar në rrugën e saj

Nga Gjon NEÇAJ

**S**humë është shkruar e thënë këto kohë për moralin në përgjithësi, por veçmas për moralin në politikë. Politikani i suksesshëm duhet të udhëhiqet sipas parimeve morale. Skena jonë politike më tepër u përngjan telenovelave që kanë mbushur ekranet shqiptare, sesa politikë-bërjes serioze. Intrigat, dredhitë, përbaltja e kundërshtarit politik kanë përparësi ndaj analizave politike dhe strategjive zhvillimore serioze. Kalimi nga njëra parti te tjetra, kandidimi i pamoralshëm për të qenë përfaqësues i sovranit që nuk pyet fare pas hipjes në fron, shfrytëzimi i padrejtë i pozitës shtetërore, konsiderohen veprime normale të një shoqërie të pakënaqur. Dalëngadalë në shoqërinë tonë po paraqiten dy lloje të moralit që s'kanë asgjë të përbashkët. Morali i politikës dhe jetës publike nga njëra anë dhe morali i njeriut të thjeshtë nga ana tjetër. Morali i njeriut të thjeshtë synon të arrijë idealet në infinit, duke zbatuar porositë, detyrat dhe obligimet që ia përcakton shteti, kurse përfaqësuesi i këtij

shteti, në kontrast krejt të ndryshëm dhe të përcudnuar, vepron kundër interesave të tij dhe shtetasit. Shoqëria shqiptare në mbarë hapësirën e saj duhet detyrimisht t'i çrrënjosë tashmë kulisat e ndërthuruara të lidërshpitit dhe politikanëve, që të zhvishen nga dozat e tepruara të moralit politik e të jenë të barasvlershëm me shoqërinë, se ajo është tepër përpara, shumë e shumë më përpara se udhëheqësve partiakë dhe kuvendarëve. Por e vërteta në mes të gënjeshtrave është krejt ndryshe. Mendojmë se forcat politike në pushtet duhet të përcaktojnë dualitetin shtet-pushtet, në zbatim të ligjeve kushtetuese. Demokracia të mos prodhojë konflikte të panevojshme mes politikanëve, pushtetarëve dhe partive, por me vizionin përcaktues të hartojnë strategji të reja për zbutjen e varfërisë, që kurba e papunësisë të ulet, dëshirojmë që të ketë energji elektrike dhe ujë për çdo ditë, të ketë sa më pak sharje në Parlament e sa më shumë të ardhura për të varfrit, drejtësi për të gjithë, të mos ketë vrasje, vetëvrasje, krizma tritoli, kërcënime, përdhunime, as keqpërdorime dhe bindjet politike të mos përdoren për interesa të ngushta vetjake, siç ka ndod-

hur dhe ndodh rëndom. Duke dialoguar me vetveten, deshifroj thënien e një rilindasit tonë të madh, se Shqipëria është e shqiptarëve, e të gjithë jemi përgjegjës ndaj atdheut, ndaj kombit. Secili prej nesh ka një pjesë fajësimi që t'i nderojmë njësoj heronjtë e kombit, të kemi ekonomi të intensifikuar, tokë sa më shumë të punuar, pyje të gjelbëruara, ara të punuara, lumenj të pastër dhe një Shqipëri kryezonjë siç e kanë ëndërruar rilindasit këtu e para një shekulli. Milionat e eurove, duart e mbushura me orë të florinjta, zinxhirë, varëse qafe të gjyqtarëve, pushtetarëve e kadrove drejtues të shtetit, po kaluam infinitin e përsëritur të korrupsionit, sovranit do të kthehet idhshëm ndaj tyre e do ua zënë frymën me varëset milionëshe të këtyre njerëzve, që në emër të popullit po montojnë një demokraci mjerrë. E sovranit pret e pret jo vetëm reformën e thellë në sistemin e drejtësisë, por krejt kupolën ligjvënësë e qeverisësë. U godit rëndë përfaqësimi si gur themeli i demokracisë, u futën listat e mbyllura të kryetarëve për deputet. Argumenti ishte për të sjellë elitat në Parlament, për të mos qenë përfaqësues ata që janë të fortë e kanë xhepa të thellë

dhe pastaj u detyruan të miratojnë ligjin e dekriminalizimit, pasi hynë të papërshtatshëm. Parlamenti i Shqipërisë nuk ka përfaqësues të popullit, por thjesht punëtorë me mëditje të kryetarëve të partive. Ata për votën në Parlament marrin ofiqe prej kryetarëve kur vijnë në qeverisje, madje dhe kur mbesin në opozitë si tendera, punësime të pamërituara të njerëzve të tyre etj. Shikoni administratat shtetërore, ato doganore e tatimore, pushtetin gjyqësor, bordet e rëndësishme lokale e qendrore, agjencitë shtetërore e deri tek funksionet më të rëndomta, të mbushura me të afërm të deputetëve të të gjitha partive. Aspak më shumë se dhjetë për qind e tyre nuk i kanë merituar dhe nuk i meritojnë këto funksione. Ky është privatizimi i Kuvendit dhe i administratës shtetërore nga kryetarët e partive, të cilët asnjëherë nuk cenojnë të afërmit e palës tjetër, por shtojnë radhët. Kjo ka bërë që të kemi jo vetëm administratën më të dobët në Evropë, por dhe më të fryrën për mijë banorë. Deri më sot opozita nuk ka artikulluar shkallmimin e sistemit të përfaqësimit, këtë sistem që lind autokrat, arrogant e bajraktar të tipit feudal.

## k o m e n t e &amp; a n a l i z ë

Nuk duhet “t’i fusim krahun” demokratëve,  
për pazaret Berisha-Rama!

Nga Qamil GJYREZI

L oja Berisha-Rama ka filluar, që në vitin 2008 politikisht dhe juridikisht me ndryshimet kushtetuese. Berisha-Rama filluan lojën duke iu ‘futur gishtin’ shqiptarëve. Kurse sot në 2024, duan t’i fusin krahun, ndjesë për gjuhën urbane. Citova nje deklaratë të kryetarit të PD së Z Lulzim Basha, në emisionin Open që gazetarët me provokimet e tyre të bëjnë të dalësh jashtë karakterit me fjalë dhe sjellje. Juridikisht, Kryetarë i PD- së është Basha, mbasi vendimi i Ape lit, do të ankohet në Gjykatën e Lartë deri në Strasburg, pavarësisht se është njohur politikisht. Gjyqtaret që e morën vendimin u pyetën dje nga observërat amerikanë dhe trupa juridike duhet ti padisi në SPAK nëse ka shkelje ligjore. Populli thotë se kur nxe het i Urta, duhet patur kujdes prej së vërteti

gjithmonë politikisht. Nuk komunikohet me një kandidat për Kryeministër me atë gjuhë, mbasi gazetaret kanë mision tjetër dhe politikanët kanë mision gjithashtu tjetër. Studiot televizive nuk janë gjykata, as logu i burrave, as prokurori, as Big Brodher por kanë përgjegjësi për opinionin publik. Po e shkruaj që në fillim, që çelësat e Kryeministrit ne Shqipëri Rama, nuk do t’i dorëzojë kujtdo, siç janë dorëzuar me marrëveshje dhe lojë deri në 2013. Kryeministri i ardhshëm, nuk do ti marri çelësat pa hipotekë dhe me lojë e pazare, prandaj sulmohet Basha! Unë e kuptoj fare mirë që disa gazetarë dhe opinionistë përfaqësojnë klane dhe grupe interesi politiko-financiare dhe nuk ia plas për ndryshimet e vërteta pa lojë e marrëveshje politike. I vetmi njeri që nuk ishte pjesë e marrëveshjes së 2008 është Lulzim Basha. Prandaj Basha flet me kompetence për lëvizjen e lirë dhe

anëtarësimin në NATO, këtë e di mire Berisha dhe Rama. Do të shkruaj me prova e fakte nje opinion për këtë temë. Ish-ministrit të Jashtëm Besnik Mustafaj ia kanë marrë çelësat e ministrisë ne Orën 5 të mëngjesit para anëtarësimit tonë në NATO. Administrata Bush nuk ka patur besim në 2008 as tek Berisha as tek e Mustafaj aq më pak. Amerikanët dhe europianët Franko Fratini kanë mbështetur në vitin 2008 Lulzim Bashën. Është mëse e vërtetë, se nëse nuk do të ishte ministër i Jashtëm Lulzim Basha, ka të ngjarë edhe sot në 2024 nuk do të lëviznim pa viza. Nuk duhet harruar kurrë edhe rruga gjeo-strategjike e Kombit?! Ndryshimet kushtetuese të 2008 me akte politike dhe gjeo-strategjike nuk i ka mbështetur vetëm Basha. Pjesa tjetër e Liderhipit të kohës, Topalli, Patozi, Olldash, Bregu, Bode, Imami, Ruli, etj, etj, “delfinët” e Ramës e kishin mendjen

tek karrigia e Kryetarit të PD-së. Por Berisha i ka njohtë mirë këtë grup pseudo-demokratësh prandaj edhe i bëri ministra dhe i kontrollonte gjitha planet duke iu futur së pari gishtin shqiptarëve! Prandaj me të drejtë Lulzim Basha deklaroi se nuk do të lëmë t’iu fusim krahun, biles me gjeste, shqiptarëve për pazaret Berisha-Rama 2008-2024! Ata që mbështesin Berishën dhe Foltoren, kanë vënë shishen e qumështit dhe presim largimin e Berishës në 2004 karrigen e Kryetarit dhe Kryeministrit në 2029, ne kurriz të shqiptarëve. Demokratët euro-atlantikë do të bëjnë betejë politike dhe ligjore me anë të rekursit në Gjykatën e lartë dhe në Strasburg, për të penguar pazarin Berisha-Rama, për të sjellë ndryshimin dhe per ti dhënë të gjithë shqiptarëve edhe gazetarëve të paguar, demokratëve dhe biles edhe te majtëve Shqipërinë që duam, pa korrupsion dhe krime!

## Udhëkryqet “me vulë” të opozitës tonë

Nga Bardhyl ERMINI (Bejo)

T ek ne, a thua se jemi në ndonjë vend të izoluar andej nga “Saharaja afrikane”, politika ushtrohet nëpërmjet një praktike të shëmtuar e primitive. Individë, grupe e parti politike, bëjnë thirrje kundër pushtetit me një fjalor tmerrësish të lodhshëm e të konsumuar. Emërtimi i Edi Ramës si “kapobandë e drogës dhe pastrimit të parave apo si “kryehajdut” i votave, është kthyer në një pasaportë me të cilën mund të zbresësh nga avioni “bombardues” i luftës për pushtet, pa e munduar veten të japësh argumenta reale ekonomike dhe politike për ta merituar atë. Klasë e pështirë, pas të cilës hiqet zvarrë edhe një tjetër brez i ri politik, i cili ta shpif kur i dëgjon duke konsumuar demagogjinë e vjetër me të cilën janë ushqyer, frika ndaj përdhosësve të vërtetë të demokracisë dhe servilosja e pështirë. Paaftësi, administratë e korruptuar, nepotizëm, vjedhje, krim, drogë, pastrim parash, etj. Kjo lloj gjuhë tashmë, përvetëse e lodhshme dhe e konsumuar është bërë kaq e zakonshme sa gjithçka duket normale. Aprovohen ligje radhë ku nuk e merr vesh i pari të dytin, bëhen seanca parlamentare ku dhuna zëvendëson komunikimin politik, bëhen revolta pa objektiv përveç zjarrit dhe bombave molotov, dhe në mbrëmje nëpër ekrane të mara fund, detyrohemi të dëgjojmë plot budallallëqe përgjithësisht nga lloj-lloj fytyrash “kritike”, të cilët i bashkon demagogjia e injoranca. Dhe ditët zënë njëra tjetrën, nën rënkimin e një vendi që nuk e di se ku është dhe nga po shkon, përveç faktit që zgjedhjet e radhës i ... mbeten në dorë përsëri zotit Edi Rama. Si është e mundur? Si është e mundur që nuk ka opozitë të vërtetë? Si? Fare e thjeshtë! Sepse kjo gjendje është rezultat i lojës primitive të politikës apo më mirë i politikës tanë abuzues deri në paturpësi. Ata, të cilët nuk arrijnë të kuptojnë se kanë dalë jashtë kohe. Duke përvetësuar “familjarisht” tezën se investimi më i mirë për të fituar është të merresh me politikë, janë futur aty me të gjithë forcën e shpirtit të tyre të përtharë nga humanizmi dhe nga ndershmëria, në se me këtë fjalë përmbled

dhim përpjekjet për drejtësi e barazi shoqërore. Boll të shash e sajosh episode dhune dhe qytetarët “do të binden” për të votuar ndërrimin e pushtetit. E quajnë se populli nuk është gjë tjetër përveçse një tufë me “injorantë” që nuk kuptojnë, por vetëm jetojnë për llogari të atyre që duan të ndërrojnë vetëm ngjyrën e karrigeve të pushtetit. Pa e kuptuar aspak se në demokraci pushtetet zëvendësojnë njeri tjetrin vetëm kur sasia kthehet në cilësi, vetëm atëherë kur pushteti i ardhshëm e mohon cilësisht atë që zëvendëson. Cili është mekanizmi, argumentet politike dhe ekonomike, nëpërmjet të cilave “opozita” do të “fitojë zgjedhjet përballë regjimit të dështuar të Edi Ramës”? Po i rendisim më me hollësi këto argumente, pasi janë tepër “të rëndësishme” nga pikëpamja ekonomike dhe shumë “të thella” nga ajo politike. Së pari “paaftësia dhe administrata e korruptuar”. Dhe kush e thotë këtë pyet qytetari i thjeshtë? E thotë “nona e korrupsionit”, ai që e katandisi drejtimin e shtetit në drejtimin e interesave të veta familjare, duke implikuar në të, deri edhe në Këshillin e Mbrojtjes, persona me një qëndrim dhe histori armiqësore me Shqipërinë. E thotë ai që “mbolli” gjyqësorin nën hijen e plepave të Golemit, ai që mbushi administratën dhe policinë e shtetit me militantë partiakë, me elementë negativë e të dështuar të administratës “ish komuniste”, me diletantë injorantë e falsifikatorë. Jo, qytetari nuk do që t’i dëgjoj zërin këtij drejtimi e kësaj administrate. Për të, më mirë “vezën” e sotme se sa “pulën” e rrjepur e të gënjeshtert të së nesërme. Së dyti “vjedhje e pastrim parash të pista”. Por kush na premtuaka të kundërtën se! Ai që i batërdisi shqiptarët në 97-ën e tmerrshme, ai që e ktheu privatizimin e ekonomisë në një garë batakçinjsh, në një katrahurë që do të përkujtohet përherë siç ligji famëkeq 7501, i cili gjatë zbatimit të tij u kthye në një luftë për pushtim pronash dhe pasurimin e banditëve politikë, për deformimin e krejt vendit nga një atdhe të shtrenjtë, në një tokë të “djegur”, i cili nuk do të arrijë të përtërihet dot edhe pas njëqint vitesh. Po pse çfarë e kujtoni ju zotërinj “opozitarë” qytetarin? Pse i duhet atij të pranojë këta lloj hajdutësh të ndyrë? Jo, më mirë për të janë këta “skuthat”

e sotëm, të cilët sidoqoftë e njohin frikën. Së treti “nxitje e drogës dhe krimit, qeveria e drogës dhe e krimit”. Dakort! Janë kapur në fakt ministra, kryetarë bashkish dhe drejtorë e janë futur në burg. Por çfarë çudie! Kush e bën këtë akuzë? E bën ai, shkaktari kryesor që u vranë rreth 3500 djem me armët që ju a la në dorë, më i tmerrshmi i historisë të pluralizmit shqiptar, ai që ngrii avionë me qëllim që të bombardonte e të helmonte krahina të tëra të jugut, ai që të vriste në mes të bulevardit, që të mbyste burgjeve politike, që hidhte në erë fshatra duke i bërë pre të fitimeve të tij kriminale, ai që bën edhe sot thirrje për luftë e për revolucion turmash, ai që për hir të pushtetit të vet të vret e të pret, të shet e të blen si në pazar të bagëtive. Jo mor vëlla, nuk ja ka ngenë më qytetari i thjeshtë këtij e këtyre monstrave. Mbyll një sy e jepu votën “zorraxhinje” të sotëm. Të paktën këta “të vjedhin”, por nuk të vrasin si qen. Përgjithësisht kjo është klima politike që mbizotëron dhe mentaliteti i qytetarit që voton, e atij që kupton gjithçka, por që ka në dorë vetëm një “atu”, votën, e cila shpesh i është kthyer nga një mjet fitoreje në një gënjeshtër, me një fuqi të tillë “magjike” që ka gënjer edhe ... vetë atë qytetarin. Demagogji, gënjeshtër e luks i rremë, ja kështu ka dashur politika jonë të ndërtojë themelet e të ardhmes të vendit. Dhe ç’është e vërteta ja ka arritur. Ja ka arritur duke e përjashtuar qytetarin e thjeshtë nga lufta për zhvillim, duke e futur atë në dyert e botës të frikshme të varfërisë e të pasigurisë, në mjegullnajën e theqafjes e mungesës të perspektivës, në mungesën e plotë të alternativave demokratike. Ai, qytetari ka sot vetëm një mundësi, “levën” e mashtrimit, të zgjedh më të mirën ndër të këqijat. Sepse nuk ka asnjë lloj mundësie tjetër. Dhe tani, mendoni për një moment : qytetari përjashton nga listat e veta p.sh. Edi Ramën, Ballukun, Ballën, Gjijnurin, Klosin, Spiropalin, Braçen etj. dhe në vend të tyre të vendosë Sali Berishën, Bardhin, Nokën, Vokshin, Saliannin, Palokën, Balliun etj! Thjesht të vjen nëpërmend të këndosh një varg popullor të rëndomte por tepër domethënës, “vare veten me litarë o Dino”. A mund të vazhdojë kështu ky qytetari “ynë”? Të paktën edhe pesë vite të tjera po,

kështu do të vazhdojë, do të vazhdojë të zgjedh më të mirin e të këqinjve! Kjo është rezultati i jo më pak se dhjetë viteve të një opozite, e cila në mënyrën më injorante të mundshme ka bërë një luftë donkishoteske me fraza e pa ide, me urrejtje e jo me urtësi, me dhunë e jo me demokraci dhe mbi të gjitha me një anti-amerikanizëm demagogjik të hapur e të çuditshëm, të brumosur në degradim moral dhe financiar. Lëvizjet e ndodhura kohët e fundit, pas gjykimit “jashtëzakonisht profesional” juridik të përkatësisë të vulës të PD, kanë nxjerrë në pah “diçka” pozitive. Fakti që shumica e parlamentarëve “opozitarë” bëjnë sikur nuk e kanë “kuptuar” se historia e vulës dhe e ndarjes të tyre në “grimca” ka ndodhur 100 përqind për shkak të faktit “non grata” të Berishës (armiqësisht të tij me administratën e shtetit) e jo të dobësive apo moskonsequencave të Lulëzim Bashës, ka bërë një “sitje” racionale. Demagogjia e miqësisë me SHBA, nëpërmjet të cilës parlamentarët “demokrat” përpiqen të maskojnë frikën nga Berisha, servilizmi i pështirë dhe degradimin e tyre politik, kanë bërë që të faktorizohet fare qartë se kush janë ata që nuk duhet të të dalin më në skenën politike, ata që kërkohen “PD - në e vërtetë” apo më saktë emrin në listën e parlamentarëve parazitarë. Dy janë mundësitë e vetme në këtë ambient të “damllosur”. Opozita më reale që mund të konsiderohet sot e mundshme në kushtet e demokracisë tonë, është bërthama që përfaqëson zoti Alibeaj me kolegët e vet dhe me bashkimin e tyre me të tjera figura të përngjashme në pikëpamje, si zotërinjtë Astrit Patozi, Dash Shehu etj. Ose, ose ... një zgjidhje tjetër alla shqiptarëshe nuk është e pamundur. Gjatë mandatit tretë të zotit Rama, të cilën tashmë ai e ka në “xhep” dhe nën frymëzimin e rrugës të tij ideologjike të “përtej të majtës dhe të djathtës”, le të presim investimin e tij për përtëritjen e ... PD (partisë të rinisë të vet), si opozitë e të ardhmes dhe alternativë për të fituar në 2030, pas të cilës ai mund të dorëhiqet i qetë për të vazhduar pikturat e tij të lëna përgjysmë. Për të mos u dukur si çudi, disa elementë të tillë kanë filluar të duken. Rrugë tjetër edhe për një “epokë” nuk duket më!

## k o m e n t e &amp; a n a l i z ë

www.sot.com.al

## Kur do, shteti e kap lepurin me qerre

Nga Dhimitër SHTËMBARI

Ajo çka u zbulua ditët e fundit në spitalin Onkologjik prodhoi një "habi" të madhe në institucionet shëndetësore dhe krijoi një zhurmë jo të vogël në tërë mediat shqiptare dhe në organet shëndetësore e shtetërore. Prodhoi "habi" në këto, por aspak në opinionin e gjerë publik! Populli e dinte, shteti bënte sikur nuk e dinte! Nga që njerëzit i kishte zënë e keqja, s'kishin se si të vepronin, prandaj ishin pajtuar më të keqen. Ulnin kokën, shisnin bagëtitë dhe blinin sa frëngu pulën për të blerë ilaçin, që jepej falas nga shteti! A beson kush, se ministrat e Shëndetësisë nuk e dinin që operacionet në spitalin shtetëror kryheshin me pagesë? Ajo që i ka shqetësuar shumë mjaft mjekë është se korupsioni plasi hapur si fluskë sapuni. Doli sheshit, me emër e me mbiemër mjekësh, që nuk mund të mbulohej dot edhe pse, fatkeqësisht, disa "avoketër" mjeranë të tyre mundohen ta minimizojnë, si për të mbuluar me jorgan një të sëmurë rëndë që lëngon! Pyetja më e parë që i lind kujt do është: po vet Shteti a mund ta parandalonte një skandal të tillë të bluzave të bardha? Përgjigja të vjen e thjeshtë: absolutisht po. Sepse ai i ka të gjitha mjetet për t'i prerë rrugën një veprimtarie të tillë kriminale, që pasuron një kategori njerëzish nëpërm-

jet vdekjes së të sëmurëve! Ajo çka pas shkruar e ndjera Ina Kasimati ka qenë një kabanë alarmi për këto që ka vesh. Ajo çka treguar ajo lipset të bëhet afishe dhe të vendoset për t'u mbajtur gjatë në derën kryesore të spitalit Onkologjik. Në spitalet shtetërore franceze, gjermane, italiane etj., siç janë dëshmitarë shumë nga emigrantët tanë, pacienti shtrohet në spital e operohet pa asnjë shpenzim. Ngjet kështu, sepse në këto institucione "shikon" dhe "dëgjon" Shteti. Pranon dhe përfill vetëm dokumentacionin. Sado e vogël të jetë një shkelje, atje menjëherë analizohet dhe, sipas shkallës së asaj shkeljeje, aty për aty merren masat. Cilit mjek i hyri gjemb në këmbë në Shqipëri?! Edhe një mjeku të mirënjohur të zemrës që u fut kanaleve të Drejtësisë, "e keqja" i erdhi aksidentalisht. Jo nga institucioni i tij, por ra në rrjet nga përgjimi që i bëhej një punonjësi të Drejtësisë! Disa mjekë janë dërguar djerve të Drejtësisë drejtpërsëdrejti nga prindër që u ka ndodhur fatkeqësia në spitale. Nga institucionet shëndetësore, domethënë nga Shteti, nuk ka të paditur! Madje, ka pasur raste që nga këto zyra janë mbrojtur! Thuajse çdo ditë ka të arrestuar për shkak të kultivimit të drogës. Hap televizorin dhe lajm të parë do të kesh vënien në pranga të atij apo të atij, që iu gjetën kaq apo aq bimë kanabis! Teksa mëson këto, natyrshëm të lind pye-

tja: si mund të kultivohet kanabis dhe, ca më shumë, si mund të sigurohet në fshat laborator përpunimi të kokainës? Shteti nuk është vetëm Edi Rama, as Erion Veliaj dhe as Tauland Balla. Shteti është edhe ai kryeplaku atje në fshat, që duhet të dijë se çfarë mbillet e korret parcelave të fshatit. Bëjnë të paditurin në Frakull të Fierit për një laborator narkotikësh, a thua se bëhej fjalë për një tullë të vendosur mbas gardhi! Shteti është edhe ai mjeku, mësuesi, infermieri, ekonomisti, agronomi a tjetër që banon në fshat dhe i bie rruga të kalojë mes fshatit, ku rasti e bën të shikojë këtë apo atë bimë narkotike. Nuk është spiunllëk kur lufton të mbrosh ligjin. Është vënë re, se shteti ndërhyr kur shkelja arrin të bëhet skandaloze, kur për shkak të saj publiku irritohet në kulm. Mësojmë ditët e fundit, se Shteti ka ndërhyrë për prishjen e disa ndërtimeve pa leje në plazhe! Që ndërhyr, bën mirë, por... tani, në sezon plazhi, kujtohet shteti?! Dhe kur themi shteti, fjala nuk është thjesht për Qeverinë, por për bashkinë, për njësinë administrative. E paska më të vështirë bashkia të shkatërojë një ngrehinë në çastin e ngritjes, se në kohën kur pushuesit janë në breg të detit për plazh?! Para pak javësh kryetari i SPAK – ut tha një fjalë të madhe: kemi shumë pak, për të mos thënë aspak, denoncime nga vet administratat e institucioneve të ndryshme! Me këtë deklaratë ai vuri

gishtin në një plagë të madhe: ka heshtje ndaj shkeljeve! Madje, disa institucione orvaten t'i mbulojnë këto shkelje, duke menduar, si duket, "le ta gjejnë nga të tjerët"! Nuk është e thënë, se të gjitha abuzimet duhet t'i kërkojë e t'i zbulojë SPAK – u apo Prokuroria. Janë shumë ingranazhe që të çojnë te Shteti. Bënte kohë që Kontrolli i Lartë i Shtetit kishte zbuluar shkelje në Onkologjik, por s'ishte treguar operativ. Të kishte vepruar në kohë do të mund të kishte ndihmuar në zbulimin e skandalit të këtij institucioni, brenda të cilit vërtitej paraja dhe vdekja. Bëhet mirë që shteti kërkon, ku të jenë, kriminelët shqiptarë dhe i sjellë për gjykim e dënim në Shqipëri. Mirëpo... kur vjen puna për të sjellë në Shqipëri ish Prokurorin e Përgjithshëm "nuk paska fuqi"! Dhe ish Prokurori i Përgjithshëm, që duhej të ishte i pari që të sillej këtu, jeton bukur mirë në një vend të huaj, duke i bërë karshillëk Shtetit shqiptar! Po kështu, ish zëvendëskryeministri jeton si kont në një shtet të huaj, u jep edhe intervista mediave të huaja, pa kërkon edhe azil politik dhe Shteti ynë nuk paska mundësi e fuqi për ta sjellë në Tiranë për të dhënë llogari lidhur me akuzat që i janë ngritur. Si përfundim, kanë ndodhur e vazhdojnë të ndodhin deri edhe skandale, sepse nuk këmbëngul Shteti. Sepse kur do, siç shprehet populli, ai e kap lepurin me qerre.

## Paaftësia në mbikëqyrje e AKEP-it

Nga Bujar LESKAJ

Jam i detyruar të votoj kundër Rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për arsye të mëposhtme:

**Qytetarët pesëfishojnë ankesat, AKEP vendos një gjobë...10 milionë lekë!**

Sipas informacionit nga vetë Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), vitin e kaluar u depozituan në këtë institucion 2,123 ankesa nga pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, në krahasim me 415 ankesa të paraqitura në vitin 2022. Edhe pse ankesat e përdoruesve pranë AKEP, në lidhje me refuzimin e kërkesave për bartjen e numrit celular nga operatori transferues, me mbifaturime, me pengesat apo vonesat për mbylljen e kontratës apo kalimin nga plane tarifore paspagesë në ato me parapagesë, etj., u pesëfishuan gjatë vitit 2023, institucioni veprroi shumë me vonesë, duke vendosur një gjobë ndaj një prej dy kompanive të shërbimeve celulare në vend, tek e cila përqendroheshin 90 përqind e ankesave të qytetarëve, vetëm në nëntor 2023. Masa e gjobës prej 10 milionë lekësh ishte shumë e vogël, gati simbolike, për një operator që qarkullon me dhjetëra milionë euro në muaj. Shumë pak për një detyrë madhore që kishte AKEP vitin e kaluar dhe e ka edhe këtë vit e më tej, atë të kontrollit të rreptë dhe të detajuar të procesit që solli një situatë duopol në tregun e telefonisë celulare në Shqipëri.

**AKEP, i paaftë të mbikëqyrë si duhet situatën duopol**

AKEP u tregua i paaftë të mbikëqyrte plotësisht dhe me profesionalizëm të lartë procesin e ndërlikuar teknik të bashkimi mes dy ish-operatorëve në treg, proces që u reflektua edhe me shumë probleme në shërbimin për klientët. Që prej fillimit të vitit të kaluar, tregu i telefonisë celulare në vend ka vetëm dy operatorë, pas bashkimit me përthithje të operatorëve One Telecommuni-

cations dhe Albtelekom. Kjo situatë shtron rreziqe për rritjen e çmimeve nga dy operatorët e mbetur, për shërbimet që ofrojnë, duke reduktuar përfitimet e konsumatorit, madje, në shumë raste, edhe duke e dëmtuar atë. Edhe pse tërësisht i ndërgjegjësuar për këto rreziqe, sidomos për praninë e sjelljeve bashkërenduese ndërmjet operatorëve në treg, nëpërmjet strategjive të çmimit dhe rritjes së dyshemesë së çmimit për të njëjtin shërbim, përfshirë këtu edhe tarifimin e shërbimeve të tjera shtesë që impaktojnë drejtpërdrejt shërbimin parësor të kontraktuar nga pajtimtari, AKEP nuk ka vepruar energjikisht për parandalimin dhe mënjanimin e tyre. Efekti potencial negativ në situatën duopol të krijuar në tregun celular, ndikohet edhe nga faza e maturimit të këtij tregu, pasi beteja e mundshme për të ndryshuar bazën e pajtimtarëve në një treg ku nuk ka rritje të bazës së pajtimtarëve, do të fokusohet kryesisht për të njëjtën bazë konsumatore, të cilën aktualisht e zotërojnë dy operatorët aktuale. AKEP justifikohet për mosveprimin e tij rregullues, me mangësitë e kuadrit ligjor aktual, i cili nuk i mundëson instrumentet e nevojshme për të ndërhyrë në tregun me pakicë të komunikimeve celulare legjislacionit, kur duhet të ishte vete ky institucion promotor i ndryshimeve përkatëse ligjore! Vitin e kaluar u hodh për konsultim ligji i ri "Për komunikimet elektronike". AKEP nuk provoi me të gjitha mundësitë e tij lobuese që ligji të miratohej brenda vitit 2023 dhe nuk doli asnjëherë publikisht me fushatë sensibilizuese dhe mesazhe të forta, për domosdoshmërinë e miratimit sa më parë të ligjit të ri. Ky ligj u miratua vetëm ditët e fundit dhe kjo vonesë përbën një dështim të madh të AKEP. Le të shprejmë që ligji i ri i sapomiruar, do të zbatohet me ekzigjencë nga operatorët në treg dhe do të mbikëqyret me profesionalizëm dhe përkushtim nga AKEP. Legjislacioni i Bashkimit Europian parashikon se një rregullim ex ante (paraprak) i tregjeve të komunikimit mund të justifikohet, në rastet kur përmbushet testi

i tri kriterëve: (i) ekzistenca e barrierave hyrëse dhe jo kalimtare për hyrjen e konkurrentëve të rinj; (ii) një strukturë tregu që nuk është e orientuar ndaj konkurrencës efektive dhe (iii) pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar problemet e tregut. Edhe pse Autoriteti i Konkurrencës i ka kërkuar disa herë AKEP në dekadën e fundit te punojë për vendosjen në rregullim të tregut celular me pakicë, AKEP e ka kundërshtuar vazhdimisht një rekomandim të tillë, me argumentin e pabazë se testi i tre kriterëve nuk e justifikonte një ndërhyrje të tillë.

**AKEP, tërësisht i përgjumur ndaj sfidës së teknologjisë 5G!**


Zbatimi në Shqipëri i teknologjisë 5G duhet të ketë si përmasë kryesore respektimin e obligimeve tona në fushën e sigurisë si vend anëtar i NATO-s dhe partner strategjik i SHBA-ve. AKEP, edhe gjatë vitit të kaluar, ka qëndruar indiferent ndaj rekomandimit për ngritjen e një Komiteti Kombëtar për vlerësimin e investimeve strategjike për teknologjinë 5G. Në këtë Komitet duhet të ketë përfaqësues jo vetëm të fushës ekonomike, por edhe të fushave të sigurisë, informatike, mbrojtjes etj. Për këtë duhet miratuar një bazë e posaçëm ligjore nga Kuvendi i Shqipërisë. Detyrat e këtij Komiteti duhet të përfshijnë, ndër të tjera, (1) vlerësimin nëse ofruesit e teknologjisë 5G janë subjekt i kontrollit nga një qeveri e huaj, pa një proces të pavarur gjyqësor; (2) vlerësimin nëse furnitorët e rrjetit dhe ofruesit e shërbimit financohen në mënyrë transparente, duke përdorur praktikën më të mira në prokurim, investim dhe kontraktim; (3) vlerësimin nëse ofruesit e shërbimit kanë pronësi, partneritet dhe struktura qeverisëse kooperative transparente; (4) vlerësimin nëse ofruesit janë shembull i inovacionit dhe respektit për zbatimin e ligjit dhe të drejtave të pronësisë intelektuale; si dhe (5) vlerësimin e riskut dhe sigurisë që ofruesit dhe teknologjitë e rrjetit krijojnë një mjedis të sigurt, pavarësi nga ndikimi qeveritar dhe

pajtueshmëri me standardet e industrisë. Aksioma e punës së këtij Komiteti duhet të jetë respektimi i statusit tonë si vend anëtar i NATO-s, konsideruar si investimi më i madh strategjik në fushën e sigurisë kombëtare, që Shqipëria ka arritur në ekzistencën e vet si shtet. AKEP ende është shumë mbrapa për rekomandimin me forcë të masave emergjente të ruajtjes së teknologjisë së informacionit të instaluar në strukturat tona kryesore qeveritare dhe shtetërore në tërësi, nga sulmet kibernetike dhe piratereske, edhe pse shumë struktura nevralgjike si INSTAT, portali "e Albania, etj., kanë qenë objekt dhe janë dëmtuar nga këto sulme vitin e kaluar dhe këtë vit. AKEP i mungon strategjia dhe planet e veprimit për zhvillimin dhe zbatimin e duhur të teknologjive të reja të informacionit. Modalitetet e përdorimit të internetit në administratën publike kanë treguar mungesë procedurash për administrimin e incidenteve në platformat kompjuterike dhe rrjetat e tyre; përdorim jo të përshtatshëm të trafikut të internetit dhe mungesë kontrollesh ndaj përdoruesve, duke shtuar rrezikun e cenimit të të dhënave. Me kalimin e infrastrukturës celulare nga rrjeti 4G në atë 5G, jo vetëm përdorimi, por krejt ekonomia jonë mund dhe duhet të riorganizohet rreth teknologjisë më moderne, si shtyllë kurrizore e saj. Teknologjia 5G premtton inteligjencë artificiale, mjete autonome transporti, civile dhe ushtarake, si dhe qytete smart, etj. Një teknologji e tillë nuk është thjesht një motor ekonomik, që do të shtojë forcën tërheqëse drejt rritjes ekonomike. Në duart e gabuara, ajo mund të shndërrohet në një instrument kontrolli dhe cenimi fatal sigurie. AKEP ende nuk është gati dhe nuk ka strategjinë e duhur, për të na dhënë siguri të arsyeshme të përdorimit të teknologjisë 5G. Kjo është arsyeja kryesore, pse kjo teknologji e së sotmes dhe së ardhmes nuk ka hyrë tek ne dhe nuk do të hyjë, për fat të keq, edhe për një periudhë tjetër të gjatë, edhe për shkak të mosreagimit dhe mosveprimit në kohën e duhur të AKEP.

Piktori thotë se ekspozita me vizatime vjen prej një dosjeje, e cila pasurohet që prej 55 vitesh

# ANASTAS KOSTANDINI: Vizatimi është mjet për të mbajtur mend çaste nga jeta materiale dhe sentimentale, ai mbetet një ditari i vend-jetës

**N**ostalgjia dhe dashuria për atë që po humbiste e nxiti piktorin Anastas Kostandini që të krijojë një repertor të pasur motivesh, të cilat i përkasin dhe nuk i përkasin më qytetit të tij. Pogradeci vjen përmes vizatimeve. Në intervistën e tij për gazetën "SOT" piktori i njohur Anastas Kostandini (Taso) tregon se ekspozita "Vizatime nga vendi i jetës" përmban 70 vizatime. Ai tregon se në vitin 1966 filloi të vizatojë, ku gati çdo ditë e gjente mundësinë të linte gjurmë në fletoren e tij të vizatimit. Ekspozita që hapet këtë mbrëmje në galerinë e Pogradecit përmban vizatime që janë nxjerrë prej një dosjeje voluminoze, e cila sipas artistit pasurohet që prej 55 vitesh. Piktori thotë se ka vizatuar qytetin e tij thuajse përditë, tamam sikur të ishte një ritual. Ndërkaq që pak javë më parë u inaugurua dhe mozaiku "Iliria" veper e piktorit. Ai thotë se është një mozaik me trajta grafike, krijuar mbi motivet e Paftës së Selcës. Anastas Kostandini (Taso) është një piktor, mozaist, vizatues, grafist, ilustrator i mirënjohur shqiptar, lindur në Pogradec. Në 1978 diplomohet në Akademinë e Arteve të bukura në Tiranë për art monumental. Në vitin 1991 i jepet titulli "Piktor i merituar".



gjysma kushërinj dhe pjesa tjetër miq e të njohur), kam krijuar në një hapësirë lirie dhe paqeje. Pothuaj çdo ditë, me dosjen në dorë, endesha pranë liqenit, në mëhallën e burimeve, të lumit, dhe në Goricë; një lagje nga ku shihja panoramën e gjerë të Pogradecit. Kjo pamje ka evidentuar te unë "vizatuesin-poet". Vizatimi është ky medium i thjeshtë, modest e i ngrohtë përmes të cilit zgjohet ndjenja e mallit dhe dëshirës për gjëra të njohura e të panjohura. Kjo gjini e lashtë e artit figurativ lindi bashkë me nevojën për të komunikuar, duke u bërë çelësi magjik drejt labirinteve të qenies. Vizatimet nuk pranojnë udhëzime, paramendime, as porosi, pasi në to shfaqet sensi i një lirie të vërtetë krijuese.

**-Paris është një nga kryeqytetet që ju e vizitoni herë pas here. Por në këto vizita në kryeqytetin e Francës, një artist si ju nuk largohet pa parë dhe ekspozita. Çfarë ju ka bërë përshtypje?**

Para pak kohësh, vizitova në Paris ekspozitën mbresëlënëse të realistit Theodore Rousseau. Ai njihet për vizatimet monumentale kushtuar natyrës; pyjeve dhe drurëve. Ndërsa në Barbizon pashë studion e tij dhe të François Millet. Këta janë baballarët e realizmit natyror, të cilët shpalosin dashurinë mistike për natyrën e virgjër dhe humane. Si nxënës në liceun artistik, pata njohur në libra këta kolosë dhe shumë të tjerë si Camille Corot, Vincent Van Gogh, Paul Cezanne; kanë pasur një ndikim të madh në formimin tim që në kohën e Liceut Artistik. Kështu, arti im ka bashkërendur me njeriun dhe natyrën në një shteg të gjatë e të bukur, ku udhëheq vizatimi. Vizatimi është mjet për të mbajtur mend çaste nga jeta materiale dhe sentimentale. Ai mbetet një ditari i vend-jetës. Sa më shumë kalon koha, aq më domethënëse bëhen ato vizatime për artistin.

**-Sa vizatime ka ekspozita që ju hapni më 29 qershor për publikun?**

Ekspozita "Vizatime nga vendi i jetës" ka 70 vizatime, nxjerrë prej një dosjeje voluminoze e cila pasurohet që prej 55

vitesh. Kam vizatuar qytetin tim thuajse përditë, tamam sikur të ishte një ritual. Marrëdhënia ime me vizatimin ka luajtur rol thelbësor në ripërtëritjen e marrëdhënies sime me vendin ku jetoj. Përmes "ditarit" artistik, kam mundur të ndërtoj dhe rindërtoj gjithçka rrotull meje. Kështu, qyteti im është bërë një motiv i pashtershëm; gjithnjë dhe përditë më duket sikur e shoh për herë të parë. Kjo më kujton dokumentarin e famshëm francez mbi muzeun e Louvre-it, i cili mbyllet me thënien: "Kur do ta shikoj përsëri këtë muze me sytë e herës së parë!". Ekspozita i dedikohet peizazhit. Megjithatë, veprat nuk paraqesin thjesht realizmin ekspresiv të natyrës, por shkrihen me konceptin e qytetit-shtëpi. Sipas një linje kronologjike, të parat vijnë punimet e viteve '60, '70 (rinia ime shkollore dhe akademike). Ky moment përkon me ndikimet e para nga mjeshtrat



Mëhalla e vjetër, vit 1969 / 35 x 25 cm - Flomaster

e vizatimit si Da Vinci, Rembrandt, Durer, Poussin, Rubens, etj. Në vitet '80, megjithë përkushtimin tim ndaj tablove në vaj, nuk rreshta së vizatuari. Besoj se krijimtaria ime erdhi e ekuilibruar përsa i përket dy medimeve (mes pikurës dhe vizatimit), ashtu si ndodhi me Goya-n, Picasso-n, Chagall-in, Bernard Buffet apo ekspresionistët gjermanë. Vitet '90, sollën një qasje shumë ekspresive. Ndryshimi i sistemeve, tranzicioni, mënyra e re e jetesës, nxiti qëndrime të tjera grafike. Këndvështrimi i ri mbi realitetin, i dha jetë një tensioni të fortë në të vizatuar. Vizatimi ndryshoi bashkë me mua. Njerëzit po shkëlpin mbi kulturën e tyre, duke përcënuar çdo gjë që vinte nga e kaluara. Qyteti po humbiste vetveten. Në të, po materializohej anarkia; rrugë kaotike, ndërtime arbitrare, shtëpi dhe lagje të amortizuara, natyrë e denatyrizuar. Ishte momenti kur vizatimi u kthye për mua në një mision "shpëtimi" ndaj gjërave që befas po zhdukeshin. Nostalgjia dhe dashuria për atë që po humbiste, më nxiti të krijoj brenda meje një repertor të pasur motivesh, të cilat i përkasin dhe nuk i përkasin më qytetit. Qysh atëherë, vizatimi u bë një ritual melankolik, sepse shqetësimi për zvetënimin e qytetit më bënte të krijoja një realitet tjetër. Fushat bujqësore dhe rrethinat e braktisura, u bënë një motiv i dashur. Aty, unë ende takoj lirinë e natyrës

bashkë me pastërtinë e një jete të thjeshtë. Uroj që dosja ime e vizatimit të mos vijë si një arkiv i zakonshëm pamjesh, por si një koleksion gjurmësh drite, fati dhe jete. Vincent Van Gogh-u shprehet kështu për vizatimin: "Ç'do të thotë të vizatosh? Si ia arrijmë kësaj? Të vizatuarit është veprimi me të cilin çajmë tejpertej murin prej hekuri e të padukshëm, i cili me gjasë ndodhet midis ndjenjave dhe mundësive tona. Si duhet ta përshkojmë këtë mur? Sipas meje duhet ta rrëzojmë duke e ngrënë me limën e durimit dhe pasionit, ngadalë...".

**-Në aktivitetin tuaj në vijim të veprave ishte dhe mozaiku "Iliria", që u inaugurua pak javë më parë. Por sa kohë keni punuar për realizimin e tij?**

Unë kam punuar një vit e gjysmë për mozaikun. Kam bërë një mozaik klasik të mbështetur mbi traditën e mozaikut paleokristian dhe mozaikë të themi të periudhës klasike siç jemi edukuar, kryesisht mozaikët greko-romakë që janë në vendin tonë. Ne jemi edukuar me ta dhe unë kam zgjedhur këtë teknikë. Është me pak ngjyra, nuk është një mozaik kromatik me shumë ngjyra, por me 4-5 ngjyra, dhe është në formë grafike. Unë desha që kjo të ishte e fuqishme dhe të kishte impakt dhe përshtypje të drejtpërdrejtë me kalimtarët aty, dhe është në zonë të rëndësishme të qytetit te fasada e bashkisë. Fasada e bashkisë së Pogradecit ka dhe një punë tjetër timen, por në një teknikë tjetër. Quhet "E bukura e dheut dhe era pranverore" dhe është e montuar në hekur dhe



Varka dhe Zgalemi në Pogradec, vit 2011 / 32 x 23 cm - Flomaster e zezë

mjaft e madhe, rreth 6 metra e gjatë, kurse tjera që është mozaik quhet "Iliria" dhe i dedikohet botës Ilire. Një nga kryeqendrat ka qenë dhe Pogradeci dhe është marrë pikërisht Pafta e Selcës një nga gjetjet më të spikatura të kulturës Ilire që është gjetur në Pogradec në Selcën e poshtme dhe unë e kam përpunuar.

**-Ju si artist keni një aktivitet të larmishëm artistik dhe me krijimtarinë tuaj jeni prezantuar në ekspozita të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Por pas kësaj ekspozite që hapet këtë qershor, çfarë mund të na tregoni mbi projektet tuaja në vijim si piktor?**

Në planet e mia si piktor në vijim parashikohet një tjetër ekspozitë në përmasa të mëdha në Tiranë, që mund të hapet nga muaji shtator dhe tetor.

Intervistoi: Julia VRAPI

Myshketa interpretoi së fundmi rolin e Gianni Schicchi-t

# Baritoni Gëzim Myshketa dhe artistët e TKOB-së një koncert me këngë shqiptare dhe pjesë të huaja

Nga Julia VRAPI

Një përzgjedhje këngësh shqiptare, si dhe pjesë të njohura ndërkom-bëtare janë pjesë e koncertit recital të baritonit Gëzim Myshketa. Artisti i njohur rikthehet me një koncert recital, që do të zhvillohet në mbrëmjen e 6 korrikut në amfiteatrin antik të Durrësit. Baritoni Gëzim Myshketa, "Mjeshtër i Madh" dhe fitues i disa çmimeve prestigjioze është i njohur për debutimet e tij në kryevepra botërore në skenat e teatrove të shteteve të ndryshme si të Italisë, Japonisë, Koresë, SHBA-së, Gjermanisë dhe më gjerë, por këtë verë ai rikthehet në qytetin e tij të lindjes, Durrës, me një koncert recital unik. Kjo pohohet nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, që shprehet më tej se i shoqëruar nga kori, solistët dhe Orkestra Simfonike e TKOB-së, baritoni Gëzim Myshketa do të interpretojë një përzgjedhje këngësh shqiptare, duke përfshirë "Të falem i bukri Durrës", "Për ty Atdhe" dhe "Pragu i vegjëlisë". Po ashtu sipas TKOB-së repertori do të përmbajë edhe pjesë të njohura ndërkom-bëtare si "Parla piu piano", "Funiculi Funicula" dhe "Caruso". "I cilësuar nga kritika italiane si një nga talentet më të spikatura të brezit të tij, Myshketa interpretoi së fundmi rolin e Gianni Schicchi-t në operën "Il Trittico", e cila u vu në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit gjatë muajve shkurt dhe mars të këtij viti", thuhet nga TKOB që shton se ky koncert organizohet në bashkëpunim me Bashkinë Durrës. Amfiteatri i Durrësit do të vazhdojë të jetë një skenë e hapur, plot aktivitete gjatë gjithë stinës së verës dhe një prej



**I cilësuar nga kritika italiane si një nga talentet më të spikatura të brezit të tij, Myshketa interpretoi së fundmi rolin e Gianni Schicchi-t në operën "Il Trittico", e cila u vu në skenën e Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit gjatë muajve shkurt dhe mars të këtij viti...**

tyre në vijim është dhe koncerti i baritonit të njohur.

#### Bashkëpunimet artistike

Gëzim Myshketa është një këngëtar i njohur. I lindur në vitin 1982 në Durrës, Gëzim Myshketa filloi të studiojë kanto duke rënë menjëherë në sy si një nga talentet më interesante të brezit të tij. Ai u diplomua me nota maksimale në Konservatorin "Arrigo Boito" në Parma, nën drejtimin e mjeshtërave Giuliano Ciannella dhe Lelio Capilupi. Vetëm 20 vjeç debutoi në rolin e Figaros në "Le Nozze di Figaro" nën drejtimin e Antonello Allemandit dhe më vonë me fituesit e konkursit ndërkom-bëtar "Giuseppe di Stefano Trapani". Fituesi i 57-të i Konkurrencës As.Li.Co 2006, ai bëri debutimin e

tij si Don Giovanni dhe Leporello në Circuito Lirico Lombardo dhe Opera de Massy. Në vitin 2008 ai fitoi Konkursin Ndërkombëtar të Muzikës së Dhomës "Francesco Paolo Tosti". Myshketa ka bashkëpunuar me dirigjentë të tillë si: Bruno Aprea, Philippe Auguin, Frederic Chaslin, Fasolis Diego, Will Humburg, Daniel Oren, Nello Santi dhe drejtorë të tillë si Robert Carsen, Giancarlo del Monaco, Dante Ferretti, etj. Në 2018 opera "Carmen" erdhi në skenën e Pallatit të Kongreseve me regji nga Gëzim Myshketa. Artisti i skenës operistike Myshketa luajti dhe rolin e Escamilos në veprën "Carmen" të Georges Bizet bazuar në libretin e shkruar nga Meilhac dhe Ludovic Halevy.

## Koncerti "Brez pas brezi" në kuadër të projektit "Edukimi përmes artit"

Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullor prej muajsh tashmë transmeton vlerat e traditës e kulturës shqiptare tek nxënësit e shkollave "Ismail Qemali", "Qemal Stafa", Shkolla e Baletit dhe shtëpia e fëmijës "Zyber Hallulli". Kjo ka vijuar në kuadër të projektit "Edukim përmes Artit", për të cilin teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor shprehet se artistët dhe nxënësit do të bëhen bashkë në një natë për programin artistik. "Në përmbyllje të këtij programi mblihdemi tok të gjithë së bashku dhe "Brez pas brezi" e teçojmë traditën e këngës dhe valles shqiptare me orkestrën, solistët dhe valltarët e Ansambli Popullor në një natë plot ngjyra tradite në TKOB. Nga Veriu gjer në Jug, do të këndojmë dhe kërcëjmë së bashku me Shkollën e Baletit dhe gjimnazet "Ismail Qemali" dhe "Qemal Stafa", këtë 29 qershor në orën 19:00. Hyrja e lirë!", thuhet nga Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit (TKOB). Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore (AKKVP) ose Ansambli Shtetëror, është krijuar në vitin 1957 si ansambël profesionist. Ky ansambël përbëhet nga solistët këngëtarë, orkestrina, grupi i valleve dhe kori. Qëllimi i Ansambli Kombëtar të Këngëve dhe Valleve Popullore është në përpunimin, zhvillimin dhe përhapjen e thesarit folklorik të Shqipërisë. Këtu përfshihen pasuritë e mëdha folklorike vokale, instrumentale, koreografike dhe kostumografike, që variojnë nga zona në zonë, duke krijuar një koloritet motivesh.



## Fortifikimi i qytetit antik të Orikumit

Fortifikimi i qytetit antik të Orikumit është një ndër elementët që e bën edhe më tërheqës parkun arkeologjik. Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë shprehet se në ditarin e mbajtur gjatë zhvillimit të Luftës Civile (viti 48 p.Kr) midis Cezarit dhe Pompeut në territorin e Ilirisë së Jugut, ndër të tjera, Cezari bën një përshkrim të qytetit antik të Orikumit. "Ai i referohet fortifikimit kur thotë se: "Orikumi ishte

një qytet antik i fortifikuar mirë, me mure të fuqishëm të mbrojtur nga kulla". Gërmimet arkeologjike të projektit shqiptaro-zviceran zbuluan një pjesë të mirë të murit fortifikues, hyrjeve antike, si dhe kullave e bastjoneve që mbronin hyrjet. Edhe fazat e ndërtimeve dhe rindërtimeve në murin fortifikues janë të shumta, por më të pranishmet janë fazat e shek. IV-III p.Kr, si dhe shek. V-VI m.Kr.", thuhet nga DRTK.

## Tuma e Kamenicës një ndër sítet arkeologjike më të rëndësishme

Tuma e Kamenicës është një ndër sítet arkeologjike më të rëndësishme jo vetëm në rajonin e Korçës, por edhe në Ballkan. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore përmes një materiali shprehet se në këtë vendvarrim prehistorik janë evidentuar varre, skelete kockore, objekte arkeologjike si qeramikë, armë, stoli prej bronxi, hekuri, argjendi, ari, qelibari dhe kocke. "Me çeljen e sezonit

turistik, Tuma e Kamenicës është kthyer në një destinacion mikpritës për vizitorë të huaj, të cilët kanë vizituar Korçën dhe destinacionet kryesore pjesë e trashëgimisë kulturore të qytetit", thuhet nga IKTk. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore herë pas here sjell në vëmendje objekte të trashëgimisë sonë kulturore, së fundmi ishte dhe materiali për Tumën e Kamenicës.

## 38.285 vizitorë në parkun e Butrintit gjatë 5 mujorit të parë të vitit

Parku kombëtar arkeologjik i Butrintit vijon të mbetet destinacioni, që tërheq vizitorët nga e gjithë bota. Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Blendi Gonxhja bën të ditur dhe për rritjen e numrit të vizitorëve. "Vetëm gjatë pesëmuajorit të parë të vitit, parku i Butrintit mirëpriti 38,285 vizitorë, 79.4 për qind më shumë krahasuar me vitin 2023", shprehet ministri në rrjete sociale.

Sipas ministrit Blendi Gonxhja rreth 52 për qind e vizitorëve kanë qenë turistë nga vende të ndryshme të botës. Butrinti është një kompleks arkitektonik me 15 zona të periudhave të ndryshme, nga shekulli IV para Krishtit deri në shekullin XVI pas Krishtit. Mes rrënojave të lashtësisë muzeu i Butrintit shfaq një kronologji të historisë mijëra vjeçare të qytetit antik.



# kulturë

## Emma Roberts dhe Kim Kardashian producente ekzekutive të "Calabasas"

Emma Roberts dhe Kim Krdashian vijnë me projekte të reja. Do bëhen producente ekzekutive të një seriali të ri në platformën Netflix. Kim i ka bashkuar forcat me yllin Emma Roberts në mënyrë që t'i ndihmojë ta realizojë serialin e quajtur "Calabasas". "Kim dhe unë jemi producente ekzekutive të një seriali që do të shfaqet në Netflix dhe quhet "Calabasas", ka thënë Emma në emi-

sionin "The Spotlight With Jessica Shaw". Ajo ka thënë se drejtoreshë e këtij projekti është Marlene King, e cila e ka bërë serialin "Pretty Little Liars", ndërkohë që ka cekur se është tepër e entuziazmuar ta bëjë këtë punë duke mos ndarë shumë detaje. "Nuk mund të ndaj edhe aq shumë informata. Kim dhe unë jemi dy vajza "Calabasas" që po rikthehem në rrënjët tona", ka thënë ylli. Ndërkohë Kim ka

qenë duke bërë disa orë mësimi për aktrim, duke thënë se i pëlqen ta sfidojë veten. Së fundmi Emma Roberts ka folur për Julia Roberts, duke kujtuar se ishte me të vërtetë e frikshme të dëshmosh nivelin e famës, që fitoi halla e saj. Emma, vajza e Eric Roberts dhe mbesa e aktores së "Pretty Woman" shpjegoi në podcastin "Table for Two" të martën se fama vjen dhe me anët e saj negative.



### FJALEKRYQI SOT

1	2	3		4	5	6		7	8	9	10		11
12			13				14						
15			16				17					18	
	19				20					21			
	22				23					24			
25				26					27				
28			29					30					31
32			33					34					35
		36						37				38	
39						40					41		

### HORIZONTAL

1- Ish presidenti i SHBA Xhorxh ... (2001-2009) 4- I thuhet tepsisë prej bakri me buzë të kthyer 7- Janë parazitë të vegjël 12- Kafshë e egër e pyjeve tona 13- Ajo është burimi i të gjitha të mnirave materiale 14- Ish futbollisti anglez i viteve 1985 Kigan 15- Theodhori i këngës 17- Është lidhës që shpreh një dëshirë për miratim 18- Gëlltit ose ... 19- Një lagje e vjetër në Shkodër afër kalasë 20- Medikament që lufton malarin 21- Jo shumë 22- Ajo e Arkimedit 23- Kamberi Aktor 24- Grup këngëtarësh prej tre vetash 25- Një opera e Puçinit 26- Lluqaçi, aktor estrade 27- Një opera e Pjetër Mankanjit 28- Profil metalik 29- Një qytet bregdetar në jug, i pashquar 30- Është gjini e letërsisë artistike që përpunohet e përshtatet për tu vënë në skenë 32- Pohojnë rusët 33- I thatë, lungë me qelb 34- Potere 36- Ato mund të jenë elektromagnetike 37- Është gaz i plogët dhe i rrallë, përdoret në llambat për ndriçim 38- Pije alkoolike që përdornin më parë piratët 39- Një hotel luksoz në qendër të Tiranës 40- Njomësia që mban në vetvete toka 41- Nasi i shkrimeve.

### VERTIKAL

1-Ymeri aktor 2- Nevojë e ngutshme për ushqim 3- Në kimi quhet procesi kimik për përfitim të elementeve me anë të bashkimit të substancave 4- I thonë ndryshe drerit apo drenushës 5- Gjika e skenës tek filmi "Vetmi" 6- Përemër vektor 7- Një shtet pothuajse në zemër të Europës 8- Shkencëtari rus për trurin Pavlov 9- Stacioni ndërplanetar rus në hapësirë 10- Kidman, aktore australiane, në inic 11- Veshje dimërore 13- Arshi..., gjuhëtar dhe akademik shkodran 14- Degë e muzikës në Institutin e Lartë të Arteve 16- Është kafsha më elegante e Savanës 17- Kështu quhej më parë Egjipti 18- Plotëson nevojat për një marshim 20- Lloj peshku liqeni me pika të kuqe në trup 21- Diçka parësore, e dorës së parë 22- Një ndër shfaqet e para të baletit shqiptar 23- Pagesë mbi vlerën e faturës 24- Autobus mbi shina 25- ... Shtylla, ish Kryetar i Kuvendit (1958-1963) 26- Një qytet në verilindje të vendit 27- Një shtet në Lindjen e mesme 29- Përpjekje për të mashtrua, dredhi për mashtrim 30- I thonë ndryshe dërrasës së zezë 31- Një gazetë e përditshme 33- Aktori i Hollywood-it, Xheki ... 34- Dert, anglisht 35- Rrethi çiklistik i Francës 36- Valët Galaktike 37- Natasha aktore në inic.

### SUDOKU

		1		2		5	3					5	2		1			1	4		2					
5		9		4				1	8								5	8	2			9				5
			5				4	2	9			6			7	8	3			4	7					
	9	4	8	7							8				2		6	8	1					5		
												3	9									5	6		2	
				3	5	4	6			1					6						1				8	
2	1				7				6	3			7			4			4		6		5			
9				1		6		5	4							7			3					6		
	4	8		5		1					7		8	3			2						3	9		

### Celine Dion dhuron 2 milionë dollarë për qendrën mjekësore

Celine Dion ka dhuruar 2 milionë dollarë për kampusin mjekësor "Anschutz" të Universitetit të Colorados ku bëhen kërkime për sindromën e muskujve të ngurtësuar, me të cilën është duke u përballur edhe vetë. Në këtë qendër mjekësore aktualisht është duke u trajtuar edhe Dion nga doktoresha Amanda Piquet, shkruan FemaleFirst. "Jam tejet e nderuar për të pranuar këtë mirënjohje në mënyrë që kjo fushë e mjekësisë të dërgohet përpara. Sindroma e muskujve të ngurtësuar është sëmundje neurologjike autoimmune, e cila karakterizohet nga dy veti, spazmat muskulore dhe ngurtësia e muskujve", ka thënë Piquet. Ajo ka shtuar se ishte vetë Celine ajo e cila i ka gjetur këta mjekë me të cilët ka pasur një marrëdhënie të mirë. Këngëtarja përmes një dokumentari ka thënë se dëshiron ta rrisë vetëdijen për këtë sëmundje.



### Babai dhe djali

Bledi hyn me vrap në dhomën, ku i ati po lexon gazetën. Me një frymë e pyet:  
-Baba, a është e vërtetë, që një mollë mund të largojë mjekun, që ke pranë?  
I ati përgjigjet pa e ditur qëllimin e vërtetë, të djalit të tij:  
-Kjo është sipas asaj që thonë, biri im.  
Djali sapo dëgjon këtë përgjigje, i thotë:  
-Më jep menjëherë një mollë. Sapo kam thyer xhamat e dritares së mjekut, që ndodhet afër me ne.

### Biseda

Një djalë ishte tepër xheloz për të dashurën e tij dhe dëshironte të dinte, se ku ndodhej ajo në çdo moment. Një herë vajza nuk i tha djalit se ku do të shkonte, sepse mendoi se nuk do të vonohej shumë. Sapo hyn në dyqan vajzës i bie zilja e telefonit dhe ajo e ngrre dhe menjëherë përgjigjet:  
- I dashur, si e gjete që unë isha në supermarket?

# kulturë

Restoranti "Disfrutar" në Barcelonë të Spanjës kryeson listën e 50 restoranteve më të mira në botë. Por kush shpreson që të rezervojë një tryezë në "Disfrutar" mund të zhgënjehet, lista e pritjes zgjat pothuajse një vit. "Disfrutar" do të thotë "të kënaqesh". Restoranti me këtë emër në Barcelonë është një histori suksesi. Ka marrë vlerësime të larta nga udhërrëfyes të ndryshëm prestigjiozë, përfshirë "Michelin". Dhe tani i është dhënë vendi i parë në listën e 50 restoranteve më të mira në botë.

## Restoranti më i mirë në botë zgjidhet në Spanjë



### Përgjigjet e fjalëkryqit

A	D	E	L	A		E	T	I	K	A
K		T	E	R	I	T	O	R		V
O	B		K	O	R	I	K		S	A
M	U	R		M	I	K		S	E	R
A	R	E	N		S	E	M	A	N	I
	I	M	A	M		T	O	K	A	
A	M	A	T	O	2/R		L	A	T	I
M	E	T		T	7/I	M		T	O	K
I	T		M	I	11/K	E	L		R	O
T		L	A	V	1/A	M	A	N		N
A	K	I	L	I		A	K	O	M	A

### OnePlus prezanton telefonin Ace 3 Pro

OnePlus paralajmëroi ardhjen e të ashtuquajturës teknologji Glacier Battery disa ditë më parë. Dhe dita ka ardhur, pasi OnePlus Ace 3 Pro i sapo shpallur është telefoni i parë me këtë teknologji, shkruajnë mediat e huaja. OnePlus thotë se Ace 3 Pro ka një bateri 6,100 mAh, duke e bërë atë ndoshta baterinë më të fuqishme që kemi parë ndonjëherë në një celular OnePlus. Ai gjithashtu ka një procesor Snapdragon 8 Gen 3.

### Fjalëkryq i shifruar

5	11	7	4	5		9	2	3	7	6
8		13	2	11	14	5	4	7		10
12	12		1	10	3	14	5		8	1
5	3	7		11	7	1		6	1	5
1	2	11	5		11	7	6	3	5	6
	15	5	3	5		14	3	7	11	
3	2	6	7	11	5/A		2	9	2	3
7	1	7		7	1/K	5		5	12	7
9	6		5	4	2/E	6	2		7	6
2		8	12	7	3/R	5	4	2		2
4	10	6	7	11		1	5	8	2	9

1			2	3		4	5			6
			7		8					
		9						10		
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39				40		41		42		
		43	44				45			
			46							
47							48			

### HORIZONTAL

1- Është ai që kryen një punë në vendin tënd 4- Lloj peshku liqeni me shumë hala 7- Jurist që merret me identifikimin e dokumentave 9- Shkëmbinj me ngjyrë hiri në të bardhë, përdoret për të prodhuar xhamat 11- Njëlloj si egoja 13- Një firmë e njohur karburanti në Itali 14- Organizatë terroriste baske 16- Piktori shkodran Idromeno 18- Lëng i hidhur që prodhon mëlçia 19- Poeti dhe piktori Maks ... 20- Një gjarpër shumë i rrezikshëm 21- lopatat e lundëtarit 22- Kripë e kaliumit shërben për prodhimin e plehrave kimike, sapunit etj. 23- Profil metalik 24- Taksë apo detyrim që i paguhet një shteti tjetër që e ka mundur në luftë 26- Përemër vektor 27- Janë konstruksione betoni për ndërtim 28- koraca në makina 29- Është fsht i Fierit 30- Një prift ortodoks 31- Marcelo ..., ish-futbollist kilian 32- Lloj të qethure 33- Rracë e përzierë 34- Figurë tek letrat e bixhozit 35- I thonë edhe masat, copë çeliku për të ndezur eshkën 37- ... Liza, (Xhokonda) pikture e Leonardo da Vinçit 39- Bakër ose ... 40- Zakon, adet, huq 42- Lojë në fushën e shahut 43- Ai i llampës magjike 46- Kështu quhej më parë vendi ynë 47- Ai vërteton identitetin 48- Piktura të shenjtorëve në dru.

### VERTIKAL

1-Vegël muzikore karakteristike greke 2- Koço i muzikës 3- Një ndër shfaqjet e para të baletit shqiptar 4- Disponojmë 5- Kafshë e egër e pyjeve tona 6- Shkretëtirë e gjerë në qendër të Afrikës 8- Edmondi tek filmi "Si gjithë të tjerët" 9- Jam në hall, në mëdyshje apo në ... 10- Një fshat i Vlorës 12- Tregim i gjatë që përshkruan ngjarje nga jeta 15- Ai i Pojanit, pa të fundit 17- Tase e volejbollit 18- Ato janë determinonte në zgjedhje 20- Lloj peshku liqeni me pika të kuqe në trup 21- tip automjeti francez 22- Aktorja amerikane me origjinë greke Irene ... 24- Çardak apo ... siç i thonë shkodranët 25- Tufë kafshësh 27- Lloj vaji për motorët që del nga kullimi naftës 28- ... virusi që po bën kërdinë 29- Faith, këngëtare dhe aktore amerikane 30- Krijim letrar ironizues 31- Janë 114 kapitujt e Kuranit 32- Zotëroj 33- Ato banojnë në manastire 36- Aktori i Hollywood Kabir ... 38- Është lëng frutash 40- I plotfuqishëm i një vilajeti në kohën e sulltanit 41- Një shtet në Lindjen e Mesme gjiton me Jordanin 44- "Mbreti" i Shekspir 45- Patrioti ... Pjetër Gega.

### HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

**Dashi**  
21 mars - 20 prill  
Suksesi që keni arritur së fundmi do bëjë shumë persona xhelozë dhe disa madje do mundohen t'iu bëjnë keq.

**Demi**  
21 prill - 21 maj  
Do keni zemër shumë të madhe gjatë kësaj dite dhe do falni. Nga ana tjetër do iu vini kapak edhe problemeve që keni pasur.

**Binjakët**  
22 maj - 21 qershor  
Në punë do jeni të saktë dhe shumë seriozë. Do keni arritje dhe do merrni përgëzime në çfarëdo lloj fushe që të veproni.

**Gaforrja**  
22 qershor - 22 korrik  
Do jeni plot energji, besim, dinamizëm dhe kurajë sot. Çdo qëllim që do i vini vetes keni për ta arritur.

**Luani**  
23 korrik - 22 gusht  
Në planin financiar, të gjitha përpjekjet dhe matura që keni treguar së fundmi, do japin rezultatet e veta.

**Virgjëresha**  
22 gusht - 22 shtator  
Ardhja e personave të rinj në jetën tuaj do ju bëjnë të ndiheni edhe më mirë sot. Do ndodhin gjëra vërtetë interesante.

### HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

**Peshorja**  
23 shtator - 22 tetor  
Yjet do kenë ndikim negativ gjatë kësaj dite dhe do sjellin herë pas here probleme. Shpenzimet do i kryeni pa menduar aspak.

**Akrepi**  
23 tetor - 21 nëntor  
Sot do jeni më të ndërgjegjshëm për gabimet që keni bërë dhe do bëni gjithçka që t'i ndreqni ato sa më parë.

**Shigjetari**  
22 nëntor - 21 dhjetor  
Në punë do jeni më aktivë, por frika nga gabimi do ju stepë paksa për të çuar deri në fund objektivat.

**Bricjapi**  
22 dhjetor - 21 janar  
Do jeni shumë optimistë dhe pozitivë gjatë kësaj dite, kështu që në tërësi gjërat do ju ecin më së miri.

**Ujori**  
22 janar - 19 shkurt  
Sot do jeni shumë të duruar dhe dëgjues shumë më të mirë. Të gjithë do kërkojnë t'iu qëndrojnë pranë.

**Peshqit**  
20 shkurt - 20 mars  
Në punë duhet të mbronni çdo mendim që do keni edhe sikur të gjithë t'i keni kundër. Në planin financiar tregoni kujdes.

# Debate te Franca para duelit me Belgjikën, Kroacia e pëson nga UEFA për shkak të tifozëve

Tek francezët ka pasur një debat mes trajnerit Deshamps dhe Kamavingës, kurse përfaqësuesja kroate merr gjobën më të rëndë në këtë European, 105 mijë euro

Adriatik BALLA

Situata te kombëtarja franceze nuk është aspak e qetë para ndeshjeve të 1-8-ave në Euro 2024. Siç raportohet nga e përditshmja "L'Equipe", trajneri Didier Deshamps dhe i riu Eduardo Kamavinga patën një debat të ashpër pas barazimit kundër Polonisë. Një barazim që e detyroi Francën të renditej në vendin e dytë në grup. Nga konferenca për shtyp kishin dalë disa zëra, ku trajneri francez u ankua për mungesën e reagimit nga lojtarët që morën përsipër të luajnë në pjesën e dytë, por që nuk mundën të ndikonin në ndeshje. Dje, para stërvitjes, Deshamps iu afrua lojtarëve të tij. Ndërsa Kamavinga po i lidhte këpucët, trajneri e pyeti me sarkazëm: "A je gati, Kama? Le të fillojmë", tha ai. Menjëherë më pas, gjatë seancës së nxehmjes, Deshamps u rikthye për t'u përballur me mesfushorin e Realit të Madridit. Nga



pamjet, duket se të dy po diskutonin për këpucët e tij të futbollit. Në dy momente të veçanta, lojtari ka treguar qartë tabanin e këpucës së tij, duke i shpjeguar me sa duket trajnerit diçka. Edhe pse ishte një dialog i shkurtër, është e qartë se Deshamps donte të trajtonte dhe sqaronte disa çështje me lojtarin e tij. Ndërkohë që tek Franca ka probleme të brendshme, duket se për disa përfaqësues që janë eliminuar vijojnë problemet me UEFA-n për shkak

të sjelljes së tifozëve të tyre. Kështu, Kroacia të premten ka marrë gjobën më të madhe nga UEFA për ndonjë përfaqësues në "Euro 2024", ndërsa është dënua për herën e tretë. Federata e Futbollit e Kroacisë ka njoftuar se është gjobitur me 105 mijë euro nga UEFA për sjellje jo të mirë të tifozëve në ndeshjen e fundit të fazës grupore ndaj Italisë. Kroacia e Shqipëria mund të marrin tjetër dënim. "Associated Press" ka njoftuar se po

hetohet për racizëm ku u përfshinë tifozët kroatë e shqiptarë, në ndeshjen Kroacia - Shqipëria, që përfundoi 2:2. Federata e Futbollit të Kroacisë u dënua për gjuajtje të gjëseneve në fushën e lojës me 45 mijë euro, për ndezjen e fishekzjarrëve me 30 mijë euro dhe për sjellje të papranueshme të tifozëve me 30 mijë euro. Për ndeshjen kundër Shqipërisë, Kroacia kishte marrë gjobë prej 27 mijë e 500 eurove për shkak se tifozët ndezën dhe hodhën fishekzjarrë. Tri gjoba për tri ndeshje i janë ndarë Shqipërisë, e fundit të enjten. Federata kroate ka përfutuar 9.2 milionë euro nga UEFA për pjesëmarrje në Evropian. Ndërkohë, Kroacia vijon të marrë goditje nga UEFA për sjelljen e keqe të tifozëve shfaqur në duetel e grupit B, madje ka nisje të një hetimi të dyfishtë për Kroacinë dhe Shqipërinë pasi dyshohet se tifozëritë e tyre shpalsën rihirje raciste në duelin e 19 qershorit.

## Merkato/ Çelsi kërkon më e pakta 43 mln euro për Lukakun


Kampionati European i Futbollit ka hyrë në fazën me eliminim direkt dhe merr më shumë vëmendje, por ndërkohë klubet e kanë mendjen në merkato. Milani dhe Napoli kërkojnë përforcime në sulm dhe kanë të njëjtin objektivi, që është belgu Romelu Lukaku. Kuqezinjtë tashmë mund të shpenzojnë para për një sulmues të ri, por napolitanët duhet të shesin Viktor Osimhen për t'i lënë vend belgut. Edhe pse kishte raportime se Çelsi nuk ka

ndërmend ta lirojë belgun nëse nuk merr të paktën 30 milionë euro, "Sky Italia" shkruan se në fakt bëhet fjalë për 43 milionë euro. Ashtu siç pritej, Milani dhe Napoli nuk janë plotësisht të gatshëm të shpenzojnë kaq shumë para, ndaj shpresojnë që blutë të bëjnë zbritje gjatë afatit kalimtar të verës. Milani mund të presë deri në fund të afatit kalimtar dhe të përpiqet të sjellë Lukakun në huazim, ashtu siç bëri Roma sezonin e kaluar.



### DEKLARATA

**Karvajal:**  
Jam më i miri në botë në rolin tim



Mbrojtësi i Realit të Madridit, Dani Carvajal, beson se nuk ka asnjë më të mirë se ai në pozitën e tij në futboll. 32-vjeçari ka shprehur dëshirën për t'u nominuar në "FIFA Best XI" para përfundimit të karrierës, dhe pa dyshim se ai ka një mundësi të mirë këtë sezon. Carvajal nisi sezonin në një nivel të lartë, duke kontribuar edhe me disa gola. Ai u pyet gjithashtu

drejtpërdrejt nëse është mbrojtësi më i mirë i djathtë në botë. "Duke vlerësuar vitin e kaluar, mendoj se po, gjithmonë besoj se për vetëbesimin tim, gjithmonë i them vetes sime që jam, nëse jo unë, kush do të ishte? Ka qenë një vit i mirë, fitimi i Ligës së Kampionëve, madje edhe me gol, kampionati dhe tani dëshira për të çuar Spanjën sa më larg në European." Pa dyshim që golat

në "EURO 2024" dhe në finalen e Ligës së Kampionëve nuk vënë në dyshim se ai kandidat serioz për 11-shen më të mirë të botës. i aftë për të shkaktuar probleme në sulm, pak mbrojtës të tjerë ofrojnë konkurrencën e fortë dhe vendosmërinë që Carvajal ka treguar, dhe pa aftësitë e tij mbrojtëse, triumfi ndaj Manchester Siti dhe Bayern Munihi do të kishte qenë në dyshim.

**NJOFTIM**  
Agjencia e Lajmeve



kërkon

- gazetarë webi dhe
- grafik dizajner

Kontaktimi në adresën:  
gazetasot@yahoo.com  
gazetasotnews@gmail.com

### QËNDRIMI

#### Van Dijk: Holanda ka mundësi të përmirësohet

Holanda është kritikuar shumë pas humbjes 3:2 nga Austria të martën në Berlin. Me humbjen që ua shkaktoi Austria, "tulipanët" mbetën në vendin e tretë në grupin D me 4 pikë. Holanda kaloi në një të tetën e finales si një nga përfaqësueset më të mira të vendit të tretë. Dje në konferencë, Van Dijk tha se i kupton tifozët. "Unë mund ta kuptoj plotësisht kritikën. Unë nuk jam budalla, e di gjithashtu se mund të bëj më mirë dhe se duhet të jetë më mirë dhe




për këtë jam duke punuar. Nuk luajta ndeshjen time më të mirë kundër Austrisë", u shpreh mbrojtësi Van Dijk.

### SULMUESI

#### Morata: Pres telefonatën e Simeones për vazhdimin te Atletiko

Bomberi Alvaro Morata ka shuar spekulimet për një largim të mundshëm nga Atletiko e Madridit. Sulmuesi spanjoll së fundi ka folur për të ardhmen e tij. Morata thotë se deri tani nuk ka marrë asnjë mesazh nga trajneri Diego Simeone. "Nuk e di nëse do të qëndroj te Atletiko. Kam marrë mesazhe nga shumë persona në klub, por jo nga "Cholo". Unë e njoh Simeonen në mënyrë të përsosur, nëse ai nuk do të besonte tek mua, ai do të më kishte telefonuar.



Por ai nuk i ka rënë telefonit tim, kështu që s'kam arsye të shqetësohem", u shpreh ndër të tjera sulmuesi Alvaro Morata.

**STAFI/**

**DREJTOR/** Arjan PRODANI;  
**ZV/KRYEREDAKTOR:** Elmas BOGDANI;

**KRYEREDAKTOR/** Rigels SELIMANI; (067 5000 200)  
**KULTURË/** Julia VRAPI; **SPORT/** Adriatik BALLA; **MENAXHER SHITJE/** Shpëtim Caco

**MARKETING:** Glen PRODANI (Cel: 068 60 33 098);  
email: gazetasotnews@gmail.com